# ExLibris

ISSN 2708-4876

E PËRJAVSHME LETRARE KULTURORE

Themelues • Kryeredaktor BUJAR HUDHRI

E SHTUNË, 23 TETOR 2021. NUMËR 153 VITI IV I BOTIMIT. ÇMIMI 50 LEKË. WWW.EXLIBRIS.AL EMAIL: INFO@EXLIBRIS.AL BOTIM I ONUFRI SHPK


## Sot, 150-vjetori i lindjes së Fishtës

Mes kritikave dhe lavdërimeve:

## Faik Konica për Fishtën

(fq. 4)

## Skicimi i Atë Gjergj Fishtës si kryeredaktor nëpërmjet një polemike

(fq. 5)

*Nga Andreas Dushi*

## A.MANZONI dhe POETIKA E FISHTËS

*Nga Blerina Suta*

(fq. 2)





## LETËRKËMBIMI I MID'HAT FRASHËRIT

*Nga Uran Butka*

(fq. 8)

Tri janë kulmet e kësaj pasurie epistolare: koha kur ishte anëtar dhe kryetar i delegacionit shqiptar në Konferencën e Paqes në Paris dhe në Lidhjen e kombeve në Gjenevë në mbrojtje të identitetit dhe tërësisë teritoriale të Shqipërisë përkunder politikave pushtuese serbe, greke dhe italiane, përkundër politikave imperialiste...

Në 75 vjet, qendra dhe promotori i artit shqiptar dhe e violinës në veçanti

## LICEU ARTISTIK DHE VIOLINA SHQIPTARE

Nga Ina Kosturi

(fq. 10)

Është bukur të shqiptosh dy fjalë "Liceu Artistik ", aty ku nisin ëndërrat e mëdha të artistëve të vegjël, aty ku nisën sukseset e para të artsitëve të mëdhenj shqiptarë, aty ku në çdo kohë merr frymë pasioni...

## LIBRAT-KUMTE TË MREKULLUESHME

*Nga Xhevair Lleshi*

(fq. 12)

## SHËNIME PËR LIBRAT

Anton Nikë Berisha, *Vepra letrare e Martin Camajt.* Studim. Sh. B. "Beqir Musliu" Gjilan

## Një studim vlerash të shumta për veprën letrare të M. Camajt

Nga Ajete Zogaj

(fq. 11)

PYETËSORI

## "LIBRAT E JETËS SIME"

## ERMIR NIKA:

**Libri që pati ndikimin më të madh në shkrimet e mia?** Romani "Një hero i kohës sonë" i Lermontovit!

(fq. 16)

## NË BEOGRAD, NË KONGRESIN E SHKRIMTARËVE

*Nga Dhimitër Shuteriqi*



(fq. 22)

## HENRY MILLER

## Meditime mbi krijimtarinë letrare

## BIBLIOTEKË


Feride Papleka — *Cikël me poezi* (fq. 13)

Nurie Emrullai — *Gjethe tetori* (fq. 17)

Ajkuna Dakli — *Buzë rrugës* (fq. 12)

Kjell Epsmark — *Kur lind një gjuhë* (fq. 14)

Charles Baudelaire — *Tirs* (fq. 12)


## "BRITMA", MONA LIZA E ARTIT MODERN

*Dr. Bledar Kurti*

(fq. 18)

Nga 14, 15, 16 Tetor në Teatrin Libero

## PJESA TEATRALE "LETRA" E YLLJET ALIÇKAJT, U SHFAQ NË PALERMO

(fq. 7)

## FJALORËT, ZEJTARIA E ZGJEDHJES SË FJALËVE

*Nga Mark Simoni*

(fq. 16)

# MANZONI DHE POETIKA E FISHTËS

nga Blerina Suta

Një nga problemet më të rëndësishme të inkuadrimit të Fishtës në sistemin letrar të vlerave është përcaktimi i përmasës romantike, karakterizuar, siç është dëshmuar nga kritika, edhe nga prania e fortë e kulturës klasike.

Në lidhje me këtë raport "problematik" të Fishtës me vetë termin "romantik", arsyeton studiuesi i romantizmit, prof. A. Xhiku, megjithëse Fishta i vlerësonte shumë disa përfaqësues të shquar të romantizmit italian, si Leopardi dhe Manzoni, ai nuk i cilëson ata si romantikë.

Nuk është hera e parë që shkrimtari nuk ia njeh vetes përmasat e një poetike të caktuar me të cilën e identifikon më pas kritika: kështu Manzoni vetë, siç mund të lexohet në përvijimin e shkurtër që De Sanctis-i jep në leksionin e dhjetë për romantizmin, nuk e quan veten romantik; në dallim nga shkolla romantike franceze (e Hygoit), e vrullshme, me pasoja radikale dhe ekstreme, ajo italiane (e Manzoni-t) është për një letërsi të re, por pa qenë në konflikt tërësor me klasikët; pa përdorur shumë fjalë të reja; letërsia e Manzoni-t do të bëhet pasuri e shkollës së re realiste që do të niste.

Profili romantik i Fishtës do të specifikohej më mirë nëse do të evidentohej qartë raporti me traditën pararendëse, për krijimin e asaj që Zamputti quan gjuhë "letrare-epike", duke e vendosur kështu veprën e Fishtës në kuadër të traditës nisur me Bogdanin drejt krijimit të një gjuhe të përbashkët letrare të arealit verior.

Modeli letrar i Manzoni-t qarkulloi në letërsitë ballkanike të kapërcyellit mes shekullit XIX dhe shekullit XX, në të njëjtën masë me frymën kulturore të ideve të Herder-it, Cantù-së, Tomaseu-t për kulturën popullore.

Manzoni është autor që me siguri Fishta e ka njohur qysh nga studimet e tij në Bosnjë, siç dëshmohet nga sasia e përkthimeve në arealin sllavojugor. Sigurisht që ligjësitë e receptimit të frymës së kohës ndjekin rrugë krejt individuale dhe ne flasim për receptim që me rastin e Fishtës pasuron në nivel mbinacional letërsinë shqipe.

Çështja e rëndësishme që mund t'i shërbejë përcaktimit të qartë të Zamputti-t është pikëprerja e poetikës së Fishtës (nënkuptuar si ide dhe teknikë njëkohësisht) me doktrinën manzoniane të "sistemit historik", koncept që Manzoni e përpunoi në esenë e famshme *Për romanin historik dhe në përgjithësi për krijimet e përziera të historisë dhe të trillimit*, duke marrë në analizë romanin historik përballë epopesë dhe tragjedisë historike.

Ajo që mbisundon në doktrinën e Manzoni-t dhe na intereson për përcaktimin e funksionit të veprës së Fishtës, është ideja se autorët e modernitetit karakterizohen nga "kritika historike": "në zotërojmë një kritike historike që, në faktet e së shkuarës, kërkon të vërtetën reale dhe çka është më e rëndësishme, në kemi një besim, që si i vërtetë, nuk mund të përshtatet me ndryshime arbitrare dhe shtesa fantastike".

Problemi specifik që shtrohet në këtë drejtim është raporti trillim-histori në botën e vërtedukshme të artit.

Kur ndalet në ligjësitë e së vërtedukshmes letrare dhe specifikisht në raportin histori-trillim, Manzoni, megjithëse mundohet të ndajë terrenin mes historianëve dhe poetëve: "Pse të përdoren pasqyra, nëse realitetin e kemi para syve", përfundon me idenë se historia dhe karakteri historik është themeli i vërtetë i poezisë dhe garancia e fundit për poeticitet. Kështu në *Lettre à M. Chauvet* shprehet: "Poezia nuk është çështje e poetëve, por e historisë vetë. Poetëve nuk u ngelet tjetër veçse ta nxjerrin atë në pah."



Fishta e bën objekt historinë; kur në shënimet e tij estetike flet për "rodin historijak", thekson se "të gjith bukurija e ligjirimit historjak do të vîjë tuj u endë prej randsijet e interesjet të fakteve, e jo prej ndîesive qi mund të ngallisin në shpírt të shkruesit prej njoftimit të fakteve".

Në mënyrë më specifike, për veprën poetike Fishta shprehet se "Bukurija nuk âsht vetun subjektive, por edhè objektive", "pse objekti i veprës artistike s'mund të jét i bukur por s'kjè edhe i vërtetë".

Nyjëtuar në këndvështrim të parimeve krijuese, ky parim i kritikës historike përfshin në radhë të parë konceptin e së vërtetës në art: Manzoni e nënkupton veprën artistike të sendërtuar nga e "vërteta": "E vetmja gjë që duhet kërkuar te faktet është e vërteta; kush ka frikë t'i analizojë, jep një shenjë të madhe të pasigurisë në principet e tij." (*Osservazioni sulla morale cattolica*)

Kur flet për formë, Fishta flet nga njëra anë për rëndësinë e "rruzullimit ideal" (ku mendja krijon sende fort mâ të madhnueshme se në rruzullimin real), por e lidh pazgjidhshmërisht me "vërtetësinë reale" të objektit: "e i vërtetë s'mundet me kenë për në kjoftë se elementat përbâsë së formës së tij mos të jenë nji gjasimi me atá të formavet të sendevet të dukshme".

Në këndvështrim të poetikës së zbatuar, le të shohim sesi mund t'i qëndrojë parimi i kritikës historike veprës fishtjane duke u nisur nga lirika.

"Unë tham se Fishta lirik asht gjithnj epiku qi del në shesh", - vazhdon Zamputti në arsyetimin e tij. Tipari "epik" apo "epicizimi" i lirikës ka të bëjë me një epikë të përditshmërisë një "epikë në veprim", do të sqarojë ai.

Të njëjtën ide të lirikës "plot me veprim" ka dhënë kritika edhe për lirikën e Manzoni-t, e cila ndërton një

"botë epike", siç do të shprehet De Sanctis-i, duke iu referuar poezive të *Inni sacri*, të përkthyera nga Fishta në rini të tij si *Vjershat e përshpirtshme*: epikë është "ajo mënyrë e të parit të gjërave njerëzore nga sipër, me syrin e botës tjetër", do të vazhdojë leksioni i De Sanctes-it për Manzoni-n në *La letteratura italiana nel secolo XIX*.

Duke analizuar gjuhën e përkthimeve të *Inni sacri*, mund të themi se lënda e Manzoni-t do t'i përcillet edhe asaj pjese të poezisë lirike të Fishtës që i jep vlerë religjionit si moral dhe si poezi: *Këshndellat*; *Të psuemit*; *Të ngjallunt*; *Rrëshajët* kanë lënë gjurmët e tyre në krijimtarinë lirike të Fishtës me frymëzimin e ri, të krishterë, që rrezatojnë.

Veçantia e frymës së krishterë të Manzoni-t që gjen pohim edhe në veprën e autorit tonë është mungesa e fluturimeve në viset e metafizikës dhe fryma demokratike e barazisë mes njerëzve, të gjithë vëllezër të Krishtit, në emër të triadës: liri, barazi vllazëri: *Mì dhe agoi drita e lirìs; [...], Sod t'atanë popujt janë nji rodit/ gjaku i t'lumit i vllaznoi*; (janë vargje të poezisë *Ngadhnjija e kryqit* që mbart atë botë morale që gjendet edhe në botën ideale të teksteve manzoniane).

Po kështu një kompozim epik në forma lirike është edhe *Cinque maggio*, poezi me të cilën Fishta ka rënë në kontakt në mjedisin kroat ku studioi: ndër përkthimet e shumta të kësaj poezie ndër serbë e kroatë, ajo e Mazhuraniqit, poetit të parapëlqyer të Fishtës, konsiderohet ende sot si përkthim më i mirë në atë areal kulturor. Teksti i poezisë *5 maji* ka lënë gjurmë konkrete në leksikun në italisht të poezisë së Fishtës kushtuar mikut të tij poet Kranjçevic më 1892, poezi që veç vargut të adelphi-i ka të përbashkët me Manzoni-n idenë e madhështisë epike të heroit gjeni, në gjurmë të krijuesit.

Pjesa iluministe e poetikës manzoniane, ajo që evokon historinë e njerëzimit dhe të kombeve si histori hegjemonie dhe skllavërie, sakrifice dhe fitoreje, padrejtësie dhe drejtësie, gjen të njëjtin terren në shkrimtarët ballkanikë të kalibrit të Fishtës, Mazuranicit apo Kranjcevicit: *E lae ti ket shkretí, ku shuen e Drejta/ E paudhnija kû sundon mizore; [...]*, janë vargjet e *Nji lule vjeshte*, poezisë që përjetëson në mënyrë të re dhe origjinale idenë e monumentit të gjuhës kombëtare nëpërmjet aktit konkret të poetit-profet.

Së dyti, për sa i përket veprës dramatike, shënojmë se ka vend për përqasje mes dy shkrimtarëve edhe në lidhje me çështjen e objektit të "artit dramatik": sipas Manzoni-t "drama duhet të marrë argumentet nga historia kombëtare dhe në dhimbjen e të drejtëve, duhet të dijë të tregojë forcën dhe dinjitetin njerëzor dhe gjurmën e një rendi të naltëm të gjërave".

Një funksioni të tillë i referohet figura e valles apo kori i zanave në veprat melodramike të Fishtës. P.sh., koret dhe vallja i melodramës *Shqyptarja e qytetnueme* ndihmojnë në ngritjen e subjektit të veçantë në rend më të lartë, atë të himnit kombëtar: "pse meldodrami kje shkrue për me kremtue kunorimet eventuale të Mbretneshave të rregjinis shqyptare".

"Moraliteti i veprës tragjike" të Manzoni-t mishëron një koncept të moralit larg didaktikës dhe katekizmit: dëshmi është fakti se në traktatin *Della moralità delle opere tragiche* ai shprehet se moralitetin e gjen të sendërtuar në mënyrë të përsosur në veprën e Shekspirit, duke iu referuar përcaktimit të Russeau-t për moralin: "është puna me mendjen që ndihmon njeriun të gjejë fenë".



Feja e arsyes në themel të poetikës manzoniane nuk duket larg këtij koncepti iluminist të moralit fishtian kur shkruan: *Ndritjau menden Shqyptarve,/ Qi t'lidhin besë e Fe/ E si motit p'r Atdhe/ [...]/ Qi t' majën p'rherë ka' e verteta/ [...]; E ban qi Feja t'niallet/ Me Shpnesë n' zërner t' Shqyptarit.*

Vepra dramatike *Odisea* e botuar në *Pika voësët* më 1909 ka në incipit vargje nga vepra e Manzoni-t *Conte di Caramanjola* ("Un nemico che offeso non hai/ A tue mense insutando s'asside") që bashkojnë nën toposin e së drejtës natyrore historinë shqiptare me atë universale.

Vargjet në fjalë janë marrë nga kori, element i rëndësishëm në veprën e Manzoni-t, aq sa ai në parathënien e saj, duke u frymëzuar prej funksionit të korit grek, propozuar prej Schlegel-it, e konsideron atë si "mishërues të idealeve dhe zbutëse të tensionit dramatik"; si "personifikim të mendimeve morale që frymëzohen nga veprimi"; si "organ i ndjenjave të poetit që flet në emër të njerëzimit mbarë".

Së treti, dhe më e rëndësishmja, është ideja se koncepti i Manzoni-t për romanin historik do të mund të na ndihmonte për të specifikuar pozicionin e poemës *Lahuta e Malcìs* si epos në modernitet, përkundrejt burimeve përkatësisht klasike dhe popullore, duke i tejkaluar ato dhe duke ia nënshtruar veprën një funksioni që i përgjigjet bashkëkohësisë historike.

Manzoni sheh tek epika prototipin e narracionit me sfond historik. Epopeja qysh në lashtësi dëshmon për njësim mes historianit dhe poetit.

Kur trajton raportin e veprës së artit me "normën", Fishta flet për formë ideale dhe legjitimon efektin kompleksiv të bukurisë së sendeve të rruzullimit të dukshëm. "Në ket veprim mundet ndonji herë me marrë elementa edhe prej rruzullimit të dukshem, sodomos prej sendeve në shumicë qi apin efekt bukurije kompleksive: si nji poet klasik, po zâmë, qi merr elementa prej poezijet popullore, per të trajtuem nji kangë letrare e artistike." (*Hijeve të parnasit*)

> Koncepti i Manzonit për Romanin historik do mund të na ndihmonte për të specifikuar pozicionin e poemës "Lahuta e malcìs" si epos në modernitet, përkundrejt burimeve përkatësisht klasike dhe popullore, duke i tejkaluar ato dhe duke ia nënshtruar veprën një funksioni që i përgjigjet bashkëkohësisë historike.

Ndërgjegjësimi i Fishtës për veçantinë e poemës së tij epike, larg eposit klasik, qartëson dhe specifikon më shumë tipologjinë romantike të veprës dhe funksionin thellësisht social të saj në lidhje me krijimin e gjuhës letrare.

Gjuha e folklorit është themelore: "'folklores' do t'i siellesh, po desthe me shtue pasunín e gjûhës me fjalë të permvehtsueme, me frazeologí shprehsore, me shembulltyra të gjalla, dramatike; në 'folklorë' prap kè me ndeshë më type mâ të nalta, më karaktere mâ të forta, e më motive mâ t'ardhuna e të perkueshme per zhvillimin e leteratyrës komtare. ("Parathâne", Kanuni i Lekë Dukagjinit)

Fishta është larg çdo paragjykimi për gjuhën, duke mbështetur idenë se forma e fjalës legjitimohet në përshtatshmërinë e saj semantike. Me një përmasë të natyrshme prej filozofi të gjuhës, Fishta, duke arsyetuar për "zejën e fjalës", thekson qartë lidhjen e pandashme të idesë me shprehjen e mendimit: "Arsyeja âsht, pse, tue kênë fjala hija e pasqyra e idés, sá mâ mirë e mâ plotsisht t'a shprehë idén, aq mâ i bukur e fuqishme ajo âsht në vedvedi."

Edhe Manzoni kur flet për rregullat gramatikore flet për "mënyrë që t'i korrespondojë një rendi të nevojshëm të mendimit" dhe për të qëllim i gjuhës është gjuha e folur, ajo e gjallë.

Gjuha e Fishtës, ashtu si gjuha e Manzoni-t, ishte e kuptueshme nga njerëzit e thjeshtë: "ajo që është e vërtetë sipas të drejtës natyrore, është e vërtetë edhe sipas Ungjillit", citon Manzoni-n De Sanctes-i.

Në stil të poemës epike, Fishta zhvillon formën e tij letrare si përgjigje ndaj fqinjëve dhe fuqive të mëdha duke i dhënë zë kështu të drejtës natyrore në themel të poetikës së tij ideologjike.

Fishta është i bindur për funksionin social të gjuhës poetike dhe nuk është i rastësishëm (me shumë gjasa burim manzonian dhe pse jo, cesarotian) citimi i De Radës në incipit të *Mrizit të Zanave* (Shkodër, Shtyp "Zoja e Paperl", 1924): "Di molte lingue la cultura pare che sia cominciata dalla Poesia, al modo che le creazioni stesse del linguaggio devono quasi essere di poetica aspirazione." (G. De Rada, *Antologia albanese*)

Si përfundim, prerje të kësaj natyre na ndihmojnë jo vetëm të ndërlidhim në sistem dhe funksion autorët më të rëndësishëm të romantizmit shqiptar, De Radën dhe Fishtën, por edhe t'i vendosim ata në rrafsh mbinacional duke i çliruar nga hipertrofizimi i përmasës kombëtare.

Receptime të këtij lloji janë të natyrshme në gjeni të përmasës së Fishtës duke mos e pranuar termin "ndikim" i cili nxit debat shterp ndër ata që mundohen ta parrokializojnë autorin mbarëshqiptar.

Me rastin e 150 vjetorit të lindjes së Atë Gjergj Fishtës, "ExLibris" po boton disa nga shënimet e Faik Konicës për Të, qysh nga njoftimet e hershme rreth "Lahutës së Malcis", deri te polemikat dhe kundërshtitë mes dy shqiptarëve të mëdhenj.

# Mes kritikave dhe lavdërimeve: FAIK KONICA PËR ATË GJERGJ FISHTËN

Përgatiti për botim Andreas *Dushi*

*Shqipëtari është shumë duar-gjerë me lëvdatat; por kur quajmë vjershëtor të math, një bërës tototosh e tatatash, ç'fjalë do të na mbetesh për Gjergj Fishtën?*
Faik Konica

Duke ndjekur në linjë kronologjike shkrimet ku përmendet Atë Gjergj Fishta, vëmë re se për të parën herë në rrafshin e krijuesit, ndër të parët që shkruan për të është Faik Konica në të përkohshmen "Albania", drejtuar prej tij. Bëhet fjalë për vitin 1905, ku me anë të një njoftimi, tregohet se në redaksi ka arritur bleni i parë i *Lahutës së Malcis*:

*Muarme këto fletore e libra: 1. "La questione Albanese", e përkohshme italisht ci filloj të dalë në Buenos – Aires. – 2. "Milosao, poema lirico", vepre e njohur e Radës, të cilën e përktheu në vjersha italisht X. Dinatello Nive. – 3. "The burden of the Balkans", liber i Xogun. Edith Durhan, të tsilin po e kritikojmë në këtë numër. – 4. "Lahutën e Matlsies" për të tsilen gatitme një artikull për numër t'afërm.*[1]

Po atë vit, në numrin 7 të revistës, në një shkrim që i përgjigjet gazetës *Drita* që botohej në Sofje lidhur me idenë e shtruar prej tyre se *lahuta cenka nje fyell*, Konica bën me dije se autori po përgatiste pjesën e dytë të veprës së tij:

*Auktori i* Lahutës së Maltsies *është duke gatitur edhe të dytën pjesë të këtij libri ace të pëlcyer. Sa ka cen' i pëlcyer, munt të kuptohet nga tsa fjalë ce po hecim prej një letre ce muarme tani shpejt: "Të katër tsopet e Lahutës i kam nis për Shcypnie, ci le t'i shpërdajn ndër Male, se jan fort të mira mer me u 'nex gjakun Shcyptarve."*

Vlerësimi i Konicës për Fishtën është tejet i veçantë! Në shkrimin e tij tejet të njohur për Naim Frashërin, pasi e trajton me ironi qasjen që i bëhet atij nga bashkëkohës, studiues, shkrimtarë dhe lexues, thotë mes të tjerash se assesi nuk mund të quhet një vjershëtor i madh Naimi, duke e cilësuar si bërës *tototosh e tatatash*, pasi, po t'i bëhet atij një vlerësim i atillë, ç'fjalë mbetet për Fishtën, çka nënkupton se vlerësimi i tij për të është shumë më i madh.

Mes tyre, marrëdhënia ka qenë komplekse, ku gjithnjë, pavarësisht rrethanave dhe ngjarjeve që e kanë shoqëruar dhe krijuar, ka mbizotëruar dashamirësia. Pak vite më parë, Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë iu dhurua një pjesë e madhe e bibliotekës personale të Faik Konicës. Mes librave të ardhur, është edhe një ksombël e veçantë e *Lahutës*, botim tejet cilësor për kohën, me dedikim në gjuhën latine nga vetë autori.

Gjithsesi, pavarësisht kësaj, dy vjet më vonë, rëndë dhe me ironi, Konica do ta kritikonte Fishtën. Duke u ndalur në një shkrim të tij, botuar në *Hylli i Dritës* ku mes të tjerash thotë: *Mbas endimit t'em, pra, lypet qi ky i Nalti Kshill Komtar të shuej: a) Kshillin e Epër Arsimuer, i cili asht si nji mulla m'qafë të shtetit; b) credit-i për shpërblime auktorësh: s'ka auktorë, mos të ketë as shpërblime; c) credit – i për bandën e Korçës, e d) prej credit – it 30.000 Franksh ar për formim librash shkollorë t'epen vetëm 15.000, e kta jo pse un besoj, se me kët credit ka me u formue ndonji libër shkolluer, por pse Ministrija e Arsimit mundet me u gjetë në nevojë, qi me rishtobue ndonji asi librash, qi der m'sod kjenë përdorue nder shkolla t'ona.*

Me nënshkrimin, F. K., përgjigjja për të është:

*Jo vetëm vjershëtori i Iliadhës, po edhe vjershëtore më të vegjël dremitin nga nonjë herë. Një nga këta vjershëtore është dhe miku ynë Gjergj Fishta. Në një numër të funtme të revistës* Hylli i Dritës*, At Gjergji i këshillon Guvernes të shuaj nga budgeti një ndihmë 10.000 frangash ar ($2.000) që Guverna ka vendosur për bandën "Vatra". Çudi! Në vend që të kërkojë të shtohet ndihma, dhe në qoft' e mundur t'u zgjatet dora edhe shoqërish muzikale të tjera kur këto shoqëri stervisin popullin me muzik klasike, At Gjergj Fishta i këshillon Guvernes të mos ndihhe. Të lëmë me nj'anë çdo argument tjatër në favore të bandës "Vatra", - po At Gjergj Fishta vall' a di që Prefektura e Korçës i jep Shtetit 30 për qint nga gjithë t'ardhurat e Shqipërisë dhe që kjo provincë e pasur ka të drejtë të presë se një pjes e vogël e atyre t'ardhurave do t'harxhohet për shvillimin kultural të saj?*

Kjo nuk është e vetmja polemikë mes tyre. Një tjetër, e mëpërparshme, menjëherë pas Kongresit të Manastirit është shumë më e rëndë. Konica e quan atë Kongres ***Kongresi i Shqipëtarve Xhon – Turq në Maqedhonie*** dhe, duke e përshkruar, flet për Kongresin e Alfabetit. Për ata që e përbënin e tij, jo pa ironi, thotë:

*Këta Shqipëtarë (apo a të thom, duke imituar një fjalë të Nietzches, këto Siper – Shqiptarë, se me të vërtet kanë dalë permi të tjerët duke shpënë në një lartësi të çuditshme gjithë vetijat e mira të kombit t'onë: besën, taktin, hoboresinë, kontemnimin e dinakërisë anadollake, etj.) u mbyllne në një odë dhe pas shumë dhembjesh pollne këtë kryevepre:*

***Kombi Shqipëtar të ketë jo një abee por dy.***

***Njera, abeje e Stambollit, me dy a tre ndryshime pa rendese, për përdorimin në Shqipëria***

***Tjetra, e cila i shëmbëllen shumë asaj që përdori kohërisht Albania më 1987, për përdorim jashtë***

Konica tregohet tejet i ashpër me këtë vendim, i cili ishte mbrojtur nga Atë Fishta. Tek ndalet pikërisht këtu, shkruan:

*At Gjergj Fishta e mbrojti këtë dysie duke thënë se "ashtu ngjan edhe për Gjermanët", të cilët kanë abene gothike dhe abene romane. Ky argument, të cilin e kam dëgjuar edhe tjatër herë (besoj i pari q'e përdori ish Rada), është shum i dobët. Analogia është fare e lajthitur; se ndryshimi i abese romane me gothiken në gjuhë gjermanishte është vetëm një ndryshim shtylle shtypografike; ndryshimi në mes të dy abeve shqipe të "kongresit" xhon – turk, është për kundre një ndryshim orthografik.*

Çështjen e Kongresit të Manastirit e kemi trajtuar edhe më para (*Shih "ExLibris", nr. 106, 21 nëntor 2020, fq. 2 – 4*) duke trajtuar se si ndërkallen idetë e dhëna për të arritur në atë rezultat, të papranueshëm nga Konica. Ama, historia tregoi, me sa duket, se Fishta pati të drejtë. Largpamësia e tij e orientoi drejt bindjes se me kohën, alfabeti arab do të largohej vetvetiu dhe njerëzit nuk do ta përdornin dhe gjithë shkrimi shqip, do të përqafohej nga ai latin. Sikur mos të bënte këtë marrëveshje atëherë, punimet e Kongresit do të vazhdonin pafundësisht dhe nuk dihet nëse do të dilnin me ndonjë rezultat konkret.

Akuzat e Konicës për të dhe të tjerë anëtarë të Komisionit të Alfabetit (Komisioni përbëhej nga Atë Gjergj Fishta, Midhat Frashëri, Luigj Gurakuqi, Gjergj Qiriazi, Dom Ndre Mjeda, Grigor Cilka, Dhimitër Buda, Shahin Kolonja, Sotir Peçi, Bajo Topulli, Nyz'het Vrioni) janë kaq të rënda, edhe pasi ai nuk mendonte se ata ishin përfaqësuesit më të denjë. Sipas tij, ky komision mund të përbëhej nga Fan Noli, Anton Zako Çajupi, Aleksandër Stavro Drenova, Giuseppe Schiroi, Milo Duçi, Visar Dodani, vetë ai, pra Konica, atë Gjeçovi, atë Pashko Bardhi, dom Ndoc Nikaj e të tjerë.



*

Sikurse e përmendëm dhe më lart, pavarësisht të gjithave, raporti mes tyre ishte tejet i afërt. Mjafton të lexojmë *Ca kujtime mi At Gjeçovin* ku ndër të tjera, ai shkruan *A i vemi musafirë At Gjeçovit nonjë ditë të kësaj jave? më pyeti një herë At Fishta me të cilin piqesha çdo ditë në Shkodrë.* Bëhet fjalë për vitin 1913 të cilin Konica e kaloi në Kolegjin Saverian të Shkodrës, kohë gjatë së cilës u miqësua me intelektualët më në zë shkodranë të periudhës.

Në librin *Shqipëria: Kopshti shkëmbor i Evropës Juglindore*, kur trajton letërsinë shqipe, për Fishtën shkruan:

*Do të përmend para të gjithëve Gjergj Fishtën, një françeskan i lindur në Zadrimë, i cili nuk është vetëm poet; ai, gjatë një të katërt shekulli, ka qenjë një udhëheqës intelektual me influencë. Atë Fishta e ka treguar zotësinë e vet në çdo lëm të letërsisë; ai ka shkruar poema, komedi, dhe të gjitha i kanë dalë me sukses. Por, jashtë kufijve të Shqipërisë, ai njihet vetëm si autor i "Lahutës së Malësisë", një poemë baritore kalorësiake. Përkthimi në gjermanisht, i botuar disa vjet më parë në Laipcig, të jep vetëm një ide të zbehtë të origjinalit, sepse muzikaliteti i ritmit të Fishtës dhe koloriti i fjalëve janë të papërkthyeshëm.*

Faik Konica dhe Atë Gjergj Fishta, nga larg dhe afër e vlerësuan gjithnjë njëri – tjetrin, e një formë e vlerësimit është edhe duke e kritikuar, pasi kritika nga të tillë njerëz janë tejet të vlefta, tregojnë se ata e kanë marrë shumë seriozisht punën e tjetrit e për këtë arsye, nuk do të kishin si të mungonin përqasje të atilla që tregojnë mosdakordësi, por gjithmonë shoqëruar prej asaj dashamirësie të drejtuar kah dëshira për përmirësimin, sa të vetes, po aq edhe të tjetrit.

*Albania* dhe *Dielli* bashkë me *Hyllin e Dritës* shërbyen për shumë kohë si arena të mendimit letrar, kulturor, politik, filozofik e fetar dhe përplasje e mendimeve të askujt më shumë se ata të Konicës e Fishtës nuk mund të sillnin dobi më të madhe ndër këto lamie.

[1] Konica, Faik, Fleta e Drectorit: *Albania,* London, nr. 1, 1905, fq. 7.



# Skicimi i Atë Gjergj Fishtës si kryeredaktor nëpërmjet një polemike

Janë një sërë të përkohshmesh letrare, revista e gazeta të drejtuara nga Atë Fishta, nga shpallja e pavarësisë, deri në fund të viteve '30. Shpesh atij i atirubuohet vetëm drejtimi i *Hylli i Dritës*, por kjo nuk është vetëm një pjesë e kontributit të dhënë prej tij në këtë drejtim. Prandaj sot, është e udhës ta kujtojmë atë të lidhur me dy të përkohshme të tjera, *Posta e Shqipnis* dhe *Ora e Maleve*. Do ta bëjmë këtë, bazuar fillimisht në një polemikë që dr. Marash Ivanaj, në të përkohshmen "Republika", nr. 4, drejtuar prej tij, i bën *Orës së Maleve* duke shigjetuar edhe atë që ai e quan pararendëse të saj, *Posta e Shqypnis*.

Këtu në Shkodër del nji fletore qi thotë se âsht vegla e katolicizmit dhe e katolikve. Deri ku këta âsht e vërtetë na nuk duem ta caktojmë. Thona vetëm na se po t'ishte me të vërtetë âshtu, na nuk do t'u merrshim me të, tue mos kenë, piksparit fletorja jonë vegël feje as krahine. Por si duket, e vërteta âsht nji o tjetër: ajo fletore nuk asht për katolicizmin, qi kurrë në Shqipni e ka pasë liriën qi e ka sot: ajo fletore don të pasojnë si vegël e katolicizmit vetëm për me mujtë mâ mirë me i fshehë planet e atyne njerzve qi mbetne kurdoherë koerent: vetëvedit e veprimit të vet, kjoft se këtu, në kët Shkodër shqyptare urdhënon Turku, Slavi, Austriaku a Italiani.

Sot jena të shtrënguem të merrena pak me këtë fletore, qi nji nuk âsht fetare, as patriotike, as njerzore, por vijimi i nji tjetrës fletore, qi botohej prap këtu në Shkodër, në vjetët 1916, 1917, 1918: me gjithë at tipografië, me gjithë at Redakcion, me gjithë at direkcion o drejtim. Kush e ka lexue at fletore – din mirë me çfarë çashtjesh ajo merrej. Gjithkëta thona edhe për fletoren qi botohet këtu, e cila mbas pak kohe vorri moral e politik të disave, të cillët si duket, koha e kalueme nuk i ndalë nga çdo veprimit politik: në të saja 33 numra s'ka asnji rresht në projë të katolicizmit, por vetëm denigracione, çpifje dhe afermacione pa temel. Âsht nji fletore thjesht politike, por e asaj politike, qi popullsis shqyptare a sidomos Shkodrës ende Maleve të saja i ka kushtue shtrejtë kahë ç'do pikpamje.

Me gjith këtë na sot nuk do t'u merrshim me kët fletore dhe me njerz qi e shkruejnë (sepse për ne, sikurse do të jenë shpejtë për popull, ata janë trupna të dekun politikisht e moralisht) mos të kishte pasë guzimin me e ndye emnin e fletores s'onë në shtyllat e veta.

Na nuk duem të përgjegjem insinuacioneve të këtyne njerzve, për të cillët nuk âsht gjâ e shejtë në kët botë, sepse na jena paditsit e ata të paditunit: 3 numrat t'onë e diftojnë i cilli âsht pozicioni i ynë ndaj qeverien e sotshme të Shqypniës, 15 vjetë të kohë s'kalueme të Shqypniës s're e diftojnë i cilli prej dy parimeve: Ballkani Ballkanikve ase Shqypnia e ... Europës âsht mâ i mirë, koha e ardhshme – e ndoshta jo e largshme – do t'ë shfaqë i cilli Shqyptar kje dhe asht i huej jo vetëm për Shqypniën, por ende për Shkodrën.

Por mbas sodit mos të vijnë për me na thanë se janë projtësit e katolicizmit ende... t'atëdheut.

Në fushë politikë jena e në fushë politike do të mbetena.

Sa për sot thona se parzmat t'ona janë përpara këtyne njerzve: do të shofim kuj prej nesh ka me ju dâshtë të sjellin shpindën...

Por këtu nuk e vejmë pikën.

Dr. M. IVANAJ

Menjëherë pas këtij shkrimi, redaksia e *Hylli i Dritës* boton në *Ora e Maleve* një përgjigje ndaj tij. Pasi citojnë për çfarë bëhet fjalë në shkrimin të cilit po i përgjigjen, fillimisht merren me autorin duke e quajtur *nji Don Chisote i ri*. Më pas tregojnë se si deputeti Nikollë Ivanaj, pak vite më parë, kishte firmosur një letër në të cilën, ndër të tjera, shkruhej për drejtorin e "Postës s'Shqypnis", pra Atë Gjergj Fishtën *se pat mprojtun me nji* ***atdhesi t****ë* ***nxeht****ë e me nji mjeshtri t*ë *hyjnueshme t*ë *drejtat e komit shqyptar*. Duke ballafaquar këto dy thënie, ngrenë pikëpyetjen se cili prej Ivanajve nuk ishte i sinqertë në atë që thoshte.

Po në atë shkrim bëhet e ditur se si, në vitin 1918, qytetarët e Berati, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit i patën dërguar një pendë arit drejtorit të *Postës* si shenjë nderimi për veprën patriotike e njerëzore që po zhvillonte e përkohshmja e tij. Gjithashtu, aty thuhet edhe se, në nëntorin e po atij viti, kur gazeta u mbyll, disa të krishterë e mysliman i patën dërguar atë Fishtës një letër ku shkruhej:

*Ty, qi der më sot ke kenë shkëlximi i letresis s'onë me sa vepra të nalta qi ke botye: ty qi gjithmonë ke spikatë për dashtuni t'Atdheut, tue derdhë djerzë e mund për të, të nënshkruemit të sjellen tue Të lutun, qi mos me ndal në veprimin t'and, qi kahmot ke fillue per zhrivillim e perparim të komit t'onë, sidomos n'at veprim politik – letrar, qi per gati dy vjet rresh ke krye në* ***FLETOREN E NDERSHME*** *"Posta e Shqypnis". Tue çmue mundin e Zotnis s'Ate, marrim lejen me t'u lutun, qi në ket kohë kaq kritike për komë t'onë të dashtun,* ***të vijosh botimin e fletores*** *sidomos nder kto dit, nder të cillat do të dajet fati i Atdheut t'onë."*

*Ndoc Çoba*
*e 43 firma të tjera*

Më tej, shkrimi vijon:

*Kundruell ktyne dokymentave, sa pare bajnë artikujt e "Repiblikës"?... – Kta dkumenta djinden në Redakcjon të "Hyllit të Dritës".*

*Shifet kjartas pra [...] asht z. Dr. M. Ivanaj qi nuk vlet të verteten. "Posta e Shqypnis", prandej ka kenë nji fletore patriotike e njerzore...*

*Ne nuk e kemi zanat me predikue vedin, por vetëm Fenë, Atheun e Kulturen; prandej kta dokumenta nuk i botuem për tjetër, veç pse, tue pa se z. Dr. M. Ivanaj po ishte, me gjasë, krejt i ri e axhami nder çashtje t'ona komtare, deshtem m'e çue me turi shi m'emen të themeluesit e të pronarit të fletores "Republika"; qi kshtu të msohet tash e brapa, mos m'e ndye opinjonin publik me dyshime të pathemelta ndaj vepres komtare të njanit a të tjetrit institucjon t'Atdheut t'onë.*

Sod nuk po i apim fjalës ma pertej, pse po na bjen në mend nji kshill, qi dikuer na vetë ja u kemi pas dhanë Shqyptarve, shka merr prej kufinit të Trjepshit e tektej, e qi tingllon kso dore:

T'huejn me fjalë mos t'a poshtnoni;
Buken para, por, t'ja shtroni,
N'Shqyptari si asht kenë zakoni:
**Me i besue, mos i besoni!**

*

Marash Ivanaj përgjigjet sërish, në numrin e radhës të *Republikës* duke ia bashkangjitur përgjigjes së tij, edhe një shkrim të Nikollë Ivanajt, përdorur nga hartuesit e "mbrojtjes së Fishtës", pra redaksia e *Hyllit* si argument në mbrojtje të tezës së shtruar prej tyre. Nga sa rezulton sipas bibliografive, me aq u mbyll kjo polemikë.

E sollëm në këtë trajtë, sot në 150 vjetorin e lindjes së Fishtës për të treguar, në një mënyrë jo fort të zakontë, një tjetër anë në spektrin e poledrisë së tij, atë të kryeredaktorit dhe drejtorit të një gazete. Në atë kohë, kur funksioni i shtypit ishte i një rëndësie të veçantë, drejtimi tyre merrte një tjetër peshë, shumë të rëndë e të rëndësishme në formimin e qytetarëve shqiptarë. Duke qenë se sot, kjo përmendet shumë pak, kryesisht veçse si element biografik, menduam ta trajtonim kështu, këtu.

4 ETYDE:

# LIBRAT – KUMTE TË MREKULLUESHËM

*Nga Xhevair Lleshi*

### 1. ÇDO DITË PANAIR LIBRI

Një ditë me libra në TEG. Kjo ishte zanafilla. Pastaj një artist i menaxhimit të librit si Albert Gjoka, njohës jo i zakonshëm i letërsisë, e bëri me formulën «Disa ditë në vit me panaire libri në TEG». Kurse këtë të diel, teksa isha me të, më dha kumtin mrekullueshëm: «Miku im, çdo ditë e vitit do të jetë panair libri në TEG! Nuk bëhet fjalë ndryshe!». Na kishte mbetur ndërmend, si rrallë ndonjëherë, kjo dëshirë e pamundur, që, kërkonte aty - këtu ndonjë organizator të talentuar. Kjo ngaqë e merrnim lehtë, pothuajse nuk e vinim re, po mrekullisht do të vinte një burrë që t'i dilte për zot librit, zotër që rëndom bien në sy, sepse çdo fjalë dhe kërkesë e tyre na bezdis dhe jo pak. Albert Gjoka është krijuesi i Bukinistit. Një qenie krejt transparente, pothuajse e ajërt, i cili bën frymë vetëm pranë librave, por që gjithmonë vjen dhe ikën pa u dukur. Kur je me të sikur buron vetëm ide për librin, dhe ta vë veshin me aq kënaqësi, vetëm kur bashkëbiseduesi i tij është i kënduar, njeri i librit. Aq sa nuk ke si të mos ndjesh njëfarë dhembshurie për të, ndonëse pak të egër, po edhe një nxitje për t'i dhënë një shuplakë asaj fytyre të bukur. E bukur prej librit, domosdo. Alberti me idetë e tij që libri dhe vetëm libri të mbizotërojë, dëgjon edhe batërdinë e fjalëve tona, mbase edhe ato thjesht artistike, por gjithmonë me sy të ndritshëm e aq magjepsës, padyshim shto këtu edhe trillet tona.

Njerëzit, sidomos familjarë, prindër me fëmijët e tyre në mes librave, në labirintin e sajuar në një sallon të madh dhe elegant, me të gjitha librat e botuesve, studentë dhe paraadoleshentë.

- Jam i shqetësuar, - thotë Berti, - Pas një kohe të shkurtër në klasat tona të para nuk do të ketë as dhjetëmijë fëmijë! Më beso! Dhe të mendosh që në mes të viteve tetëdhjetë deri në mesin e nëntëdhjetës kemi pasur tetëdhjetëmijë fëmijë për çdo vit ! Pra, s'linden më fëmijë, ose më saktë s'ka më prindër të rinj! Dhe kjo po ndodh krejt para syve tanë! Ah, po, ne kemi mjaft pallate shumëkatësh, shtypshkronja edhe moderne, radio, tv, reklamë, rrjete interneti dhe portalesh! Pasuri e madhe, por pa fëmijë është kot. Jemi thjesht të vdekur të pakallur. Jeta i ngjan pemës së ullirit, çelin filiza të rinj, bien edhe gjethe, por pema është kurdoherë plot gjelbërim gjithë jetës! ...

Po shihja një grup fëmijësh vërsulur librave të tyre. Nga mëngjesi deri në darkë aty. Të lirë, në një hapësirë me librat! Ditën tjetër? Dihet, në natyrë! Eh, në natyrë do të qe mirë, por ku të lënë telefonat celularë të jesh bërë një me natyrën dhe lodrat!? Aty, me telefonat, hahet mëngjes ,drekë e darkë! Me telefonat dhe me librat do të ishte më mirë! Me telefonat, librat dhe me natyrën, lodrat e shumta do të qe ku e ku më mirë! Kjo gjendje ku jemi na fut në grindje, na lodh brenda një rrethi vicioz që ngushtohet, mosha na ikën dhe një ditë papritur do të kujtohemi se fëmijëria na qe vjedhur, bashkë me të gjitha ato që e shoqërojnë, trallisje, elegancë, gëzim, bukuri e pamend, dashuri të skajshme, se më pas s'do të kishim as përgjegjësi jashtë letrare për fëmijët që tani janë rritur.

Aty në panairin e librave të gjithmonshëm në TEG ka edhe shkrimtarë buzëhollë të çdo moshe, që siç thotë miku im që më shoqëron merren me limat, limat e fjalës me të cilat limonin imët me vite e vite fjalën! Ata duan edhe s'duan që të ketë sa më shumë novatorë të një arti të madh që t'i bëjë për vete fëmijët dhe të rinjtë. Për njerëzit që nuk lexojnë më, po bëjnë sikur lexojnë, hiqen si miq të librit dhe që Albert Gjoka u jep statueta dhe medalje për t'i afruar, sepse vetëm një si ai mund t'i sjellë afër miqtë e librin, duke i veçuar për t'i hedhur në koshin e plehrave ata që mashtrojnë. Po kemi, sigurisht që kemi, edhe mashtrues të librit.

- Nuk është pak si e pabesueshme që një njeri si ju të mos këtë miq?

- Aspak. Tek unë vijnë vetëm miqtë e librit.

- Po ne, a s'jemi miqtë e tu?

- Po, juve po! Ju i shkruani librat, edhe pse jeni të gjithë jashtë mode, se nuk ju do njeri. Ata që rrinë me ju duket se u pëlqen letërsia, librat. Mes veti kini talentin. Me ju mësova se si mund të shfrytëzoheni shpejt e lehtë sepse kështu luhet më mirë me famën. Me ju, o vërtet të talentuar, mund edhe të përfitohet më shumë dhe të mos u jepet aspak. Sepse juve ju vlejnë idetë dhe kënaqësia e të shkruarit! Dhe vetëm kaq!...

Librat tanë? Po ato nuk shiten shumë, me gjithë përpjekjen e Albert Gjokës! Se ndaj ky njeri kërkon të ketë sa më shumë fëmijë shqiptarë. Tani po fillojmë të numërojmë fëmijët tanë, fëmijët e fëmijëve tanë që lindin nëpër botë dhe kurrë s'kemi për t'i pasur pranë... Me dhimbje. Po edhe dhimbja u dashka! Duket për t'ia lëruar t'ëmën kësaj jete!...

### 2. MARATONA E TIRANËS. PO MARATONA E LIBRIT?

S'ka rëndësi që të jenë apo të mos jenë edhe librat në një maratonë! Dhe unë këtë indiferencë prisja. Edhe pse u fillua një punë e bukur ajo u la në mes. Para ca kohe kur u paraqit i vetmi libër për fëmijë në pllaka metalike të holla, si faqe të zmadhuara libri, pati jehonë dhe u mirëprit, edhe pse pa maratonë. Sak, them se nuk e ka fajin maratona në pistën rreth e qark liqenit dhe Parkut të madh! Apo nuk qe thjesht e organizuar bukur dhe me praninë e televizioneve nga Evropa, maratona me praninë e maratonistëve nga shumë vende dhe mendo, që aty do të qenë të paktën dy libra vizatimorë, ose kopertinat e librave të rinj që paralajmëronin Panairin e Tiranës! Pastaj kjo do të qe maratona e vetme në botë e shoqëruar nga librat, ose kopertinat e tyre! Ndërkohë të gjithë të pranishmit do të mësonin se pas dy vitesh do të kemi Panairin e Librit!...

Natyrisht, libri është një risk. Mund të prishte maratonën, sidomos në këtë demokracinë tonë të djegieve. Po këtë edhe si reklamë, domethënë me pagesë të botuesve, mund ta sajonin ata, se tani bulevardi më i madh e më i kulturuar është Unaza e Parkut të Madh, që thith gjithnjë e më shumë shikues që ecin në këmbë. Bulevardin e madh e ka përpirë smogu dhe protestat e vobekta para kryeministrisë sonë. Sigurisht jo si tamtame për kuzhinën e secilit për librin. Se pastaj di ajo si e qëndis...

Ta linim për mot më mirë, sepse do të jetë Maratona e Vitit 2022, se me tre dysha s'do të jetë vit tjetër, kurse me katër dysha do të jetë edhe më e rralla, 2222, por pas dyqind vjetësh. Mendo! Se mot Tirana do të jetë kryeqytet i rinisë evropiane, por pa rininë e saj, sepse rinia ka marrë rrugët e botës...

Maratona mbaroi me sukses kurse maratona e librit u fishk që në ëndërr.

E solla nëpër mend thënien e një mikut tim: Të shkruash dhe të shpresosh se ke bërë diçka, përmbledh esencën e gëzimeve më të fuqishme që kurrkush s'i ka përjetuar kurrë.

Shoqëruar natyrshëm edhe me zhgënjimin më të madh...

### 3. LUSHNJA, FASLLI HALITI DHE LIBRI

Ti kurrë s'mendove për të, për Lushnjën dhe Faslli Halitin! Unë mendova gjithmonë se *ai* famën e donte të përbotshme. Kurdo që të vinte. Se ai kurdoherë thoshte se i donte të gjithë atje dhe kudo, se edhe ata e donin shumë. Atë ditë të përurimit të veprës së tij unë e pashë me sytë e mi. Kishin ardhur të takonin Faslli Halitin, Veprën e tij të botuar nga «Uegen»... si një kënaqësi nga dhimbja.

Dhe kjo është e vërtetë. Sepse kjo dhimbje për Poetin është si një mjegull dhe kjo nuk është çarë ende. Dhe letërsia e tij e veçantë ecën. Është një letërsi e bukur, e thjeshtë, një shkrim që e ndjek kohën. Do të jenë edhe dhjetë vepra të tjera. Jetën e keni aty, të përfshirë me një zemërgjerësi dhe hapësirë të jashtëzakonshme. Dhe mbetet idhujtaria për Faslli Halitin. Mjeshtri me shumë dishepuj.

Ja ç'më shkruan Ronad Gjoza *Ditën e Përurimit*:

*«BALADA E NJË VEPRE QË ZOTËRON ENERGJINË DIVINE*

Ja ç'do të thotë baladë. U krijua dhe një baladë e re për folklorin. Jo ai klasik, rural, po ky i sotmi, modern. Balada ka dhe një shteg të padukshëm që të çon te mbretëria e saj. Pata fatin të jem unë që e zbulova atë shteg. U nisa dhe mbërrita si në përralla tek ai pallat mbretëror. Mirësia. Premtimi i mbajtur. Dy njerëz, njëri, që e mbante thesarin në zemrën e tij të madhe, tjetri që i kërkonte një nder; jam shkrimtar i varfër, dua të botoj librat, po s'kam!

- E ç'të bëj unë për ty? Dua të botoj në një kollanë të gjithë librat e jetës sime. Pastaj të vdes i qetë. Njeriu që kishte në zemër thesarin e mirësisë, nuk i dha përgjigje menjëherë. Të gjithë duan të mbeten. Të gjithë e duan fundin e lumtur. Po ajo nuk realizohet për njeriun, është e pamundur. Ajo realizohet për idenë ideale. Ai që e zotëron energjinë divine, dhe ky njeri që lutej e kishte atë, po nuk ishte dhe aq i vetëdijshëm, ka një këmbëngulje prej të marri dhe një fytyrë satiri që të bën hem për t›i dhënë dërrmën, hem për t›i hapur zemrën e thesarit. Po gjithmonë ka një dilemë, sepse bilancet kurrë s›janë individuale.

Po nuk pati shujte perëndie që të ngop, asnjë punë e shpirtit nuk kurorëzohet me skeptër e kurorë. A kanë shpirt që ushqehet me këtë shujte këta dy njerëz të pallatit mbretëror? A e ka arritur fundin e lumtur ky njeri që lutet? A e ka zemrën të hapur ai tjetri që zotëron atë pallat madhështor të nderit dhe besës? Të dy u ndanë me një premtim te pashqiptuar. Po ngjizej balada.

Ishte një keqkuptim me vetveten në një harmoni jashtë vetvetes. Ishte një kumt që vinte prej së panjohurës, një balancë e arsyes dhe ndjenjës, e altruizmit dhe absurdes. Duheshin bërë sakrifica në emër të një të ardhmeje të errët. A ia vlente që një pjesë e thesarit të bëhej fir në emër të një ideali që këto kohët tona moderne të mbushura me një materializëm të vrazhdë, nuk e pranojnë kurrsesi? Jo. Jo, ishte krejt e pakuptueshme. Njeriu i lutjes ende kishte shpresë, ndërsa ai tjetri donte ende fuqi për t›iu përgjigjur shpresës. Po ngjizej balada e një premtimi të mbajtur ose të pa mbajtur. Të dy u ndanë. A e kishte arritur ai njeri fundin e lumtur?

Kjo dilemë duhej ftillëzuar së pari, pastaj të vendosej nëse ai njeri që iku, e kishte shenjën e shujtës divine. Dhe kështu balada filloi të funksiononte lart, atje ku ëndrrat kanë atë blunë rrëzëlluese qiellore, se ëndrrat kanë punë me shenjtërinë. Kaloi kohë, një kohë e gjatë, se nuk është e lehtë të kurorëzohet një kalorës i lavdisë. Tjetri ishte i pavetëdijshëm për këtë që po ndodhte, por i mbushur me parandjenja të turbullta, që ke dëshirë t'i ndjesh dhe të mos ndahesh kurrsesi prej tyre. Të rrish dhe të presësh. Më mirë kështu ndoshta se sa përmbushja e një ideali. Po balada e donte dhe një imitim të modelit. Balada e premtimit të mbajtur. Dhe unë pashë një kalorës qe ngjalli një të vdekur dhe e çoi në lavdi...

Kjo s'ndodh sot, por të dy qëlluan të shujtës hyjnore. Le ta shijojmë si një baladë.

Ja, kështu më erdhi, mik, dhe unë kështu e shkrova. I pashë fotot dje, ty,

librat, fantazmën e lumtur, që u ngjall dhe mendova (për ty) se ky njeri, pëshpërita (unë, apo... prej jashtësisë sonë vjen një zë, si ato penjtë e marionetave, që i drejton krijuesi) prandaj e bëri se është vetë i kësaj shujte. Ndryshe s'kish se si.

Jam këtu para kompjuterit dhe të shoh ty në të njëjtin pozicion, me një shprehje dhe ndjesi sikur s'ke bërë asgjë. S'ka as pallat mbretëror, as baladë. Ke vënë buzën në gaz dhe thua me vete: prandaj e dua këtë djalë (për mua) se është i çmendur...»

Dhe folën të gjithë. I mbajtën ison baladës së Rolandit. Me lot në sy. Pastaj u larguan duke përkëdhelur librat. Po edhe duke ndjekur një intervistë të Poetit me Kozma Gjinin. Dhe ai përmend gjëra të fisme me gjakftohtësi të epërme. Edhe kjo hyn në të fshehtat e shkrimit. Sikur të thuash një Borges, një superlativë. Edhe përmend Kadarenë, Kafkën, Tolstojin, Buzatin, Gogolin! Gjëra të mëdha ndodhën atë të shtune të 16 tetorit. Elmaz Qerreti, Prof. Dr. Xhevat Lloshi, Bardhyl Dardha, Prof. Dr. Ramiz Zekaj - drejtor i IETT, një mësuese e vjetër, Valter Dauti, vajzat e gjimnazeve që recitojnë vargjet e Faslli Halitit...

Një buzëqeshje e Nirvanës, fjalët përshëndetëse të Helidon Don Halitit, Alfred Pezës, poetëve të tjerë të pranishëm, Anila Zurbo - mësuese në gjimnaz, kryetarja e bashkisë Lushnjë znj. Eriselda Sefa. Në përgjegjësi e bukur! Por mungonte Qendra Kombëtare e Librit dhe e Leximit, me gjithë ftesën dhe pranimin e saj. Dhe duam të kënaqim lexuesin edhe me dhjetë veprat e Faslli Halitit, me një dizenjim tërheqës të piktorit Helidon Don Haliti. Dhe botuesi «Uegen» duhet të ndihet mirë që librat e poetit do të jenë në nëntor në Panairin e Librit në Tiranë e më pas në promovime në disa bashki të vendit...

### 4. EKSPOZITA «LULANI-MUZE» NË MBRËMJE MAGJIKE TETORI

Prapë tetori i librave edhe për ekspozitat e pikturës! Por këtë radhë në Muzeun Historik Kombëtar. Fjalë të shkurtra. Belbëzime zërash. Maska. Pikturat e ekspozuara përkëdheleshin nga drita e butë dhe projektorët-pistoletë që i nxirrnin në pah me ëmbëlsi të veçantë. Në qendër njeriu, rrethana konkrete, malet, bora, kafshët shtëpiake, forca për të ekzistuar, brenda një kohe të caktuar, pa skrupuj, me dhe pa parime, që pse jo por janë më të këqija se gënjeshtrat, herë-herë duke jetuar në kohën e tyre edhe ideale, ku asnjëri nuk do t'i ndërronte kurrë kënaqësitë vulgare më një kënaqësi të vërtetë. Se përveç pikturave këtu mund të qenë edhe librat e shkruar për të, Ismail Lulanin, një nga penelat më të mëdha të Shqipërisë. Një libër jete e vepre, fin, elegant, i hollë e me njolla të forta që të ngrenë peshë dhe i japin dritë personalitetit të tij.

Ti, kushdo qofsh, vjen në këtë ekspozitë, me një ëndërr tënden dhe padyshim që e ndjen dështimin, por e fsheh, se s'ke qenë në gjendje të fitosh asgjë me pikturat apo librat e tu, ndërsa një bukuri e përzier, tronditëse, vjen aty me po ata miq gërnjarë e ziliqarë të cilët po ashtu bëjnë sikur jetojnë me ideale në një realitet krejt tokësor, ku natyrisht e ndjejnë fort kundërshtinë! Aty janë krejt të lirë të thonë me zë të lartë se janë Borges, Kafka e, Saramago, po edhe Ismail Lulani, duke numëruar më pas piktorët e mëdhenj, që janë të kthjellët dhe e dinë mirë që jeta është hipokrizi. Ndërkaq gjërat janë gjithnjë komplekse. Kushdo mund ta kuptojë se në rrethanat e një ekspozite pikture, qoftë edhe *Lulani-Muzé*, vënë në provë atë që ju e keni po nuk e përdorni, shqisën për të perceptuar me shumë largpamësi. Se ekspozitat nuk duan t'u mungojnë librat, edhe pse i zëvendësojnë katalogët! Vijnë, domosdo që vijnë edhe sharlatanë të artit. Më vonë artistët e mëdhenj që kanë vdekur të varfër. Fjalime me dhe pa art. Mbresa. Njerëz që shkrijnë jetën çmendurisht për artin, pa përfillur asnjë kënaqësi tjetër. Asketë. Dhe befas bëhen shenjtë që ndjejnë kënaqësi nga dhimbja...

- Kjo është tradhti prej miku! - thotë një mjekrosh i bukur. - Dikur s'guxoje të vije në ekspozita! Tani vjen dhe befas bëhesh edhe piktor i madh. Më dukej se Ismail Lulani buzëqeshte nga autoportreti, me një sarkazëm fine.

- E ç'rëndësi ka? Sarkazma ime nuk është kurrë absurde, e rëndë, vulgare...

- Si ç'rëndësi ka! Përse tallesh kështu?

- Për letërsinë, pikturën, dashnoret e mia!...

Salla e *Lulani-muzé* kumbonte prej zërit kozmik.

- Për të vërtetën e artit, të letërsisë!

- Sigurisht. Kjo më jep kënaqësi. Shpresoj deri në fund. Të tjerat s'kanë vlerë. Ose janë vlera të përkohshme. Ky është dallimi mes nesh. Ç'ta zgjasim më! Nesër sërish këtu, si sot!. Ndoshta takohemi sërish pas vdekjes. Madje kështu e lëmë. Ekspozitat e pasvdekjes!...

*Tiranë më 19 tetor 2021*

Nga data 14, 15, 16 Tetor në Teatrin Libero të Palermos u vu në skenë pjesa teatrale "Letra", me autor Ylljet Alicka dhe regjizor Salvatore Tramacere. E pritur mirë nga publiku palermitan, shfaqja pati një mbulim të mirë nga mediat lokale. Më poshtë është shkrimi i gazetës qendrore siciliane *Il Giornale di Sicilia*

# PJESA TEATRALE "LETRA" E YLLJET ALIÇKAJT, U SHFAQ NË PALERMO

**Il Giornale di Sicilia:**

## Marku dhe letra e tij që bën publikun të ëndërrojë

**Shfaqja "Letra" shfaqet dhe sonte në teatrin Libero**

Fjalët mund ta ndryshojnë një jetë njeriu... Madje, ato mund të dhurojnë atë që jeta nuk ka mundur të ta japë... Marku e zbuloi kur shkon te mësuesi i fshatit t'i shkruajë një letër për t'i dhënë një strehë në shtëpitë e ndërtuara nga kooperativa... Mësuesi ia shkruan dhe jeta e Markut përfundon në një copë letër. Marku vetë nuk di të lodrojë me fjalët, atij i duken atij mahnitëse, magjepsëse, përmbushëse, mjaft që t'ia rilexojnë letrën e jetës së tij një herë, dy herë, njëqind herë... Aq sa ta detyrojë të mos e dërgojë letrën për shtëpi, por të endet pranë shkollës së fshatit dhe t'u kërkojë nxënësve të saj t'ia rilexojnë letrën. Aq sa ta detyrojë të lutet për një abetare të vjetër, e cila bariut analfabet t'i shëmbëllejë një thesari të pafund.

Pjesa "Letra" mbështetet mbi një tekst të mrekullueshëm. Pikë!

Nuk mund të them asgjë më shumë, përveçse ajo është shkruar nga një shkrimtar, Ylljet Aliçka, mbi përvojën e tij vetjake si mësues fshati dhe që ai e ka përfshirë në një përmbledhje me tregime botuar dhe në Itali.

Dhe që aktori i ri Roerd Toçe e luan në skenë, me një hijeshi të pafundme, të lehtë, mbushur me një habi teatrore..

Monologu shfaqet dhe sonte në teatrin Libero, mos e humbisni, është realizuar nga regjizori Italian Salvatore Trameçere së bashku me përpunimin dramaturgjik të Giulia Maria Falzeas. Dhe prodhuar nga teatri Koreja i Leçes dhe teatrit Metropol të Tiranës.

Të bëhet sikur shikon një Mark teksa lutet t'i lexojnë jetën e tij në letër. Ato fjalë që me siguri ai i dinte përmendësh, por që nuk ngopet nga kënaqësia duke e dëgjuar atë nga të tjerat... Sikur kështu jeta e tij do ishte më e vërtetë.

Duartrokitje mëse të merituara!!!

(Vëllimi VI i veprës së zgjedhur)

# LETËRKËMBIMI I MID'HAT FRASHËRIT

nga Uran Butka

*"Një letër (përmbajtjen e së cilës, duhet jo vetëm ta ndjejmë, akoma ta shijojmë) për mua është një luks, një dëfrim i mendjes dhe luksi do nge, do qetësi, do një atmosferë të paturbulluar. Luksi i nxituar, degjeneron në grotesk. Shkoni dhe shihni qytetin amerikan Alantic City, ku harbutësia e një luksi të shpejtë e bën një kontrast aq të madh me bukuritë evropiane të shekullit XVII-XVIII"*

Mid'hat Frashëri

Letërkëmbimi i Mid'hat Frashërit përbën kurorën e meditimit, të veprimtarisë shkrimore dhe krijimtarisë së tij: aty shfaqen idetë e reja iluministe të tij në çdo fushë të jetës e të mendimit, sfidat dhe vendimmarrja e tij në ngjarjet kyçe të historisë së kombit, shqiptarizmi si platformë dhe veprim, përpjekjet titanike në mbrojtje të çështjes shqiptare në krizë, këmbëgulja e palodhur për zgjidhjen më pozitive të saj, humanizmi dhe evropianizmi si frymë e model, diplomacia si mjeshtëri dhe art, debati me argumente dhe logjikë të pakundërshtueshme, elokuenca dhe sjellja fisnike, bashkëbisedimi dhe polemikat me personalitete të shquara historike shqiptare e të huaja, përfshirë presidentë shtetesh, kryeministra, ministra, kryetarë forumesh kombëtarë e ndërkombëtarë, bashkëpunimi e bashkimi kombëtar, haxhiqamilizmi shqiptar, rreziku komunist, lufta për shtet ligjor dhe demokraci, miqësia dhe dashuria, por edhe kritika ekzistenciale, largpamësia, kultura sipërore, informacioni i gjerë dhe sensi zyrtar, por edhe intim dhe artistik i këtij letërkëmbimi.

Tre janë kulmet e kësaj pasurie epistolare: koha kur ishte anëtar dhe kryetar i delegacionit shqiptar në Konferencën e Paqes në Paris dhe në Lidhen e kombeve në Gjenevë në mbrojtje të identitetit dhe tërësisë teritoriale të Shqipërisë përkunder politikave pushtuese serbe, greke dhe italiane, por edhe kundër politikave imperialiste të Fuqive të Mëdha shpesh në mbështetje të tyre, si edhe në mbrojtje të popullsisë shqiptare të Kosovës dhe të Shqipërisë jug-lindore të okupuara padrejtësisht dhe të persekutuara deri në asgjësim; letërkëmbimi kur ishte ambasador i Shqipërisë në Greqi, ku mbrojti si askush tjetër çështjen çame, duke u përballur me politikat antishqiptare dhe antinjerëzore të helenizmit për shpernguljen barbare dhe shpronësimin e popullsisë shqiptare nga trojet e tyre në vitet 1923-1925; dhe letërkëmbimi erotik, që zgjati thuajse gjithë jetën, ashtu siç zgjati edhe dashuria e tij.

Dashuria e Mid'hat Frashërit ishte shpuzë e amëshuar, e mbuluar me hirin e jetës. Ai i caklon dhe i shpupurit me penën-pupël gacat, që vagëllojnë në një dritë të gjelbër dhe i derdh me mjeshtëri dhe art në letrat e tij. Dashuria e tij është e çiltër, e vetvetishme, e magjishme, emocionale. Ai e ka provuar atë me pasion më tepër se një herë, si njeri i lirë dhe i kulturuar, atë ndjesi të brendshme të patjetërsueshme njerëzore, atë prush që djeg e shqerr, si një dritë dhe terr, si shend e vuajtje, si poezi e si dramë, si forcë njerëzore që e çliron dhe e ndryshon botën.

"Dashuria, shkruan ai, është kondita e jetës. Po të mos ekzistojë ajo, shkatërrohet lidhka në mes të gjymtyrëve të njeriut, familjes dhe njerëzisë, zhduket shija e gjallërisë dhe e jetës. Pa dashuri s'ka enthuziazëm, s'ka shpresë, nuk kryhet asnjë vepër. Enthuziazmi dhe shpresa, bijat e dashurisë së sinqertë dhe të thellë, duhet të jenë si ata trëndafilë mëngjesi, që çelin çdo ditë të rinj, si ato lulet, që mbyllen natën, por hapen nën rrezet e para të diellit"

Letrat e dashurisë mes intelektuales rumune Angela Romano dhe Mid'hatit zgjasin e dokumentohen për 24 vjet me radhë, pak më tepër se letrat e dashurisë mes Balzakut dhe Princeshës Hanska, por edhe me një pathos të papërshkruar.

Pyetjes: Pse nuk u martua kurrë Mid'hat Frashëri, i japin përgjigje letrat e tij dhe të dashurave të tij.

E zhuritur nga malli dhe largësia, Angela Romano e grish në Bukuresht të dashurin e saj, ku i kishte të gjitha komoditetet që të jetonin së bashku "me idhullin e saj, shpesën e saj të parealizueshme", siç shprehet ajo në letër. Por Mid'hati zgjedh midis Angelës dhe Shqipërisë, këtë të dytën dhe ajo ia kthen: "Jam e lumtur për ty dhe për vendin tënd".

Mid'hati i përgjigjet së dashurës Emma: "Ti e di sëmundjen morale nga e cila unë vuaj, ajo mani për t'i analizuar gjërat, ajo ngasje për të gërmuar përherë në thellësi të tyre, duke dashur të shoh larg, ta konsideroj shumë shpesh të tashmen si preokupim të së ardhmes. Një martesë, për mua është e pamundur dhe jam i sigurt se nuk do ta bëja kurrsesi të lumtur". Në letrën drejtuar Elsës, Mid'hati shkruante: "Të dua të lumtur, Elsa. Po luftoj midis zemrës dhe arsyes, midis dashurisë dhe detyrës, pikërisht në emër të kësaj dashurie". Elsa: "Mbase është një marrëzi e madhe dashuria ime për ty, që e do aq shumë lirinë, të udhëtosh, t'i biesh botës qark, tek do ndryshimin, jetën pa halle, pa telashe".

Mid'hati ishte një qytetar i lirë evropian, ndaj përpiqej jo pa dilemma, që pasioni dhe jeta familjare të mos ia pengonin dashurinë e madhe ndaj atdheut dhe detyrën ndaj çështjës kombëtare, si edhe të mos lëndonin njerëzit e dashur.

Mid'hati pati një letërkëmbim të pazakontë, nga përmbajtja e thuktë, por edhe nga shumësia e letrave, që arrijnë në mijëra e mijëra. Të habit fakti që ku e ka gjetur kohën të shkruajë letra pa fund, kur ka pasur një veprimtari tejet intensive atdhetare, politike, diplomatike, pedagogjike, kulturore, studimore, albanologjike, kritike, botuese, letrare, memoriale, bibliografike dhe përshkrime udhëtimesh brenda dhe jashtë Shqipërisë.

Ai ka shkruar dhe këmbyer letra nga nevoja e kohës, me personalitete, por edhe njerëz të thjeshtë të botës shqiptare si Ismail Qemali, Luigj Gurakuqi, Faik Konica, Mehmet Konica, Kristo Luarasi, Gaetano Petrota, Dr. I.Temo, Dr. M. Turtulli, Fan Noli, Sulejman Delvina, Shtjefën Gjeçovi, Gjergj Fishta, Gjergj Pekmezi, Ahmet Zogu, Sotir Kolea, Rexhep Mitrovica, Bedri Pejani, Dhimitër Berati, Aqif Pashë Elbasani, Eshref Frashëri, Pandeli Evangjeli, Arif Dino, Asdreni, Kolë Tromara, Kostë Çekrezi, Mihal Grameno, Avni Rustemi, Samin Visoka, Branko Merxhani, Mirash Ivanaj, Seit Kemal, Hil Mosi, Kolë Kamsi, Karl Gurakuqi, Musine Kokalari, Emine Frashëri, Abaz Kupi, Dhimitër Falo, Safet Butka, Sali Mani etj; por edhe me personalitete te shquara të politikës e diplomacisë botërore si presidenti Wilson, Lord Robert Cecil, kryetar i Konferencës së Paqes në Paris, Jules Cambon, kryetar i Konferencës së Ambasadorëve, Eric Drumond, sekretar i Përgjithshem i Lidhjes së Kombeve, D'Estornuelles de Constand, Lloyd George, Aristide Briand, Aubrey Herbert, Edit Durham, Justin Godart, Baron Hayashi, Telford Erickson, Jean Pelissier, I.S. Barnes, Morton Eden, A.J.Balfour, Rene Vivian, K.Ishii, Bill Maklin, Alexandër Kirk, Julian Emer etj. si edhe ministra, deputetë, këshilltarë, ambasadorë, shkrimtarë, kryeredaktorë agjencish, gazetash e revistash, miq dhe armiq të Shqiperisë dhe të Mid'hat Frashërit.

Po ashtu, pati letërkëmbim me personalitete te shkencës evropiane si M.Shuflai, G.Weigand, E.Pittard, M.Roques, M. Tomasie, H. Pedersen, N. Jokli, Prof.Meillet, E.Legrand etj

Letërkembimi është hulumtuar dhe nxjerrë në Arkivin Qendror të Shtetit, Arkivin e Ministrisë së Jashtme dhe arkivat e bibliotekat e Turqisë, Francës, Britanisë së Madhe, SHBA, Greqisë, Rumanisë, Bullgarisë, Zvicrës, Gjermanisë, Italisë, etj, kryesisht në gjuhët shqip, frëngjisht, anglisht.

Ky letërkëmbim është ngërthyer tek vëllimi VI dhe VII i kolanës "Mid'hat Frashëri- Vepra të zgjedhura" botim i Institutit të Studimeve Historike "Lumo Skëndo" Tiranë.

Letër e Lumo Skendos drejtuar botuesit Kristo Luarasi në Sofje

*Vlorë, 10 dhjetor 1912*

# SI U BË KONGRESI I VLORËS

(Letër nga Vlora)

I dashur Kristo,

Nga Shkupi të shkrova, them ta kesh marrë. Dola nga ai qytetditën që flloi luftën Serbia d.m.th., më 3 (16) të muajt që doli dhe shkova nga Mitrovica në Pejë, Gjakovë, Has, Tejdrin, Mirditë, Kurbin, Tiranë, Durrës, Elbasan e nga Elbasani ardhçë këtu. Në Kosovë (d.m.th. prej Peje, Gjakove, Gucie dhe Plave), me tre shokë të tjerë, mora letër me nënshkrime të parësisë, për të treguar që jemi mëkëmbësit e tyre për çdo gjë që të bëjmë për Shqipërinë. Kur ardhëm në Tiranë, qëllimi ynë ish të bënim një kongres kombiar me ndihmë të Abdi bej Toptanit, se kishim bërë falë edhe me Kapidanin e Abatin e Mirditës. Por kur arritëm ne, gjetëm letrën e Surja be Vlorës, i cili kish ftuar parësinë në një mbledhje. U gëzuam se kështu e gjenim gati punën.

N`Elbasan donja që të bëhej ai qytet si vend i mbledhjes, po atje na erdhi tejshkrimi i Ismail Qemalit, që na lajmëronte se do të dilte në Vlorë dhe ftonte botën në një mbledhje. Edhe pas pak ditësh arriti në Durrës, bashkë me delegatët e Bukureshtit dhe Gurakuqin. Nga Durrësi, gjithë delegatët e ardhur dhe t`atyre viseve, vanë në Vlorë, ku dhe unë vajta me shokët e Elbasanit.

Kongresi u çel më 15/28 të këtij muaji dhe ishin 47 delegatë nga çdo anë Shqipërisë, vise të shkelur dhe të pashkelur. Sot jemi 67, se kanë ardhur dhe nga vende të tjerë. Atë ditë, pra, ora 11.1/2 allaturka (2. ½ allafrënga) me zë të përgjithshëm u proklamua Indipendenca e Shqipërisë dhe flamuri u çel në portë të shtëpisë, ku ishim mbledhur (shtëpia e Xhemilbeut).

Ngjarjet, që kanë rrjedhur q`atëherë, do t`i kesh kënduar në gazetat. Sot kemi pushim lufte me të tre shtetet. Vetëm Greqia po lufton në Janinë, ka nxjerrë dhe ushtarë në Sarandë, po tanët kanë zënë Delvinën dhe është shpresë që ata të mos përparojnë; edhe në Himarë janë nja 400 grekë, po shqiptarët kanë zënë Dukatin, Vranishtin e Kuçin dhe grekët s`bëjnë dot asnjë çap. Qeverisja shqiptare është në të tërë Gjirokastrën dhe gjer në Durrës.

Kongresi zgjodhi me zë të fshehtë kabinetin më 21 të muajit dhe ftuan: Ismail Qemali - kryeministër dhe ministër I Punëve të Jashtme; Mehmed pashë Kallkandeleni - ministër i Luftës; P.Poga Gjirokastra - ministër i Drejtësisë, Myfd bej Libohova - i P. të Brendëshme, L.Gurakuqi - i Arsimit, Abdi bej Toptani - i Financës, Pandeli Cale - i Bujqësisë, Mid`hat Frashëri- i P. të Përgjithshme, Lef Nosi - i Postavet.

Atë ditë u zgjodh edhe një Këshillë e Kombit prej 18 vetësh, të cilët do t`i ndihin qeverisë dhe do ta kontrollojnë. Për dy a tri ditë do të nisen delegatët për n`Evropë, që të mbrojnë të drejtat e qeverisë së re.

Të fala, L.S

# CITIME NGA LETRAT E VËLLIMIT VI TË MID'HAT FRASHËRIT

"Do të qe mirë sikur të mundim të zgjojmë në disa qarqe një jetë intelektuale, një rrojtje me ide të reja, një jetë mendore. Le të përpiqemi t`i prapsim pak shqiptarët nga jeta politike dhe e kafenevet, t`i shtyjmë në studim dhe në merak për çdo send që i përket Shqipërisë dhe shqiptarizmës, se po që nuk zgjuam dot një kult, një adhurim për çdo send, që i përket kombit dhe tokës sonë, nuk mund që të kemi as shqiptarë, as Shqipëri".

*

"Në këtë kohë merkantilizmi materialist, kur fjalët "drejtësi" dhe "barazi" thonë aq pak. Shqipëria është e vendosur të mos e lërë veten të therret si qingj: ajo do të luftojë; e le të guxojnë mandej të gjithëfuqishmit e botës të pretendojnë se qenka meraku për paqen e rendin, që udhëheq mendimin e tyre!"

*

"Kur Konferenca e Paqes filloi punimet, premtimet e saj të famshme për vetvendosjen e popujve, për ndreqjen e gabimeve të së shkuarës dhe për fillimin e një epoke drejtësie e ndershmërie, ne shqiptarët besuam se tre të katërtat e territorit dhe të popullsisë shqiptare që i janë shkulur dheut mëmë nga Konferenca e Londrës e vitit 1913, do të na riktheheshin".

*

"Dhe ja kur tani – në vend të na kthejnë Kosovën, Maqedoninë perëndimore dhe Epirin e jugut – flitet për copëtim edhe  të kësaj Shqipërie të vogël të 1913-ës!"

*

"Asgjë të japim nga trupi i vogël i mëmëdheut tonë!"

*

"E dini fort mirë se Shqipëria e pësoi katastrofën e 7 prillit jo vetëm prej fuqisë ushtarake të huaj, por edhe nga tradhëtija e disa shqiptarëvet, të cilët me liri dhe koshiencë të plotë përgatitën komplotin kundër Atdheut dhe vepruan si pararojë e fuqivet okupuese, e më vonë, kundër fuqivet nacionaliste të gjithë kombit mbarë, q'ishin hedhur në luftë për rifitimin e lirisë dhe të vetqeverimit"

*

"Rrojtja jonë si komb dhe shtet është një gjë prekëse, Edhe kur shteti është i dobët, ai duhet të forcohet e të përmirësohet e jo të shembet; edhe kur qeveria ezgjedhur nuk është aq e mirë, duhet përmirësuar, plotësuar apo rizgjedhur me përgjegjësi, po jo duke e përmbysur me rebelim turme"

*

Puna e qeverimit më duket se do të zgjidhej më lehtë me një regjim republikan: ndryshe kena me pas shumë ngatrresa.

*

"Kusht i domosdoshë për zhvillim është puna. Varfëria e Shqipërisë vjen nga të mospunuarit. Nuk do thenë as ishallah as kemi kohë. Kapitali jo vetëm më i madh, por i vetmi i njeriut, janë puna, mundimi e krahët e ti. Puna të mos jetë dënim dhe mallkim për ne, por uratë dhe gëzim si një falje"

*

"Shqiptarët, të cilët e duan paqen, kërkojnë të kenë marrëdhënie të mira me fqinjët. Popujt e Ballkanit kanë filluar të kuptojnë se ka vetëm një rrugë për të arritur lulëzimin, vetëm një mënyrë për të hequr qafe zakonet e këqija të së shkuarës, sipas së cilave konsiderohej armik çdo popull përtej kufirit. Tani e kuptojnë se një solidaritet me interesa të përbashkëta, solidaritet material e ekonomik, madje edhe moral e intelektual, duhet t'i bashkojë popujt e jo t'i ndajë".

*

"Një ndihmë e vogël shpëton një jetë, gëzon një shpirt , hedh pak lumturi në një zemër".

*

"Po luftoj midis zemrës dhe arsyes, midis dashurisë dhe detyrës, pikërisht në emër të kësaj dashurie..."

*

"Dashuria është kondita e jetës. Pa atë s'ka rrojtje. Po të mos ekzistojë dashuria, shkatërrohet lidhka mes gjymtyrëve të familjes e të njerëzisë, zhduket shija e gjallërisë dhe e jetës. Pa dashuri s'ka entuziazëm, s'ka as shpresë dhe nuk kryhet asnjë vepër. Entuziazmi dhe shpresa, bijat e dashurisë së sinqertë e të thellë, duhet të jenë si ata trëndafilat e mëngjesit, që çelin çdo ditë të rinj, si ato lulet, që mbyllen natën, por hapen nën rrezet e para të diellit".

## Në 75 vite ky lice u bë qendra dhe promotori i artit shqiptar dhe violinës në veçanti

# LICEU ARTISTIK DHE VIOLINA SHQIPTARE

*Nga Ina Kosturi*

Nëse duam të reflektojmë mbi historikun e violinës në Shqipëri, një rëndësi të veçantë në krijim e shkollës së violinës, talenteve, programeve të interpretuara e deri në përfaqësimin e saj përtej kufijve, i takon institucionit të Liceut Artsitik, i cili në 75 vite u bë qendra dhe promotori i artit shqiptar dhe violinës në veçanti. Ky 75 vjetor është një moment reflektimi, bashkëpunimi, evidentimi dhe frymëzim për të nesërmen në disa fusha të artit shqiptar, e mes tyre dhe violinës shqiptare si krenari dhe histori suksesi. Liceu Aristik ishte dhe është një nga institucionet më të bukura, ku drurët e mëdhenj të udhës së artit zaptojnë ndërtesën si një oaz frymëzimi ku marrin jetë tingujt e ngjyrat. Është institucioni rinor i artit ku thuren ëndërra me skena, teatro, galeri, janë qindra ëndërra bashkë vit pas viti që përçojnë kulturë, art, pasion në gjithë Shqipërinë e suksesshëm si ambasadorë të heshtur me gjuhën e artit janë lajmëtarë të kulturës e përparimit si komb . Cdo dritare, klasë, korridor fsheh mijëra histori suksesi e pasioni, studimi, melodi të pafundme, që vetëm artistët arrijnë ti njohin e perceptojnë .

Historiku 75 vjeçar kërkon padyshim evidentimin e etapave të zhvillimit të secilës degë. I takon studiuesve të skicojnë momente, evente, emra pedagogësh, instrumentistësh të cilët e çuan krahas degëve të tjera në nivele të larta interpretimin muzikor e violinën shqiptare. Nëse në fillimet e tij përparimin e sollën violinistë, muzikantë shqiptarë që studiuan jashtë, e të huaj më të paktë, vitet më pas do e përmbysnin këtë raport, duke promovuar talente të cilët zakonisht do ushtronin aktivitetin në orkestra në mbarë botën e një pjesë si solistë e pedagogë në institucione prestigjioze. Ky ndryshim duket se vulosi atë sukses që artet dhe violina në veçanti arriti, falë dhe kontributit 75 vjeçar të një institucioni që promovon, përkrah e rrit talentet shqiptarë . Recitali i parë i Ludovik Naracit i vitit 1926 do mbetej një datë historike ndërsa Liceu Artistik dhe përpjekja e Naraçit i njohur si profesor i Liceut do bashkohej me shumë violinistë të tjerë pedagogë për ta pasuruar repertorin violinistik me vepra të rëndësishme të literaturës botërore, me recitale e debutime me orkestra, bashkë me botimin e pjesëve shqiptare në" Repertorin Pedagogjik" të një tjetër profesori, Genc Bogdo, duke gërshetuar kështu pëparimin e çdo brezi në literaturë botërore e shqiptare . Emra të tjerë violinistësh duket se u bashkuan në këtë përparim të domosdoshëm të violinës shqiptare, derisa u hap dhe shkolla e lartë, e emra të rinj, nxënës të pedagogëve të Liceut do vazhdonin të transmetonin këtë pasion e përkushtim për violinën si pedagogë, solistë e orkestrantë. Një pjesë e të diplomuarve do ktheheshin në shkollën e dikurshme për ti dhënë asaj shkëlqimin e duhur, si një trashëgimi e krijuar me pasion e mundim . Në pamundësi për të përmendur gjithë emrat e violinistëve pedagogë e duke shpresuar që studiuesit të botojnë detaje, dokumentojnë histori të këtij kontributi, do ndalem në një periudhë e cila shënoi dhe suksesin më të madh, atëhere kur violina dhe Liceu u shndërruan në promotorë të artit e talenteve, kur programet dhe repertoret njohën reforminin dhe moderizimin dhe shkolla u duk se i parapriu apo përgatiti ikjet e mëvonshme të instrumentistëve shqiptarë. Ish një kohë e varfër gjithsesi e një vendi të izoluar, pa dyqane veglash muzikorë, me tela të vjetër e parte të ruajtura me fanatizëm . Në vënd të turistëve, Paganini, Donti, Rode, Tchaikovski e Sibeliusi e shumë të tjerë tregonin prezencën e tyre nga bota e largët e institucioneve shekullore me tinguj nga duar fëmijësh e të rinjsh, për të cilët violina ishte vetë jeta . Korridori u shndërrua në një sallë e gjatë ku secili ushtrohej deri sa përgatitej për të hyrë në klasën e mësimit, ishte skena ku detyra përzihej me ambicjen, një skenë e improvizuar të cilën e donin të gjithë, një skenë moderne e një shkolle të varfër ku pasioni fitonte mbi gjithë komoditetet e munguara .

Nëse shumë vite më parë, ardhja e një apo disa violinistëve pedagogë do ndryshonte atmosferën e institucionit, vitet 1985 -1990, do shënonin ndoshta dhe periudhën më të lavdishme të violinës shqiptare, ku shkolla e violinës nuk përfaqësohej me individë, ku kontributi i pedagogëve nuk ishte një i vetëm, po idetë e një pedagogu, bashkoheshin me kërkimet e një violinisti tjetër, duke krijuar nga mbyllja një dritare të gjerë diturie, frymëmarrjeje për violinën shqiptare. Elementë soliste e elementë të përkushtuar të pedagogjisë do punonin në grup duke reformuar programet, duke sjellë një progres të madh teknik, repertorë të panjohur më parë, duke e kthyer Liceun artistik, jo vetëm në institucion të violinës, po në një atmosferë konkursi, ku talentet mobilizoheshin, motivoheshin për ta kthyer shkollën në shkollën e solistëve. Duket se violina shqiptare do i paraprinte ndryshime të mëvonshme dhe hapjes me botën përtej Shqipërisë, ndërsa kompozitorë të panjohur, të mëdhenj do beheshin pjesë e tingëllimeve të sallës së liceut e skenave në mbarë vendin dhe kjo kaq natyrshëm sa solli ndryshmin e gjithë kërkesave, nivelit, motivuar dhe nga interpretimet e violinistëve solistë në skenat shqiptare .

Kjo klimë erdhi pasojë e kontributit të mëparshëm të violinistëve të tjerë, të cilat krijuan premisa për këtë revolucion në të cilin u përfshi gjithë stafi pedagogjik, madje kjo frymë u shtri dhe në shkollat e muzikës. Idetë konkrete të Robert Papavramit, përvoja jashtë e tre violinisteve të vegjël nga Liceu, avancimi teknik nëpërmjet shkallëve, etydeve të vështirësisë së lartë, ndërrimi i tyre dhe realizmi i një numri të lartë materialesh, përfshirja e koncerteve të panjohura më parë e deri në vepra të vështira violinistike në interpretimet e nxënësve të liceut u shndrrua në një praktikë të zakonshme. Bashkë me Robert Papavramin e Zhani Cikon, me Roland Xhoxhin e Fatbardha Denizin, Proletare Skënderin e Didi Tartarin, u bashkua një pjesë tjetër pedagogësh të rinj po aq të përkushtuar . Mamica Abazi e Yllka Mishto, Shanka Kumbaro, Edmond Sinani e Brunilda Stefani bashkë me violinistin solist Pirro Gjezi ( pedagog i jashtëm ) do ishin pjesë e këtij ndryshimi . Vëzhguar me syrin e një nxënëseje atëherë dhe reflektuar sot, ky staf shënoi një tjetër veçanti në institucionet tona kulturore e artistike, klimëne bashkëpunimt dhe respekti reciprok, me mjeshtërinë e mbajtjes pas kuintave, padukshëm, të ambicjeve që shoqëronjnë institucionet e artit e sidomos ato shqiptare. Pas saggiove pedagogu yt ishte po aq objektiv dhe për nxënësin e kolegut . Duket se shkolla tejkaloi ambicjen e secilit pedagog për sukses duke e shndërruar në sukses të secilit violinist që ishte nxënës i asaj shkolle, duke falur besim, vlerësim dhe duke imponuar respekt. Ambicja për sukses u gërshetua me urtësinë e violonçelistit Xhovalin Lazri,si një model paqësor funksionimi të një institucioni artistik e arsimor. Shkolla u shndërrua në një institucion që i shërbeu përtej instrumentistëve të rinj violinës soliste shqiptare dhe përparimit të saj në përgjithësi, duke e përgatitur në nivel profesional po dhe të marrëdhenieve mes pedagogëve e nxënësve, në një oaz qetësie ku punohej më përkushtim . Inatet, hatërmbetjet, ajo ambicje në shkollat e artit mbeti e fshehur e në vend të kapriciove të pedagogëve e studentëve, në të kundërt me çmendinë së kohës shfaqur me prerje pantallonash "moderne", shkolla e violinës studioi dhe perfeksionoi 24 Kapriciot e Rodes, Dontit e deri tek Paganini, një pjesë e të cilave luhej aq lehtësisht, sa do befasoheshin dhe institucione shumvjeçare jashtë Shqipërisë. Në vend të rrëmbimit të ndonjë nxënësi a studenti të kolegut siç ndodh ndonjëherë në instutucionet tona artistike, stafi i atëhershëm dha një model paqeje, ku luftohej për t'i rrembyer një pjese të re repertorit violinistik e vendosur në skenë. Salla e dikurshme e Liceut është shndërruar sot në një sallë të vërtetë arti, ku shfaqjet, koncertet, aktivitetet përcjellin njëra tjetrën. Ndërsa violina krahas degëve të tjera mbetet një histori suksesi. Kapriciot e Rodes, repertori i violinës pushton tashmë sallën moderne, ndërsa talentet janë aty në çdo kohë. Stafi i sotëm përballet me sfida të reja, në një kohë kur kontaktet e botën jashtë janë reale, të prekshme, kur zbukurimi,moda janë të dukshme e të kërkuara. Është bukur të kthehesh në shkollën e artit, ku talente, e mes tyre violinat janë gjithmonë sukses. Është bukur të shqiptosh dy fjalë "Liceu Artistik ", aty ku nisin ëndërrat e mëdha të artistëve të vegjël, aty ku nisën sukseset e para të artsitëve të mëdhenj shqiptarë, aty ku në çdo kohë merr frymë pasioni për artin.

# NJË STUDIM VLERASH TË SHUMTA PËR VEPRËN LETRARE TË MARTIN CAMAJT

*Nga Ajete Zogaj*

*"Ka libra që lexohen, ka libra që të vënë në mendime, ka libra që ruhen në zemrën e kombit".* (Leonid Leonov)

Viti 2020 shënoi 95 vjetorin e lindjes së shkrimtarit, gjuhëtarit dhe atdhetarit të shquar, Martin Camaj. Këtë përvjetor të veçantë Sh. B. "Beqir Musli" e Gjilanit e shënoi me botimin e librit "Vepra letrare e Martin Camajt[1]" të autorit Anton Nikë Berisha, një studim monumental për veprën e Martinit.

Interesimi i profesor Berishës për veprën e Camajt është i hershëm, që nga viti 1978, qysh gjatë qëndrimit të tij studimor në Göttingen të Gjermanisë. Ai zgjati vite me radhë dhe rezultoi me studimin e thelluar dhe më të plotin e më shkencorin që kemi deri më tani për veprën letrare të këtij shkrimtari.

Studiuesi Anton Nikë Berisha i është kthyer disa herë leximit e studimit të veprës letrare të Camajt dhe secilën herë ka gjetur diçka të veçantë në veprat e tij.

Duke u nisur nga teksti poetik, nga shtjellimi i veçantë i tij në një varg veprash të Camajt, qysh në *Parathënien* e vitit 1991 Berisha do të shkruajë: "E shoh të nevojshme të përmend këtu se koha e jetës dhe receptimit intensiv të veprës letrare të Camajt në rrafshin gjithëkombëtar duhet të fillojë"( f. 10).

Gjatë leximit dhe rileximit të veprës letrare të Camajt, Berisha u mishërua me të, prandaj veprave të veçanta të tij, qofshin në poezi, në prozë, qofshin në dramë, u bëri një interpretim të menduar mirë, profesionalisht të ngritur, përmes të cilit i ndriçoi disa nga vlerat më kryesore të tyre. Siç do të shprehej Zh. La Bryjer: "Kur leximi ju lartëson shpirtin dhe ju ngjall ndjenja fisnike e burrërore, mos kërkoni arsye të tjera për të çmuar atë vepër, ajo është e mirë dhe e ka shkruar një mjeshtër".

Studimi "Vepra letrare e Martin Camajt" e profesor Anton Nikë Berishës, botuar nga Sh. b. "Beqir Musliu", u shtua dhe u rishikua; u saktësuan mendime, u shtuan vlerësime; u pasurua këndvështrimi, u bën shtesa. Është me vlerë sidomos pjesa për veprën letrare të Martinit, të vështruar pas njëzet vitesh më vonë, për të cilësuar përsëri si vepër letrare sa të mëvetësishme, aq dhe të rëndësishme, me një shtjellim gjuhësor shprehës të veçantë, të krijuar nga mendja e një mjeshtri të madh të artit të fjalës së shkruar.

Në fillim të studimit Berisha i sjell të tri shënimet përcjellëse për të tri botimet e mëparshme të studimit për veprën letrare të Martin Camajt, të botuara në Kozencë e Tiranë në intervale të ndryshme kohore e të plotësuara, sikurse jep edhe një shënim shtesë për botimin e vitit 2020 të bërë në Gjilan.

Libri i Anton Nikë Berishës, "Vepra letrare e Martin Camajt" shtjellohet në tre kapituj, përmes të cilëve në mënyrë të thelluar trajtohen çështjet e poetikës së veprës letrare të këtij shkrimtari: Camaj poet, Camaj prozator dhe Camaj dramaturg.

Profesor Berisha me të drejtë thekson: "Vepra e tij poetike është, para së gjithash, fryt, me një anë i aftësisë krijuese e përfytyruese (imagjinatave) dhe, me anë tjetër, i përkushtimit të madh krijues. [...] Vepra e Martin Camajt u krijua në vazhdimësi në një periudhë mbi dyzetvjeçare dhe në kushte dhe në rrethana të veçanta e në vende të ndryshme, prandaj përcaktimi i tipareve të saj, i periudhave të krijimtarisë dhe i shkallë-shkallëshmërisë dhe i natyrshmërisë së evoluimit dhe i ngritjes së cilësisë artistike të saj, kërkon shumë më tepër aftësi e flijim mendor e profesional sesa mendohet në të parë" ( f. 20).

Sipas Berishës, Martin Camaj fillet krijuese artistike i pati me poezi, ku më 1951 në revistën letrare "Jeta e re" të Prishtinës botoi poezinë "Mësuesi i ri" (nr. 5) dhe "Mullini i ujit" (nr. 6), ndërkaq në vitin 1953 ndërmarrja botuese "Mustafa Bakija" e Prishtinës, ia botoi përmbledhjen tashmë klasike "Nji fyell ndër male" dhe më 1954 "Kanga e vërrinit".

Pas analizës që i bën krijimtarisë letrare të Camajt, ngritjes dhe pasurimit të saj, profesor Berisha veçon tri periudha, që meritojnë shqyrtim të veçantë:

Periudha e parë: 1953 – 1967
Periudha e dytë: 1967- 1978 dhe
Periudha e tretë: 1978- 1992.

Në procesin e ndriçimit të vlerave poetike të poezisë së Camajt, sidomos mënyrën se si autori u qaset dhe i shqipton dukuritë përmes gjuhës, përmes tekstit, në veprat e botuara në vitet 1967-1978, Berisha thekson: "[...] nëpërmjet artit të fjalës, poezisë, Camaj vë dialog me gjithë atë që i duket e rëndësishme dhe e nevojshme për njeriun në rrjedhën jetësore, për pasurimin dhe vetëdijesimin e tij. Camaj nuk krijoi poezinë (kjo ndodhë edhe me veprat e tij në prozë e në dramë) për hir vetëm të artit, për hir të dëshmimit të prirjes dhe imagjinatës krijuese poetike të tij, të vetëkënaqësisë artistike, por për domosdonë e komunikimit artistik e të ndikimit estetik të veprës së tij me marrësin – receptuesin e saj." ( f. 41- 42).

Në interpretimin që i bën përmbledhjes "Njeriu me vete e me të tjerët", e botuar në München më 1978, Berisha thekson se ajo hyn në radhën më të ngushtë të vëllimeve më artistike dhe më të rëndësishme të poezisë gjithëshqiptare deri më sot; nga struktura tekstore poetike e krijuar rrezatojnë mendime që rrahin larg. ( f. 50).

Edhe poezitë e periudhës së tretë, janë trajtuar nga rrafshe të ndryshme, ku autori ndalet sidomos tek libri *Palimpsest,* që është i fundit i shkruar nga Martin Camaj dhe përmbyll krijimtarinë e tij në këtë fushë.

Studiuesi Berisha merret sidomos me mënyrën si Camaj i shpreh dukuritë, përkatësisht si e shtjellon tekstin poetik, të hartuar në periudhën e tretë, ku dëshmohet një art i madh: " Poezia e periudhës së tretë të Camajt, për t'u receptura kërkon një lexim të përkujdesshëm, një njohje të natyrës së artit të fjalës e të fuqisë së tij magjike, një përafri dhe bashkafrim kohësisht më të gjatë. Ajo nuk të përvetëson fillimisht dhe me lexim të parë; kërkon më tepër për arsye se është krijuar për atë qëllim: që të pushtohet me mundim e me përpjekje më të mëdha [...] së këndejmi, mund të themi me gjithë mend se kjo poezi e Camajt është shembull dhe dëshmi e njëmendët se sa njeriu mund të pasurohet e të fisnikërohet shpirtërisht nga vlera kulminante të artit letrar" ( f. 72-73).

Me përkushtim Berisha e ka studiuar edhe Camajn prozator. "Në fushën e prozës Martin Camaj u dëshmua romansier dhe novelist dhe në dy këto forma tregoi aftësinë dhe imagjinatën e krijuesit të madh" ( f. 77).

Autori merret sidomos me veprën "Dranja", njëra nga krijesat më të veçanta e më me vlerë të Camajt, po dhe të letërsisë shqipe në përgjithësi. Po ashtu Berisha i bën një interpretim të thelluar dhe romanit "Karpa"; ngjarjet ndodhin në një të ardhme të përfytyruar, ku Camaj gërmon në shpirtin e personazheve e të zbulimit të prejardhjes së tyre.

Aftësi të jashtëzakonshme krijuese Camaj tregoi edhe në lërimin e veprave dramatike, si, fjala vjen: "Loja e mbasdrekës" (1981) dhe "Kandili i argjendit" (1993).

Dy shtojca:" Të tjerët për veprën e Martin Camajt" dhe "Njëzet letra të Martin Camajt" janë pjesë e rëndësishme e këtij studimi.

Derisa në shtojcën e parë kemi mundësinë të lexojmë vlerësime meritore për krijimtarinë letrare të Martin Camajt nga njohës të veprës së tij, shtojca e dytë është me interes të veçantë për lexuesit dhe studiuesit: Camaj sjell të dhëna të rëndësishme për mënyrën e krijimit të veprave të tij dhe të përkushtimit krijues. Ato sjellin të dhëna për njohjen e profesor Anton Nikë Berishës me Martin Camajn si dhe kujdesin e jashtëzakonshëm për t'i ruajtur e për t'i botuar ato. Letrat shpërfaqin kulturën e dy intelektualëve meritor, dijen dhe njohjet e thella për fusha të ndryshme të dijes e të artit, por edhe për çështje madhore të kombit.

Në to shfaqet konsiderata dhe vlerësimi i lartë që Martini ka për profesor Berishën dhe për Kosovën: "Letra jote vë në dukje disa pika që i harroj: relacioni im me ju. Gja që më ka ngurrue në shumë (pikëpyetje). Pa çue gjatë: në zemër (innerlich") nuk ka asnjë grup kulturor shqiptar jashtë e brenda që e ndiej ma afër se ju."(Lenggries, 6. 5. 1984)

Studimi për veprën letrare të Martin Camajt dëshmon për një punë të mirëfilltë, për një përkushtim dhe dije të madhe të profesor Anton Nikë Berishës në fushën e studimit dhe të interpretimit të veprave letrare për arsye se vepra letrare e Camajt e vë secilin studiues para vështirësive të ndryshme, të cilën gjë e përmend dhe Berisha.

Mendimi i filozofit anglez, Francis Bacon: "Leximi e kompleton njeriun; biseda e bën të shkathët, të shkruarit e bën të saktë", sikur ndërlidhet bukur me leximin, me rileximin dhe me studimin që profesor Berisha i bën veprës së Camajt, përmes të cilit ndriçohen disa nga vlerat kryesore të kësaj vepre me interes të shumëfishtë. Edhe vetë Berisha thekson se këtë studim duhet marrë vetëm si një mundësi të qasjes dhe të interpretimit të veprave poetike të Camajt: "Vepra e Camajt ka vlera të mëdha dhe ofron mundësi të pashterueshme për studime e vlerësime sa herë që t'i qasemi, ta lexojmë dhe të merremi me përkushtim me të" ( f. 162).

Prishtinë, shtator 2021

1 Anton Nikë Berisha, *Vepra letrare e Martin Camajt.* Studim. Botoi Sh. B. "Beqir Musliu" Gjilan 2020.

# BUZË RRUGËS

## Tregim nga Ajkuna Dakli

- Oh, çfarë mrekullie! – tha ajo duke vështruar poshtë – çfare paqeje, qetësie, çfarë blerimi! Sikur të kishim një shtëpi mu aty në luginë buzë lumit, një shtëpi me çati alpine sic kemi parë në Zvicër!

Kishin ndalur në Krrabë në afërsi të Gracenit dhe ajo po shihte në luginën aty poshtë në një pllajë të vogël mes dy shpateve të maleve të mbuluara me pisha. Ishte akoma mëngjes dhe mali dukej i gjelbër i thellë, ndërsa pllaja kishte  një ngjyrë pakëz me të fortë si një petal i madh zambaku. Ai ishte mbështetur pas makinës së ndalur në anë të rrugës dhe po tymoste një cigare. Ajo vështroi nga ana tjetër e rrugës nga ku një varg malesh rradhiteshin njëra pas tjetrës si hije të qeta të heshtura në një ngjyrë të gjelbër të errët në blu. Ajo pikë ishte afër majës dhe nga aty në ditë të kthjellta larg tutje në horizont mund të shihje edhe detin. Po tani qielli ishte veshur me një tis të kaltër të thellë dhe nja dy re të bardha notonin pak më tutje. Ajri ishte i pastër i freskët , asaj iu duk se dëgjoi kërcitjen e kënaqur të pëlhurës së mushkërive si një velë që shpaloset.

- Sapo e blemë një hyrje në plazh – tha ai

- Ja aty ku ndodhet ajo shtëpia e vogël – vazhdoi ajo si të mos e kishte dëgjuar.

- Ajo shtëpia e vogël nuk është shtëpi alpine – tha ai – është një kasolle e vetmuar që një zot e di di si reziston në atë vend të humbët. Mesa duket të zotët nuk kanë takat të shkojnë më tutje dhe kanë mbetur në vend numëro.

- Ose nuk duan të shkojnë më tutje – tha ajo

- Se besoj të mos duan tha ai – Nuk ma ha mendja që jeta në atë kasollen aty është aq komode sa të duket ty.

Ajo u zgjat dhe vështroi. Shtëpia nuk dukej mirë  nga larg . U mundua të dallojë figura njerëzish po nuk mundi. Ishte mjaft larg që aty. Picërroi sytë dhe shqoi një arë të vogël që nga shiritat e rregullt të ngjyrave, dukej si e mbjellë . Anash pishat hidhnin një dritë të gjelbër, dhe po të vije re me kujdes, diçka pak më tutje reflektonte diellin- duhet të ishte lumë ose përrua.

- Prapë një shtëpi aty do më pëlqente shumë – përsëriti ajo – Kaq paqe. Kaq gjelbërim. Tirana më ka lodhur. Zhurmë pluhur, rrëmujë.  Sa mund të kushtojë ajo shtëpia aty thua?

- Një kothere bukë – tha ai – sepse nuk ka rrugë . Ja shlodhemi në plazh – shtoi

- Në plazh mirë. Po as atje nuk shpëton nga zhurma e rrëmuja. Po flisja për qetësi – qeshi ajo – qetësi paqe, ajër i pastër, libra, një oxhak..... edhe pak plazh mbase. Duhet të ketë një lumë aty poshtë që nuk duket nga rruga.

- Dëgjo – tha ai duke e hedhur cigaren përtokë dhe duke e shtypur bishtin me këmbë. Duhet të nxitojmë sepse unë kam punë sonte në darkë në Tiranë. Nuk dua të kthehemi shumë vonë. Duhet të takoj ata dy njerëzit për projektin e ri. Janë gjithë ato para.

- Të paktën të mbledh nja dy manushaqe – tha ajo

Ai vajti në buzë të rrugës

- Janë poshtë – tha duke u përkulur. – Duhet të zbresësh më poshtë. – Ikim të lutem. Mbase gjen në ndonje dyqan lulesh.

- Askund nuk e kane aromën e këtyre këtu – tha ajo duke u drejtuar nga makina.

Ai psherëtiu disi i lehësuar dhe u drejtua edhe ai për nga makina . U nis kaloi me kujdes kthesën dhe vuri këmbën mbi gaz.

***

- Hajde ikim u bë vonë . Nana do bahet merak.

I vogli nga të dy djemtë e vegjël dukej i lodhur. Ishte rreth 8 vjeç vetëm tre vjet më i vogël nga i vëllai po dukej më i imët . Kishin disa orë që u zgjasnin makinave tufat me manushaqe dhe nuk kishin shitur ndonjë gjë të madhe sepse pak makina ndalonin. Ishte në të perënduar dhe do u duhej më shumë se një orë të zbrisnin në shtëpinë e vogël mbi pllajë.

- Prit edhe pak, - tha vëllai i madh. Edhe dy tufa.

- Po nuk po ndalon asnjë makinë hajde ikim.

- Po ti ke frikë? Se bëhet errët?

I vogli nuk foli.Natën dëgjoheshin hungëritje dhe i ati u kishte thënë të mos dilnin vonë se mund të dilnin ujq ose arinj.

- Jo – u përgjigj i vogli me vendosmëri – Nuk kam frikë. Po nana do bahet merak. Makinat nuk ndalojnë se ka lule në qytet.

- E ku ka lule në qytet, – tha i madhi – Në qytet ka pallate dhe gjëra të tjera

- Ka edhe lule.

- Po ti ku e di ? Ti e mban mend atëhere ku ishe i vogël ? Ti ishe i vogël.

- Në qytet ka çdo gjë që të duash. – tha i vogli me vendosmëri. - Dhe unë kur të rritem edhe pak do iki në qytet.

- E si do ikësh?

- Do iki. Do eci do eci dhe do iki.

- Po ku do gjesh shtëpi në qytet?

I vogli nuk foli . Zgjati dorën me tufën me lule me dëshpërim drejt makinës që po vinte po ajo prapë nuk ndaloi. I vogli e uli krahun.

- Hajde ikim – tha- po më hahet bukë.

- Prit edhe nji . Të betohem edhe nji. – tha i madhi duke hedhur sytë nga kthesa

***

- Prit ! – thirri ajo papritur dhe ai tërhoqi këmbën nga pedali i gazit.

- Ndalo pak të lutem ! Te ata dy çunat e vegjël atje!

Ai hapi krahun dhe e ndaloi makinën. Ajo doli dhe iu afrua të dy djemve të vegjël me tufat me lule. Të madhit i shkëlqyen sytë .

- Dy tufa – tha ajo

- Pesëqind lekë të vjetra – tha i madhi.

Ajo hapi çantën e vogël nxorri portofolin po nuk gjeti të vogla.

- Ke të vogla ? – I thirri të shoqit

- Jo . Tha ai . Kërkoi nëpër xhepa dhe nxorri një kartmonedhë . – Pesëmijë të vjetra, kjo është më e vogla që kam .

Ajo e mori kartmonedhën dhe iu drejtua djemve

- Keni kusur ?

- Jo – i madhi mblodhi buzët.

I vogli anoi kokën dhe e pa me kureshtje duke mbyllur njërin sy nga një rreze e pjerrët dielli që i ra papritur në fytyrë. Dielli po perëndonte, qielli në anën përkundruar rrugës dukej sikur kishte marrë flakë ndërsa e gjelbra e dy shpateve të malit anës pllajës së vogël ishte bërë më e thukët. Lumi nuk shquhej më sepse drita që binte mbi të në mëngjes, tashmë e kishte tejkaluar dhe shtëpia dukej akoma më e vogël. Gruaja ktheku kokën duke pyetur me sy nga i shoqi ndërsa ky iu përgjigj me një lëvizje disi nervoze të kokës.

Befas i madhi i pëshpëriti diçka të voglit në vesh, pastaj i mori të dy tufat e luleve dhe ia zgjati gruas

- Merri teta – i tha – ne do mbledhim të tjera nesër.

- Oh, falemninderit  - tha ajo. - Ju falemnderit.

Hezitoi pak dhe i mori, pastaj u ktheu shpinën dhe u fut në makinë . Burri shty derën,  rrotulloi timonin dhe shtypi pedalin e gazit.

***

Dy djemtë, morën rrugën poshtë shpatit për te shtëpia e vogël, i madhi përpara dhe i vogli duke nxituar pas tij.

- Nuk e kuptoj pse i duan lulet – tha i vogli pas pak – Në qytet rrobat vijnë erë të mirë më të mira se lulet tona.

I madhi nuk foli. Vazhdoi të ecte shpejt për të arritur në shtëpi. Edhe pak fillonte të errej.

# CHARLES BAUDELAIRE

# TIRSI

*Për Franz Liszt*

Çfarë është tirsi? Në kuptimin moral dhe poetik të fjalës, është një emblemë fetare në dorën e atyre priftërinjve dhe priftëreshave që i thurin lavde perëndisë së cilës i shërbejnë dhe i zbërthejnë kumtet. Por në të vërtetë, s'është veçse një shkop, një shkop i thjeshtë, një purtekë kulprash, një mbështetëse vreshtash, i thatë, i fortë dhe i drejtë. Rreth e rrotull këtij shkopi, duke formuar dredha kapriçoze, lodrojnë dhe harbohen kërcej dhe lule, disa dredharakë si vëthë, të tjera të varura si zile apo si kupa të përmbysura. Dhe një lavdi e habitshme shpërthen nga ky gërshetim vijash dhe ngjyrash, të ëmbla ose verbuese. A nuk duket sikur vija e lakuar dhe spiralja i bëjnë korte vijës së drejtë dhe i kërcejnë përqark me një adhurim të heshtur? A nuk duket sikur të gjitha këto kurora dhe kupa lulesh të brishta, shpërthime aromash dhe ngjyrash, kërcejnë një fandango29 mistike rrotull shkopit të shenjtë? Po kush është ai i vdekshëm i pakujdesshëm që do guxojë të gjykojë nëse lulet dhe pjergullat janë krijuar për shkopin, apo nëse shkopi është vetëm një shkas për të treguar bukurinë e pjergullave dhe të luleve? Tirsi është mishërimi i dyzimit tuaj të habitshëm, mjeshtër i plotfuqishëm dhe i adhuruar, Bacchant i dashur i Bukurisë së mistershme dhe të pasionuar. Kurrë ndonjëherë një nimfë e nxitur nga Bacchus-i i pamposhtur nuk e ka shkundur tirsin mbi kokat e shoqeve të saj të marrosura, me energjinë dhe fantazinë me të cilën ju tundni gjeninë tuaj mbi zemrat e sivëllezërve. Shkopi, i drejtë, i fortë dhe i palëvizshëm, përfaqëson vullnetin tuaj; lulet janë shëtitja e fantazisë tuaj rreth vullnetit, elementi femëror që kryen rreth mashkullit piruetat e tij të mrekullueshme. Vijë e drejtë dhe vijë arabeske, qëllim dhe shprehje, ngurtësi e vullnetit, dredhë e fjalës, unitet synimi, larmi mënyrash, përzierje e plotfuqishme dhe e pandashme e gjenisë, cili kritik do të ketë kurajën e urryer që t'ju veçojë dhe t'ju ndajë?

I dashur Liszt, përmes mjegullave, përtej lumenjve, sipër qyteteve ku pianot i bien lavdisë suaj, ku shtypshkronjat përkthejnë mençurinë tuaj, në çfarëdo vendi që të ndodheni, në mrekullirat e qytetit të pavdekshëm apo në mjegullnajat e atyre viseve ëndërruese që i ngushëllon Cambrinusi30, nëse jeni duke kompozuar këngë kënaqësie apo dhimbjeje të parrëfyeshme, apo duke i besuar letrës së bardhë mendimet tuaja të pakapshme, psalm i Kënaqësisë dhe i Ankthit të përjetshëm, filozof, poet dhe artist, ju përshëndes në pavdekësi!

Përktheu nga origjinali
BESIANA KADARE

# VARIACIONE POETIKE*

## nga Feride Papleka

« ... poezia : arti për të na afruar me atë që ndodhet përtej nesh ».

Odysseas Elytis (Nga ligjërata për çmimin Nobel, dhjetor 1979 )

### Vetërrëfim

Unë nuk do ta kuptoj kurrë
Në është dëshpërimi
Apo shpresa
Që më frymëzuan këto poema
Ajo që di
Është se nuk e di
Prej nga zbritën
Duke rënë pa formë
Përpara syve të mi
Të stolisura me një zë të padëgjuar:
Ndoshta është e kohshmja
Që përpiqet të bëhet
E tejkohshme...

1
Poema ime është
Një Je est un autre**
Që shfaqet e druajtur
Si në ëndërr
Duke shqyer errësirën
Për të dalë në dritë
Trupi i saj :
Një i SAPOLINDUR.

2
Një poemë duhet të jetë
Përgjigje
Që shpaloset dhe fshihet
Strukturë e hollë
Ku dëgjohet
Edhe zhurma e barit
Që rritet
Dhe na mëson
Ritmet e jetës.

3
Ndoshta poema është
Një tension melankolik
Që jeton në fshehtësi
Një kambanë
Që tingëllon prej së largu
Fytyra fëmijësh
Që pasqyrohen në ujë
Manushaqe të reja
Të çelura në livadh
Një lumë që zbret nga mali
Një heroizëm.

4
Në një poemë të vërtetë
Gjithçka lëkundet
Si një gjethe
Mes uraganit
E dukshmja
Bëhet e padukshme:
Shpërthimi i fjalës
Kërkon hapësirë
Për të treguar
Në jemi të humbur
Apo fitimtarë.

5
Me sa duket poema është
Një jashtësi
Që ndriçon brendësinë
Me një sy origjinal;
Një timbër
Që dridhet në kraharor
Një shpresë e përjetshme
E mbështjellë me një dritë
Ngjyrë jete.

6
Një poemë mund të jetë
Tekst asimetrik
Dhe njëherësh simetrik
Që paraekziston tashmë
Duke u dëshmuar njëherësh
Farë dhe embrion
Si një planet i vogël
Që rrotullohet në univers.

7
Poema ime është
Një çupëlinë e hutuar
Në një plazh
Që sodit detin
Dhe ëndërron
Yjtë mbi kokë
Si kurorë
Mbretëreshë pa fron;
Mbase është aurorë
Që vezullon
Mbi këtë balonë të portokalltë
Që quhet Tokë.

8
Një poemë duhet të jetë
Një thirrje
Që ia beh papritur
Nga një kënd i trishtuar
E që transformohet
Në vajtim
Për të vdekurit e pafajshëm
Të kësaj bote
Kaq të madhe e kaq të vogël
Që quhet ndryshe
Shtëpia jonë
Fshati ynë.

9
Ndoshta poema është
Model dhe kundërmodel
I hedhur në hapësirë
Që përzien
Jetë dhe vdekje
Dritë dhe errësirë
Këngë dhe vaj
Në një kohë të harruar
Vetmitare.

10
Në një poemë të vërtetë
Ka heshtje
Që flet
Jo heshtje e agonisë
Por heshtje stuhie
Bukuri që vuan
Me një gjest të vendosur
Në gjakim të shpirtit.

11
Me sa duket poema është
Rebele
E rrëmbyer
E pabesë
Që vjetrohet shpejt
Dikush që vrapon
Për të gjetur vetëdijen
E nënvetëdijes.

12
Një poemë mund të jetë
Parashtrim tepër i çastit
Që depërton hijet
Dyshimet
Pyetjet
Episodet e dehura
Dhe mbush zbrazëtinë
Dhimbje e kënaqësi bashkë
Një mynxyrë.

13
Poema ime është
Një organizëm
Vertikal
Horizontal
I pjerrët
Që hesht
Që dialogon
Që ecën
Që ndalet;
Fatalitet
Që edhe mund
Të më vrasë
Unë s'mund t'i shmangem
Është e pashpjegueshme.

14
Një poemë duhet të jetë
Një aparat magjik
Që ndërton
Vatër që ngroh
Një vështrim i ëmbël
Dhe marramendës
Engjëll
Orë profane
Trajektore e padukshme
E pandërprerë:
Gjendje e kulluar.

15
Ndoshta poema është
Një mahnitje deri në çmenduri
Që zbulon fjalë gjysmë zgjuar
Duke zhbërë imazhin narsisik
Dhe duke endur
Të vërteta të njëmendta:
Bukuri e papërshkrueshme
Që fshik vdekjen!

16
Në një poemë të vërtetë
Ka një rregull
Që rri pezull
Një luftë virtuale
Drejt një sekreti
Dhe një skaji pa emër
Një ecje kundër rrymës
Të pakuptueshme
Si shfaqja e reve
Në një qiell të kaltër
Pikturë e shpirtit.

17
Me sa duket poema është
Një material pa konture
I stampuar në eter
Tekst që dëshiron një formë
Arsye e mosarsyes
Vështrim i humbur
Jashtë kohës
Pika pa sipërfaqe
Etre sans destin ***

18
Poema mund të jetë
Një ndjesi e çuar dëm
Që gjen zemrën e vet
Një ide
Që vërshon
Në kërkim të fjalëve
Duke u ngallmuar
Në një varg të epërm
Çlirim i menjëhershëm
Nga ankthi i vdekjes.

19
Poema ime është
Një dashuri sublime
E ndritshme dhe e errët
Pa kontekst
Që nuk vdes kurrë:
E shquar, abstrakte
E pavarur
Si drita.

20
Një poemë duhet të jetë
Kohë për t'u dashuruar
Një lartësim
Midis ëndrrës dhe zhgjëndrrës
Një tingull në largësi
I ardhur nga përtej mjegullat
Që gjallërohet
Sa takon brigjet e kohës
Realitet i thellë
Rrugë fati
E shtegtarit pa atdhe
Një fitore
Përballë rrezikut
Covid-19.

21
Ndoshta poema është
Një flakë e vogël marrëzie
Ngurruese, e hijshme
E habitur
Jashtëzakonisht e mrekullishme
Që lë një shenjë të dukshme
Për një të ardhme
Natyrore.

22
Në një poemë të vërtetë
Ka dy njerëz
I pari është me kokën në re
I dyti me këmbët në tokë:
Dyluftim i përgjakshëm
Shenjues apo i shenjuar?
Prani apo mosprani?
Figurë apo trup?
Përçartje.

23
Me sa duket poema është
Një lundër e përmbysur
Dhe deti i imagjinatës
Me busull të humbur
Në orët natore
Të gjithë poetët dëgjojnë
Heshtjen
Dhe i kuptojnë
Vlerat e urtisë.

24
Poema mund të jetë
Një përmbifjalë
Që papritur
Bëhet
Zë
Vështrim
Trup i tërë.

25
Poema ime është
Ai mëngjes i mbinatyrshëm
Në një datë të shenjtë
Kur një murmurimë
E ardhur nga një bebe
Që ishte im bir
Si një ndriçim hyjnor
Më zgjoi
Muzika e tingujve të mistershëm
Që nxirrte fryma e tij
Dhe lëvizjet e vrullshme
Të doçkave e të këmbkave
Në ajër
Si të donte të përvijonte
Udhët e ardhme
Formonin një partiturë të tillë
Sa asnjë orkestër në botë
Nuk mund ta vejë në muzikë.
E fshehur nga vështrimi i tij
Shpirti im ishte përmbytur
Me një lumturi të panjohur:
Arsye e qenies sime.

---

*Shkruar në Paris frëngjisht gjatë ngujimit të madh 2020 nga pandemia. Tekstin frëngjisht do ta paraqis në një shtëpi botuese që më ka ofruar botimin në Francë, por atë të përkthyer në shqip nuk e pranojnë në vendin tim; ndonjë shtëpi botuese thotë nuk botojmë autorë shqiptarë, disa thonë duhet të paguash, ndonjë tjetër thotë se e ka bërë planin e botimeve...

**Pohim i famshëm i poetit Arthur Rimbaud, shprehur në një letër.

***Roman në frëngjisht i shkrimtarit hungarez, Imre Kertész (1929-2016), fitues i çmimit Nobel në letërsi, 2002.

# KUR LIND NJË GJUHË

## Poezi nga Kjell Epsmark

*Përktheu nga suedishtja Edita Kuçi Ukaj*

*Kjell Espmark është poet, prozator, dramaturg dhe kritik letrar suedez. Ai ka punuar si profesor i Letërsisë Krahasimtare në Universitetin e Stokholmit në Suedi dhe nga viti 1981 është anëtar i Akademisë Suedeze.*

*Veprat e tij letrare janë botuar në më shumë se njëzet gjuhë dhe është laureuar me shumë çmime suedeze dhe ndërkombëtare, ndër to Çmimin Tranströmer 2010, Il Premio Capri 2012, Il Premio Internazionale Camaiore 2015, një çmim i laureuar nga 21 shkrimtarë të rinj kinezë. Në vitin 2018 u laureua me çmimin Sorescu. Ai është oficer i L´Ordre de Mérite.*

*Në gjuhën shqip është botuar vëllimi i tij me poezi, "Kur u mposhta nga stuhia", OM, 2019, përkthyer nga Edita Kuçi Ukaj.*

### "...por pa dashuri, do të isha asgjë"

Me drita të shuara makina zhytet
në rrugën e pyllit të vjeshtës së rrallë
gjurmë të shtrira nga karroceria dhe
verniku në errësirë.
Si mbetjet prej një afisheje të rrëmbyer
në një mur të pistë çimentoje. Të dashurit
në ndenjësen e parme
janë duke u liruar nga njëri- tjetri.
Fytyra e saj e hapur duket sikur të kishte
parë Zotin.
Por duart e saj që kërkojnë qorrazi shpirtin
e tij
gjejnë vetëm grimca të thara qeseje
plastike
të ngjitura përreth kraharorit të
brendshëm.
Ai është pothuajse abstrakt, duhet të lypë
jetë aty ku ka.
Ajo ka. I gjithë trupi i saj i rendë e pa peshë
me sutjena të tërhequra poshtë dhe shpinë
te timoni;
është një operacion shpëtimi. Natyrisht
dashuria kërkon të vetën.
Ajo vendos emrin e *saj* në gojën e tij,
përsëri e përsëri.
Fryn frymën e *saj* brenda në mushkëritë
e tij.
Por kur ai drejton trupin, të thyer,
merr formën e vet.
Kush është ai? Gjuha te flokët e tëmthit
ndjen përhapjet e tij që goditin nga një
bateri:
një turmë zërash dhe fytyra olimpike
që e përkufizojnë atë në paarritshmëri.
Ajo pranon përçmimin e errësirës
kur i dhuron lëkurë nga lëkura e saj
dhe ta ndjek atë një copë, lëkurë në lëkurë.
Ajo detyron frikën e saj për këmbimin e
artë të pikëpamjeve,
ndjenja dhe mendja e tij humbasin në të.
Një gjuhë thithëse e pakuptimtë.
Më në fund ai fillon të rëndojë nga materia
e ëmbël.
Ajo i dhuron, pafrymë, gjithë frymën e
dendur.
Tani ai vjen te ajo, një gjëmim si ditën e
gjashtë.
Cukat e saj të lakuara marrin thirrjen e tij,
por një thirrje që iu është drejtuar të
gjithëve dhe askujt!
Ajo nuk e sundon atë.
Kur ai u kthye te sytë e tij
pasi mori sytë për t' u kthyer,
shleu fajin me një buzëqeshje.
Pastaj ai kujdeset lirshëm për
përkohshmërinë
dhe ndezi një cigare drithëruese,
i paprekur në rrethin e tij të ndritshëm.
Ajo është zvarritur përgjithmonë,
një ndërmjetësuese e nënçmuar që nuk
nxiton për në shtëpi.
Vështron përmes katrorit të mjegullt, të
paprekshëm
dhe krejt qartë sheh e vetme
gjithë atë errësirën të jashtëzakonshme.

### Falsifikuesi i monedhave

A ju kujtohet:
ai lexonte më një zë prej bakri.
Drita regëtinte para karriges së tij.
Te gjithë e mbanin frymëmarrjen. Kur ai
heshti
mbi Akademi u zgjat një pëshpëritje.
Tani e veja djeg letrat e tij.
Kujdesshëm qep dhe shqep kujtime,
përsëri, çdo herë vetmitare.
Ajo lë pas vetëm atë që ngjan
me portretin e sigurt në mur.
Dhe në tokën e dredhëzave i fut
dashnoret e vdekura.
Ajo ka korruptuar karriget me heshtjen e
saj.
Dhe më së shumti frikësohej
nga ato letra e shpërndara në erë.
A do të hedhë ai prej zarfi
një satirë të rëndë dhe të fuqishme?
A do të ngulfatet ai nga letra
me sy të kuq dhe gojë të shtrembër?
Në ankth ajo ruan kujtimet e tij.
Dhe e sheh atë përsëri në ëndërr
gjysmë të kthyer nga ajo-
të heshtur, me përçmim të padurueshëm.
Me padurim numëron në dorën e tij
monedhat e forta e të pavdekshme.

### Rrugëtim i një peshkatari

Mbi bjeshkë bredh lulëzimi i manaferrave.
Nata më e ndritshme se livadhi i
pambuktë.
Grepi me mizë lëkundet në pritje të kotet.
Mushkonjat zhduken nga toka.

Kur bie peshku në grep bota tkurret.
Milingonat rrudhen si pëlhurë
rreth vorbullës nga frika e pellgut.
Grepi kërcen drejt reve.

Tani rrapëllin! Dhe zemra i rënkon.
Është një ishullth i përdredhur!
Litari largohet. Unë plakem.
Tërheqjet flasin një gjuhë të panjohur.

Atje poshtë nis një magji kërcënuese
që vetëm durimi mund ta zotërojë.
Orët e jetës sime derdhen
gjatë litarit poshtë në thellësi.

Mjegulla e mëngjesit mban erë kafeje.
Zëra të ngjirur bredhin rreth zjarrit.
Pushojnë të sigurt në enën e kripës
gjahun e të tjerëve të shkëlqyeshëm.

Qëndroj akoma i vetëm mes bregut
shelgjishtër
me litarin e prerë në dorë.
Preja ime zhytet, e madhe sa një qark.
Dhe mali përsëri largohet.

### Ringjallje

Ne barkën e lamë të pa ankoruar
dhe u çapitem drejt e te ishulli i
pakalueshëm
me kokat që na shushurinin. Një det i
lashtë
u zhduk mes pemëve.
Ne mes të diellit u shtrimë në bari.
Lëndina e kuqe u shua.
E fundit gjë që pashë ishte pulsi i fytit
tënd.

Së pari u krijua zukatja e mizës, pastaj
drita.
Ne picërrojmë sytë dhe shohim botën
teksa përtërihet.
Era mbush pemët me gjethe.
Ti qesh sepse bari ekziston.
Pilivesa ngrihet, zhytet, ngrihet.
Dhe një mijë vjet kanë kaluar.

### E paimagjinueshmja

Oficerët me pamje metalike
bëjnë pyetjet e tyre të shtrembra.
Ajo hesht. Ato fshatra të torturuara
heshtin me të. Ora e dorës afrohet.

Kur furtuna prek në trupin e saj,
rezervarët gërvishten.
Por ulërima e saj nuk mund të
interpretohet.
Ka shumë gjuhë në të.

Është dita e tretë e torturës.
Llambat diellore enden të shkreta.
Çdo arsyeshmëri është pompuar nga
dhoma.
Dhe mbi atë mbështeten milingona të
mëdha.

Ato i kafshojnë copa lëkure
dhe futen brenda zemrës së saj.
Atëherë ajo dorëzon botën si në narkozë.
Ajo nuk është më qendra e ekzistencës.

Por ajo gjendet në sytë kërkues të tjerëve
(për një rreshter të ri ajo bëhet njeriu i
torturuar ndërsa shekujt mashtrojnë.
Ai përulet jashtë dritares dhe vjell.)

Një vend i prishur me fshatra dhe rrugë.
Ata pllaquriten rreth kujtimeve të saj
që ruhen vetëm nga dridhjet
reflekse në një pëlhurë të zhveshur.

Stenografi qëndron me bllokun e tij të
spërkatur
mes rrymës së mendjes së topitur
dhe shkarravit ca fakte të shpërndara
të atentatit të qershorit.

Atëherë vezullon edhe një kujtim i
papritur:
si një dorë e zgjatur për ujë të rrjedhshëm,
ku ajo përkulet për të mirëpritur një burrë.
Oficerët shikojnë njëri - tjetrin dhe
zgërdhihen.

Hetimi mbaron. Ajo shtrihet e qetë
nën të çarën e dritares, përtej rënkimit.
Qielli bosh, as ngjyrë dhe as re.
Klithmat e zogjve janë larg dhe të
pafuqishme.

### Mërgimtarët

A jua errësojmë ne qiellin e natës
me tërheqjen e procesionit të
kampshtëpizave, me makina
të ndryshkura, biçikleta kërcëlluese, qen
dhe plaçka?
A bëhemi grimca në gypin e madh
me leckat tona të shqyera, fëmijë të ndotur
te gjinjtë-
të palindurit, pas, nuk arrijnë.
Jo, ju i shihni yjet përmes nesh
përmes kësaj britme turme
të hollë sa një premtim
dhe e përndjekur që prej agut të kohërave.
Askund nuk mund të paguajmë
tatimin komunal kozmik
ose uljen e vlerës së vilave të fqinjëve.
Provojeni një tjetër galaksi, ju thatë.
Po mundohemi. Ne po hulumtojmë për ju.
Jeta jonë e pa kohë, e papërcaktuar
është një eksperiment i pastrehë.
E kaluam përmes gjuhës suaj.
Duart tona u formuan parmës çelësave
mashtrues,
prej tërë duarve tuaja të mbyllura.
Fytyrave tona iu zhvesh pafajësia
para gjithë atij dyshimi.
Ja pra këto na ndodhën.
Dhe nëse dëgjoni zhurmat e borive të
makinave dhe të tiganëve
prej vite larg në kohë dhe arsye,
kemi gjetur një kontinent të ri për ju.

Me kapelën mbi fytyrë
pushoj në bar. Përherë jemi të ndjekur
edhe mes yjeve skajore.
Shelg barishte lart përmes gjoksit. Bari
lëvizës.
Pjesa e përparme e trenit
ka të njëjtën ngjyrë si errësira.
Unë jam një prej atyre të fundit.
I dëgjoj ata, hapat drejt zhavorrit, rrota
kërkëllitëse
Ankime fëmijësh, gjithë këto zëra
i kemi pasur me vete, gati të këputur jemi
tani.
Do të përpiqemi në galaksinë tjetër.

### Dhoma e izolimit është gjithë heshtje

Nuk mund t´i bindej më atij dëshpërimi
që e lejoi t'i ngulitej.
Me pjesët e mbetura të duarve të
ndritshme
e mbërthen vrullshëm mjekun.
Ndihmomë të lirohem nga jeta ime!
Dhe ndihmomë që t'i dorëzohem asaj
që askush nuk donë t'i thotë emrin.
Ajo shtyp shkretimin e saj afër tij.
Por mjeku shqyen veten, i ashpër ndaj
tmerrit.
Shkarravit në fletore; shenjat e
shqetësuara
mohojnë që ajo farë ekziston.
Ajo ka rënë prapë në shtrat

dhe dridhet nga poshtërimi.
Shikimi i infermieres e lut për durim.
Duart e saj strehohen te bula:
premtim pas premtimi për jetë
lejon vetës të zhytet në krahun e venitur
pa asnjë detyrim.
Për shkatërrimin e trupit ka një rutinë.
Kockat e legenit të saj zbrazën nga dhimbja
në çaste të caktuara. Bashkësitë
kujdesen mirë për mbetjet e mishit ndriçues
por tremben nga shpirti ankues.
E vetme duhet të lirohet
nga sytë e fëmijëve të mëdhenj të pangjyrë
të mbushur nga frika para lëkurës të shkëlqyer
dhe gjithë asaj zbrazësie të pështpëritur në jastëk.
Ajo deshi ta prekë vdekjen e saj me duart e tyre.
Por së fundi i bashkon vetëm tmerri.
E vetme i duhet të përballojë zemërimin e pakuptimtë
që herë pas here i zë vendin e dhimbjes.
E vetme duhet të lëshojë kapjen e zbardhur
në rrethin e shtratit
dhe të largohet nga uji, tërësisht e trullosur
me hapa që morfina heqë çdo rëndesë.
E vetmja gjë që ajo mban me vete
është një kujtim pulsues tradhtie.

## Ende më quajnë Osip Mandelstam

Jo, kjo nuk është migrenë.
Është mbetje e një detyre
të goditura
mbetur në zbrazëti.

E kam shumë vështirë të marr frymë, Nadja.
Sikur të ishim shtrirë ende në kasolle
dhe të këqyrnim tavanin: një grumbullim aq
i madh që s'ka vend në fjalën `turmë`.
Kjo barakë është një varr masiv
ku i ndajmë vdekjet e njëri - tjetrit. Dëgjojmë mendimet
e ngadalshme të tjerëve duke kërkuar në dhomë
pas një dritareje. E qartë si era
e shurrës këtu brenda.

E mësova në fund,
tretje në zjarrmi dhe jashtëqitje,
të mendosh me trup.

Dhe puhia që kalon përmes dhomës
(nga erdhi ajo?) më jep fuqi.
Dikush merr frymë për mua.

Arrita të mendoj dhe e ngre krahun
duke këqyrur nga dritarja.
Duket si asgjë nuk ka ndryshuar:
peizazhi i zbrazët, mungesa e oksigjenit,
era siberiane e vetmisë – gjithçka është njësoj.
Babai i kombit e dinte deri në grimca
se mbretëria e vdekjes është e përbërë. Jetova tashmë
sikurse vendi të mos ekzistonte.

Sytë e tij janë vetëm një paranojë e shtangur prej ku mund të shoh,
mustaqja vetëm një tërbim ujku gri që nuhat
një Rusi tjetër në mes të Rusisë së tij,
një vend që bën vendin të dukshëm.
Me yjet poshtë, me pamje elastike
që u japin atyre njoftimet që ai kërkoi.

Se si ata që e drejtojnë realitetin
i trembën poezisë: një kundërshtim i papritur
që e bënë të mundshme të shoh.

Ata duhet thjesht ta ngulfatin zërin tim.
Më ndanë larg prej kujtimeve të lexuesve
siç prehet një faqe nga enciklopedia.
Atë që askush nuk e dëgjon
ngulfatet nga fjalët e veta.
Pesë frymëmarrje të thella më thonë
se i shpëtove dorëshkrimet
dhe që ka njerëz që i lexojnë shkrimet e mia. Dikush
shfleton një faqe: më jep fjalë që të shoh.
Fikson harkun e zbrazët të dritares. Kovën
në kënd: një kundërmim i shtypur nga ideologjia.
Shoh shumë qartazi se kam vdekur.
Shoh se asgjë nuk ka ndryshuar.
Fjalë të reja realisht dalin nga goja
dhe lëvizin këtu përmes zbrazëtirës.
Do të me gjejnë mua të krimbur nga poezia
megjithëse dhoma është e tymosur.

Askush nuk shkruan pas vdekjes, thua ti.
Por e ke gabim pra, Nadja!
Nëse unë do të mbaroja
zemra jote do të mbarojë së rrahuri
dhe Rusia do mbetet një koncept i shkretë.

Nuk guxon të besosh?
E shoh dyshimin tënd të degëzohet
jashtë dritares, një e gjelbër e qartë.
Fjala ime lëshohet lëkundshëm në të,
disa tone të imëta, një lëmsh
që detyron të gjelbrën të pavendosur në gjethe,
ku dhe një saktësi, me pesë gishta.
Ndoshta për një minutë
fjala e shndërron në panjë
këtë pemë që nuk ekziston
dhe pema shndërron fjalët në gardalina
që tundin skajet e degës. Asnjë tingull
nuk është aty ku pritej.

Rruga bëhet për një çast e qartë-
është rruga për në Vladivostok.
Dhe ti je aty.
E ndjej se je aty dhe sheh në errësirën time.
Mos ndalo së marri frymë për mua!
E ngriti dorën time në erën tënde.
Rrafshina e baltosur përmban një Mesdhe.
Velat e delfinëve poshtë nën tokë
lërojnë pandërprerë, si dora e shkruesit.
Kreta në lartësinë e lëkurës vezulluese
është zëne në baltë. Valët ngritën,
mezi munden të mbajnë pohimin e tyre-

Errësirë. Është shumë herët.
Kujtimi im i vetmuar mërdhin.
Si e mora konceptin `mantel` në dorë?
Do ta kesh ti, dërgoma.
Një mantel kaq e vjetruar. S'kam më si ta ndreq.
Por prapëseprapë ai mbetet një mantel.
E mbështjell shpejt vendin e mërdhirë.

Duhet të tregohem më i duruar.
Më duhet t'ia filloj me më të afërmen.

Tani do të mendoj një fjalë të thjeshtë:
përulësi. Iku te pragu i dritares,
jo, aty ku pritej të ishte prag i dritares,
saktësisht pedante,
por e pamundur të parashihet. Duket
se hyn dhe del i palënduar nga vdekja,
brenda dhe jashtë botës sime, në botën tënde.
Tani merr rrugën e shkurtër mbi një gisht.
Ekziston po aq sa një çast. Kundërshtimi
i fjalës është befas lumturia.

## Kur lind një gjuhë

Kur lind një gjuhë,
një ditë të gjitha do të thuhen
si një kruarje nën qiellzë.
Barinjtë që rrinë kruspull rreth zjarrit
dhe provojnë një tingull për ngrohje
ndjejnë një letërsi të tëre në gojë,
por e kanë vështirë ta marrin me seriozitet.
Ata ngërdheshen me ngjashmërinë e një thirrje
dhe sytë e dhive jashtë në errësire.
Mund ta kapësh rreth një trill me fjalë!

Një djalë me shpinë të kërrusur dëshiron t´i thotë
vajzës së tij se ajo diellin e bënë diell
por gjuha i rrëshqet. Ende
janë letrat më të bukura të dashurisë,
të shkruara shekuj më vonë,
tashmë në murmurimën e tij jo guximtare.

Ai që sapo vendosi dru në zjarr
përbën dramën më të madhe të gjuhës.
Ai do të lindë së paku edhe njëmijë vite
por gjuha e pamësuar e barinjve
është e mbushur me citate prej veprave të tij.

Deri sa kjo gjuhë të flitet,
askush nuk do të ketë nevojë të ndahet nga bari dhe retë,
asnjë të tërhiqet nga ajo që e dashuron:
sepse të gjallët nuk kanë varreza.

## Nga jeta ime më kujtohet vetëm një çast.

Qëndroja tek uji i plazhit
me fundin e kuq të ngrehur
dhe e shtyra një varkë të vogël prej kallami
me djalin tim të porsalindur në të.
Valët më kishin premtuar se do të kujdeseshin për të,
kur ushtria armiqësore do të afrohej.

Qëndron një shkëlqim rreth atij çastit.
Unë bëra ashtu siç miti kërkoi
dhe e lashë varkën duke u lëkundur larg.
Por ende në ketë errësire të përjetshme
mund ta dëgjoj britmën e djalit.

## Ecim përmes pyllit në Runmarö.

Tomasi, lart në mes të Baltikut,
nxiton në stilin madhështor. Ai më ka lejuar ta lexoj-
dhe të vërej si era nga Baltiku
përbën zëra me vrima pas gërshërëve me censorë.
Dhe se si do të ndodhë tanimë është këtu
por nuk do të flasë.
Hala e pishës është një tekst kodues
dhe retë ndërrojnë, nuk dëshiron të lexohen.
Një kursive precizon: është një *afazi*.
Por është një memecëri që mund të mposhtet.
Sikur ai kompozitori rus
që pas një goditje në tru nuk kuptoi tekstin
por arriti të shkruaj muzikë për të.
Kjo ngjashmëri e njeh një fragment të ardhmes!
Nëse Tomasi kishte dëgjuar sesi një derë
godet prapë në një kohë të mëvonshme
por lë jehonën e vet tani.
Kandili i detit që stërpik në ujin e plazhit
vezullon prej porosisw rrezikuese.

(Për Tomas Tranströmer)

# FJALORËT, ZEJTARIA E ZGJEDHJES SË FJALËVE

Nga Mark Simoni

James Howell thotë te "Historia dhe leksikografia", se: "Fjalët janë burimi i dijes, dhe pikërisht për këtë shkak të tyre ne jemi të lirë. Ato janë si mamitë që ndihmojnë të sjellin në jetë të vërtetën. Dhe bash prej tyre dallojmë xhentelmenin, (pra zotërinë) nga kllouni, ndajmë filozofin nga i çmenduri. Ne flasim për shkak të natyrës, por fjalët ama i zgjedhim me art. Dhe zejtaria më e lartë e zgjedhjes së fjalëve, është bërja e fjalorëve, punë cilësore që na hap dyert e kësaj zgjedhjeje të leksikut.".

Dhe vetëm kjo devizë është e mjaftueshme që të shtyjë studiuesit dhe njerëzit e kërkimeve, zbuluesit dhe shkencëtarët e gjuhës të kërkojnë nëpër kohra fjalorët zanafillorë, përpiluesit e tyre, historiografinë e gjuhës dhe të vokabolarëve.

Gjuha shqipe herë ka qenë fatlume mbasi në matricën fillestare, bash atëherë kur po ngjizej dhe themelohej, ka patur maturimin dhe pjekurinë e hulumtuesve të famshëm të gjuhës. Po ashtu dhe siç është e pafate, sepse një pjesë e volumit të dorëshkrimeve dhe fjalorëve të mbledhur e të përgatitur për botim, kanë humbur, janë dëmtuar e djegur, si pjesë e atyre fatkeqësive që kanë ndjekur dhe fatin e kombit tonë.

Nuk duhet të harrojmë se bota e gjuhës si disiplinë dhe si fushë studimi është shumë serioze dhe po ashtu e herëshme, që prej qytetrimeve antike.

Prova e pare historike e fjalorëve janë kuneiformet sumero-babilonese, ku kemi pikë së pari dokumentimin e fjalëve dhe përkrah shpjegimin e tyre, (ku janë zbuluar 30.000 dokumente balte) Një fakt tjetër interesant është se, në lindjen e largët, një farë Xu Shen, konfucian i shekullit të parë para Krishtit, përpiloi një fjalor me 10.000 zëra.

Drejtori i bibliotekës së Aleksndrisë, filozofi i famshëm Aristofan, ishte i pari që provoi të shkruante një fjalor gjithëpërfshirës, (plotësisht e humbur si vepër).

Pastaj Marcus Verrius Flaçus (De Significatu Verborum- "Kuptimi (domethënia) e fjalëve"), një vepër me 20 vëllime, (që ngelet vetëm një manoskript i dëmtuar, që është së bashku me një dokument tjetër të shekullit të 8 ku janë titujt e veprave).

Këto janë thjeshtë një pjesë fare e vogël nga kalendari i punës me fjalën dhe fjalorët e famshëm dhe seriozë, që qenë shkolla e parë e leksikografisë së mëvonshme.

***

U desh një njoftim në faqet 169-170, të numrit 10, të revistes "Albania" të vitit 1897, (që botohej në Bruksel, në shqip dhe frëngjisht), që të rroposte në çast besimin e deriathershëm se, "nuk kishte dokument ( fjalor) të shkruar në shqip, para shekullit të 17". Ky lajm zbriti nga froni i të qenit i parë "Fjalorin e Frang Bardhit", (Dictionarium Latino-Epirotikum, botim i Romës me 1635). Dhe këtë më të hershmin se të Bardhit na e kishte shkruar Arnold von Harff në vitet 1496-1499. Qe shkruar hollandisht dhe kishte dhjetra e dhjetra fjalë të shqipes, një listë të gjatë fjalësh dhe shprehjesh, nga ato



më të përdorshmet, si bukë, kripë, mirë, keq, burrë, grua, po, jo, ujë, mish, gjah, të hash, të pish, mirëmbrëma, mirëdita, kalë, elb, si dhe numrat nga një deri në dhjetë.

Revista "Albania" e pati premtuar botimin e kësaj liste, ( fjalor) në numrin 11 të saj, (numri pasardhës), por pastaj u mjaftuan vetëm me historikun e këtij fjalori, që qe ribotuar në 1860 në Këln (në gjuhën gjermane), dhe po në gjermanisht në 1873 nga Karl Horfi në Berlin.

Kjo ngjarje gjuhësore nuk ia zbehu aspak lavdinë Fjalorit të Frang Bardhit  që daton në 1635 dhe titullohet "Dictionarium latino-epirotikum", (Fjalori latino-epirot). Është 222 faqesh plus 18 faqe të pa shënuara me numra. Madje në këto faqe të pa emruara me numra Bardhi shkruan dhe arsyet që e shtynë dhe e bindën të punojë këtë vepër kaq të vlefshëm. Ky fjalor do të ndihmonte jashtëzakonisht shumë në ruajtjen e gjuhës sonë që po zhbëhej dita ditës dhe po humbte formë. Gjithashtu Bardhi e dinte mirë se ky fjalor do të qe një doracak shumë i vlefshëm për misionarët e fesë, që duke patur mangësi në njohjen e latinishtes, ata kurrësesi nuk do të mund ta kryenin misionin e tyre në mënyrë korrekte. Në fillimet e tija, Bardhi e kuptoi se fjalori që pati hartuar qe i vogël dhe i pamundur ta kryej misionin si duhej, ndaj vendosi ta zgjeronte me numrat, me gjeografinë e qyteteve, kështjellave dhe toponime të tjera të rëndësishme, përfshiu mbi 100 proverba, një listë mënyrash të të përshëndeturit, etj. Sipas Bardhit ky fjalor do të ndihmonte priftërinjtë që nuk e dinin latinishten, (duke i disiplinuar me fjalet shqipe) dhe ashtu pa dashje në Mesha e shërbime thonin tjetër për tjetër, duke devijuar shenjtërinë e postulateve dhe teksteve të tjera.

***

Kësaj kohe i përket dhe lulëzimi europian i fjalorëve dy gjuhësh.

"Deri në fundshekullin e 16 kemi fjalorë dygjuhësh ose shpjegues të gjuhëve klasike, dhe pikërisht atëherë "Italianët, spanjollët dhe francezët shpjegonin fjalët pikërisht me gjuhën e tyre"". Kështu shkruante Richard Mulcaster, një autor anglez. Ky autor shikonte me admirim zhvillimet e kulturave të tjera, dhe në punën e tij për të afruar anglishten me këto arritje të gjuhëve të tjera, është dhe i pari që ankohet dhe ngre zërin për huazimet e kota.

Ndërsa në Greqi, dallojmë se fjalorët klasikë ndihmonin lexuesin për fjalët e vështira, që kishte përdorur Homeri në vepren e vet. Impuls i veçantë për fjalorët (dy ose më shumë gjuhësor) u bënë dhe gjuhët e shenjta (hebraisht-greqisht-latinisht, por dhe arabisht), të cilat janë dhe gjuhë referimi për nxënësit që i afroheshin studimit të teksteve të shenjta.

***

Pjetër Bogdani, një prej figurave tona më të rëndësishme të shekujve 15-19, qe njëri nga klerikët dhe dijetarët  që hoqi kalvarin e vuajtjeve dhe përndjekjes për arsye fetare dhe intelektuale. Ka shumë dijetarë të kohës që flasin për veprën e tij "Çeta e profetëve" (shtypur në Padova në 1685). Madje dhe për dinastinë klerikale të Bogdanëve, me Andrea Bogdanin xhaxha i Pjetër B, Gjon Bogdanin nipi i Pjetër B. etj

Por harrojnë të përmendin se, si Pjetër Bogdani ashtu xhaxhai i vet Andre Bogdani kishin hartuar vetë edhe një gramatikë bashkangjitur së cilës qe dhe një fjalor latinisht -shqip, një gramatikë që humbet nga zhvendosjet e vazhdueshme dhe shpërnguljet e Pjetër Bogdanit, duke na lënë kështu një bosh dokumentar të historiografisë së gjuhës.

Megjithëse ndonjë studiues i thellë i historisë së gjuhësisë shqipe e thekson se, At Françesko Maria Da Leçe me punën e tij "Shqyrtimet gramatikore mbi gjuhën shqipe" ka shuguruar me këtë studim veprën e parë të njohur mbi gramatikën e gjuhës shqipe, por pak kush e di, për të mos thënë shumë të rrallë janë ato që përmendin se "At Françesko da Leçe bëri një fjalor të rrallë të gjuhës shqipe, në vitin 1702, (i cili mbeti dorëshkrim dhe i pa botuar)".

Më vonë Dhimitër Kamarda i ka dhënë lexuesit një ekstrakt të këtij fjalori, qe Da Leçe e pati shkruar në Maqedoni.

***

Rast emblematik është ai i "Academia della Crusca" ("Akandemia e krundes") që merrej që atëherë (ky istitucion vazhdon të funksionojë dhe respektohet akoma dhe sot në Itali), dhe fjalorët e saj kanë mision "pastrues" dhe selektiv,  ashtu siç ndahet gruri i dobishë nga krundet.

Në mesjetë kemi nje personazh që për herë të parë i jep një dinjitet të ri fjalëve, Izidori i Seviljes, (Shpallur rishtazi nga kisha si Pajtor zanafillor i internetit) sepse duke krijuar Etimologjinë, na shtyn në një udhëtim brënda rrënjës së fjalëve,  dhe vetë botës që i pati sjellë në jetë këto fjalë, (20 vëllime dhe 448 kapituj).

Pikërisht ato kohë kemi kaq shumë punë të skribëve (zakonisht murgj që merreshin me riprodhimin me dorë të fjalorëve), saqë kemi me qindra e qindra vëllime të shpërndrara kudo, në gjithë Europën.

***

Gustav Majeri na bën me dije për dy leksikë dhe fjalorë shumë të rëndësishëm të pas viteve 1750. Bëhet fjalë për fjalorin greqisht-rumanisht-shqip të Teodor Kavaliotit ("këtij Voskopojari të ditur" konsideratë e bashkohësit të tij profesorit të Universitetit të Halles Thunman) me 1200 fjalë, si dhe fjalorin katër gjuhësh greqisht-vllahisht-bullgarisht-shqip të njëfarë prifti vllah me emrin Daniel. Majeri ka mundur të gjejë fjalorin e Kavaliotit, vetëm në variantin e botimit të Venecias, që mendojmë se i ka shërbyer, si shumë tekste e materiale gjuhësore, në përmbushjen e veprës së tij madhore "Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe" (1891).

Skiroi, në një shkrim të tij thotë se posedon një fjalor shqip-italisht dhe italisht-shqip të At Nilo Katalanit, i lindur nga prindër latinë në Mesina ku dhe shërbeu si Abat në famullinë e grekëve lindorë të Mesinës dhe që nga 1682 shkoi në Korsikë. Thuhet se ky fjalor është po aq i rëndësishëm sa dhe fjalori i At da Leçes. Profesor Skiroi na jep dhe një fakt tjetër, mbi egzistencën e dorëshkrimi të një Fjalori Etimologjik të gjuhës shqipe, të bërë nga Nikollë Keta (1742-1803), rektor i seminarit greko-shqiptar, i cili pat vdekur në Palermo.

***

Fjalorët e viteve 1700 kanë veçantinë e ndarjes së gjuhës formale, (të gjuhëve të mëdha) nga ato që një autor do të qunte "barbarizmat e bashkëbisedimit". Por nga ana tjetër dhe tendencën për të mos i kthyer këto fjalorë në përbindësha që nuk arrijnë dot të shpjegojnë dhe atë që duan të thonë.  Në Francë, pasi stili i jetës arriti në detaje të atillë si: shpjegime të vogla për ditët, festat, tregtitë dhe zejet e qyteteve të veçanta, kemi si reagim prej gjuhëtarëve shpikjen e fjalorëve doracak dhe specifikë, të përdorimit të lehtë e të përditshëm, që të ndihmohej kushdo në bisedat e zakonshme dhe të nevojshme. Kjo praktikë nisi rreth viteve 1760.

Autor interesant i kësaj kohe është gjuhëtari Samuel Johnson, që megjithëse në fillim pati opinione shumë të ngjashme me ato të akademive franceze dhe italiane, pas disa vitesh shprehet "kurrë nuk mund të prangosen rrokjet, aq sa mund të lidhet era".

***

Në Bibliotekën Kombëtare të Parisit është dhe dorëshkrimi i një fjalorthi greqisht-shqip, të Marko Boçarit. Në Paris e pati sjellë si dhuratë Pukvili, mbasi Boçari e hartoi këtë fjalorth në Korfuz në prani të Pukvilit të famshëm. Madje edhe vetë Pukvili e përmend rastin e fjalorit të Boçarit në veprën e tij "Udhëtim nëpër Greqi" (1820-1821).

Një vepër tepër serioze në fushën e leksikologjisë, mendoj se është dhe Fjalori shqip-italisht dhe italisht-shqip i Andrea Gavril Darës (1796-1872), një fjalor i thellë dhe i gjërë, i punuar me shumë cilësi gjuhësore.

Nga këto shënime, argumenta dhe fakte, jo vetëm që kuptojmë angazhimin e plotë të intelektualëve dhe dijetarëve të kohrave për tu marrë me fjalorët dhe gjuhën, por pikësëpari mësojmë se inisiativat e tyre, modelet, format, alternativat e studimeve dhe hulumtimeve janë me të njëjtin ritëm, (si per këso lloj punësh), në vendet më të zhvilluara europiane.

Ndersa studiuesi i famshëm Gaetano Petrotta, i jep mundësinë e madhe shqiptarëve, nëpërmjet arkivit të tij, për të patur një panorama më të gjërë mbi zhvillimet dhe dinamiken e gjuhës shqipe nëpër shekuj. Ndaj për nder të tij, për veprën "Populli, gjuha dhe letërsia shqipe" (që ka 90 vjetorin e botimit), solla për lexuesin këtë shkrim përmbledhës rreth gjuhës dhe fjalorëve.

*Pyetësori "Librat e jetës sime"*

# ERMIR NIKA

## Libri që pati ndikimin më të madh në shkrimet e mia

## Romani "Një hero i kohës sonë", i M. Lermontovit

**Libri që po lexoj ndërkohë**

Aktualisht i jam rikthyer një periudhe të adoleshencës dhe të kohës kur isha student, duke iu përkushtuar veprës së një prej figurave më të spikatur dhe mbizotërues të artit dhe kulturës amerikane të viteve 60-70, të shekullit të kaluar dhe ky është Andy Warhol. Vepra që kam në duar momentalisht është një përmbledhje me vargje dhe aforizma të shkruara prej tij dhe që titullohet "Gjëja më e bukur e Firences është McDonald's".

**Libri që më ka ndryshuar jetën**

Nuk mund të jetë vetëm një libër por edhe një libër mund të na josh drejt ndryshimit të madh, në të gjitha këndet dhe mënyrat perceptimit dhe mendësisë dhe pa hezitim mund të them që libri që shënon një ndryshim në jetën time ka qenë dhe mbetet "Frymë të vdekura", vepër e një prej autorëve më të mëdhenj të të gjitha kohërave Nikolaj Gogoli.

**Libri që do të doja të kisha shkruar**

Në këtë etapë ku gjendem tashmë, kur kam lexuar një pjesë të konsiderueshme të letërsisë evropiane, asaj amerikane, amerikano – latine etj, mund të them që kërshëria dhe intuita me drejton drejt letërsisë kineze dhe pa kurrfarë hezitimi mund të përzgjedh romanin "Ëndrra në pallatin e kuq", si një prej veprave që ka luajtur një rol epokal në letërsinë klasike të këtij vendi.

**Libri që pati ndikimin më të madh në shkrimet e mia**

"Një hero i kohës sonë", një ndër librat më brilantë të letërsisë ruse të të gjitha kohërave, me autor shkrimtarin universal Mihail Lermontov.

**Libri që më ndryshoi mendjen**

Nuk mëndyshem aspak të pohoj se libri që më ka ndryshuar mendjen dhe konceptet mbi mënyrën e të shkruarit është "Pallati i Ëndrrave" e autorit më të lartë të letërsisë shqipe, Ismail Kadare.

**Libri i fundit që më bëri të qaj**

Për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje më duhet të bëj jo pak hapa prapa, në kohën kur isha disi me sentimental dhe padyshim i jepesha romaneve dhe filmave ku merrja një dozë më të lartë emotive dhe këtu mund të përmend librin dhe me pas edhe filmin "Histori dashurie" e autorit të mirënjohur amerikan Eric Segal.

**Libri i fundit që më bëri të qesh**

Nëse më duhet të përzgjedh në shportën e librave që më kanë bërë jo pak të qesh, pse jo, i qëndroj diptikut "Tregime nga njëri xhep" – " Tregime nga xhepi tjetër" të autorit të shquar çek Karel Çapek.

**Libri që më vjen turp që s'e kam lexuar ende**

Ia drejtoj herë pas herë një vetes një pyetje të tillë dhe jo rrallë herë ndalem tek romani "Mbi heronjtë dhe varrezat" të Ernesto Sabatos.

**Librat që kam dhuruar**

Janë të shumtë por mund të përmend Kokoro të Natsume Sosekit, veprat e Dostojevskit, të Ismail Kadaresë, Fatos Kongolit dhe të Gabriel Garsia Markesit.

**Libri me të cilin dua të mbahem mend**

Pyetja nuk është aspak e lehtë për një krijues por në fazën aktuale mund të veçoj përmbledhjen me poezi "Kuarteti bohem".

**Libri që më bën të ndihem mirë**

Nëse do t'i përmbahem krijimtarisë sime do të ndalesha tek romani im "Robi i lartësive", ndërsa nëse do të hidhja vështrimin përtej vetës, do të përqendrohesha pikërisht tek romani "Ulku dhe Uilli", vepër e shkrimtarit tonë të shquar Vath Koreshi.

**Libri që mendoj se është më i nënvlerësuar**

Mungesa e theksuar e kritikës shpesh herë na bën të mendojmë se ka ende vepra apo procese letrare që përshkohen nga indiferentizmi dhe këtë fat e kanë shumë shkrimtarë dhe vepra dinjitoze të tyre. Në përvojën time mund të them se e kam ndierë më së shumti brenda vendit me vëllimin poetik "Kuarteti bohem", libër i cili jashtë vendit ka pasur një vlerësim jo të pakët dhe disa nga poezitë e tij janë përfshirë në disa antologji ndërkombëtare. Ndërsa sa i përket letërsisë shqipe, mund të them se deri me tani shoh ende një nënvlerësim dhe mosnjohje sa duhet sa i përket veprës letrare të Mihal Hanxharit.

# GJETHE TETORI

## poezi nga Nurie Emrullai

### GJETHE TETORI

Bie shi fjalësh brenda kafkës sime ndërtuar nga letra.
Letër nga thesi i miellit,
ku piqej buka për pangopësinë tonë ndaj jetës.
Dy këmbë ecin mureve të mia
dhe shkelin çdo fjalë të shkruar me shkronja të medha,
si: TI, DASHURIA, KOHA, dhe përsëri TI.
Gjethe të tërë vjeshte-
(bien në vjershat e mia)
-bien syve të mi,
jo për t'i lënduar,
po për të parë se vjeshta, si vdekja, është këtu.
Çdo vdekje është jetë e re.
Tinguj të çuditshëm,
lëvizin një dorë e cila nuk mund të jetë e imja,
nga duart e panjohura që ka shtrënguar.
E di?
Më vjen të bërtas kur kuptoj se kjo është një rrugë pa krye.
Zëri im vjen nga një tokë e largët.
Vjeshtë e pakohë...
Pemë pa gjethe...
Qiell pa rrathë...
Unë pa ty...
Dhe unë që vrapoj të gjejë fjalët e mia...
Poezia, poeti, fjalët, kuptimet e tyre, jeta, e verdha si xhelozia, meite si dita e fundit me ty (pa ty).
S'duhet besuar në atë që shikoj.
Por të besuarit! E di?
Më mësuan të besoj,
kur isha aq e vogël,
aq e pafajshme si një qen.
Duhet ta ushqej veten me fjalë.
Jam e uritur për dashuri.
Një qen pranë meje leh...

### KUSH JETON NË PARAJSË?

Parajsa thua është burg i bardhë,
dhe engjujt janë robërit e saj,
që Ricos i çon çdo javë në qethtore.
Kush do ta di se ç'radhë të tjerë
janë veç parajsës?
Ti qesh dhe me gojën tënde si ré
fryn lehtë një pendë nga krahu im...
Dhe lëmë takim për javën tjetër.



# "BRITMA", MONA LIZA E ARTIT MODERN

Dr. Bledar Kurti

*Po ecja përgjatë rrugës me dy shokë - dielli po perëndonte - papritmas qielli u kthye në një të kuqe gjaku - ndalova, u ndjeva i lodhur dhe u mbështeta në një gardh - kishte gjak dhe gjuhë të zjarrta mbi gjirin e detit ngjyrë blu e të zezë dhe mbi qytetin - miqtë e mi vazhduan të ecnin, ndërsa unë qëndrova duke u dridhur prej ankthit - dhe ndjeva një britmë të pafund që depërtonte përmes natyrës.*

Edvard Munch

Vepra *Britma* (1893) e artistit norvegjez Edvard Munch (1863-1944) konsiderohet si *Mona Liza* e artit modern. Kjo vepër tashmë është shndërruar në një ikonë dhe ka frymëzuar krijimtarinë e artistëve të dekadave të fundit, por mbi të gjitha ajo ka shërbyer si një pasqyrë e ankthit, frikës dhe traumës së brendshme të njeriut, të shpalosura përmes një fytyre të re të artit, e cila porsi një britmë çlirohet nga kthinat e brendshme të shpirtit dhe thërret për t'u dëgjuar nga epokat.

Një artist mund të jetë viktimë e suksesit të tij. Ndodh që ai bëhet i njohur për një punë të vetme jo për përmbledhjen e të gjithë veprave të tij. Kështu ka ndodhur edhe me Edvard Munch. Një artist novator e mjeshtëror ai njihet kryesisht falë kësaj vepre, edhe pse e gjithë krijimtaria e tij është mahnitëse.

*Britma* është një vepër e jashtëzakonshme. Ajo nuk komunikon me sytë tanë, por me ato ndjenja të cilat ne i ndrydhim brenda vetes, i kyçim me vargonjtë e harresës, i lutemi të mos kthehen, dhe urojmë të mos manifestohen sërish në jetën tonë. Gjithsecili prej nesh e ka përjetuar dhimbjen, dhe e dimë fare mirë se ajo le gjurmë më të rënda sesa lumturia, ndaj edhe e frenojmë, e ndrydhim dhe e burgosim atë, por me raste zaptohemi nga një dëshirë e menjëhershme për të ulëritur, për të lëshuar një piskatë therëse që të dëgjohet në mbarë globin. Në një interpretim më të gjerë kjo vepër është një *momento mori*, një kujtesë për vdekshmërinë tonë, për gjendjen e rënë ku gjendet njeriu, për dhimbjen që ka gjithsecili brenda vetes, për hendekun e pakapërcyeshëm që njerëzimi ka drejt çlirimit të vetes dhe shpirtit.

Vdekshmëria jonë lind bashkë me ne: nëna që sjell një foshnje në jetë, pasi buza i lodhet prej lumturisë, nis e mendon se fëmija që po mban në duar një ditë do të vdesë, dhe ajo kupton se ajo ditë gëzimi është edhe një ditë morti, një jetë lindi për t'iu dorëzuar vdekjes. Dhe ajo ka frikë e ndien dëshpërim. Dhe zgjedh që këtë tmerr emocional e mendor ta fshehë thellë brenda vetes duke shpresuar që të mos zgjohet më kurrë. Dhe fëmija rritet dhe i do prindërit e vet porsi jetën, dhe një ditë kupton se ata do të vdesin, madje edhe vetë ai apo ajo do të vdesë, dhe një britmë e brendshme nis e zgjohet e dëshiron të shpërthejë me përmasa kataklizmike.

Ndaj edhe figura në qendër të veprës po lëshon një britmë të thertë. Me fytyrën e varur e me duart tek veshët transmeton ndjesinë e një buçime të brendshme por edhe të jashtme. Britma vjen nga brenda por edhe nga vetë natyra. Një botë porsi një britmë.

Një *momento mori* i të gjithë universit.

Titulli origjinal që Munch i vuri veprës ishte *Der Schrei der Natur* (Britma e Natyrës), dhe kjo për faktin se artisti e shihte jo vetëm njeriun si qenie fiziologjike por edhe vetë natyrën si një qenie që pulsonte dhe që kishte zë, sikurse edhe njeriu. Për Munch natyra merrte frymë, ndaj ajo mund të kishte edhe zë, pasi zëri ishte gjithashtu një funksion i procesit të frymëmarrjes. Dhe ky zë i natyrës dëgjohet shumë tek vepra *Britma*.

Jo vetëm figura por edhe peizazhi krijohet nga linjat e lakuara, të cilat ngjajnë me valët e zërit. Madhësia e tyre i referohet edhe zhurmës ose intensitetit të zërit. Për më tepër, figura qendrore mbulon veshët, duke theksuar realitetin fiziologjik të zhurmës ose mosmarrëveshjes së tingujve të prodhuar nga trazirat e fuqishme në ajër. Për më tepër, figura hermafrodite, dygjinore, që ulëret, i mundëson Munch që të shmangë caktimin e ndonjë diferencimi të zërit mashkullor me atë femëror në figurë në mënyrë që britmat t'i përkasin natyrës. Artisti mund të projektojë procesin fiziologjik të frymëmarrjes në peizazhin si një mjet për të frymëzuar atë dhe për të simbolizuar gjendjen e tij të brendshme e të pikëlluar mendore. Përmes linjave të forta Munch gjithashtu lejoi gjakun të kalonte nëpër venat dhe damarët e peizazhit. Këtu, gjaku duket sikur qarkullon përmes natyrës. Në këtë vepër Munch shpalosi shqetësimet e tij të brendshme të cilat i lidh me impulset e natyrës. Artisti në mënyrë efektive pranon gjendjen e paekuilibruar të trupit të tij: ai është i sëmurë dhe i lodhur. Mjedisi i brendshëm i figurës është jashtë ekuilibrit, aq shumë i çekuilibruar sa që duhet të rrjedhë gjak edhe në mjedisin e jashtëm. Linjat e dallgëzuara ngjyrë të kuqe dhe blu dhe format në sfondin e pikturës, bëhen ilustrime vizuale të qarkullimit të gjakut.

Tek vepra *Britma* shpaloset për të gjithë shikuesit zbulesa e marrëdhënieve të munduara, si edhe histeria e dhimbjes e transmetuar qartë në tablo. Kjo vepër transmeton një mesazh të qartë, dhe ajo është shumë autobiografike. Figura është vetë artisti, por edhe shikuesi, qoftë i gjinisë mashkullore apo femërore, dhe qielli është mbi Oslon por mund të jetë edhe mbi çdo kënd gjeografik të botës.

Kjo është një tablo universale por e nxitur nga një shtysë autobiografike. Munch dëshironte që arti që ai krijonte të ishte hija e tij, një ditar rrëfimesh dinamike dhe të papërfunduara. Veprat e tij janë të udhëhequra nga vetë jeta e tij. E ëma i vdiq nga tuberkulozi kur ai ishte vetëm pesë vjeç. Motra e tij e preferuar, Johanne Sophie, vdiq (gjithashtu nga tuberkulozi) ndërsa motra e tij më e vogël, Laura, e kaloi pjesën më të madhe të jetës së saj në një spital psikiatrik. Vetë Munch ishte vazhdimisht i sëmurë dhe për shumë dimra nuk shkoi në shkollë pasi ishte i bindur se e gjithë familja e tij ishte e mallkuar me një çmenduri gjenetike të trashëguar. "Babai im ishte njeri nervoz dhe fanatik - deri në pikën e psikonerozës," shkroi Munch. "Nga ai kam trashëguar farën e çmendurisë. Engjëjt e frikës, pikëllimit dhe vdekjes kanë qëndruar pranë meje që nga dita që kam lindur." Nuk është e nevojshme të jesh psikiatër për të kuptuar pse vepra e Munch, edhe pse madhështore, ka një dëshpërim dhe zemërim më të rëndë se sa peizazhet me diell dhe natyrat e qeta me lule që pikturonin artistët e tjerë bashkëkohorë.

I nxitur nga engjëjt e tij të frikës, përgjigja e Munch ndaj rrethanave të trishta që kishte hasur ishte "të shkruante jetën e tij" dhe të pikturonte çdo gjë në mënyrë obsesive dhe me katarsisin fizik dhe psikologjik që kishte përjetuar. Kështu që çdo sëmundje, vdekje, zemërim, traumë, shishe me barna mjekësore, stetoskopë dhe vdekje që ai përjetoi gjatë 80 viteve të jetës së tij u rikrijuan në këtë vepër por edhe tek i gjithë repertori i tij. Dhe çdo joshje, xhelozi dhe dashuri, u regjistrua deri në çdo detaj.

Vepra *Britma* i përket një serie veprash nën titullin *Larmia e Jetës – Një Poemë Mbi Jetën, Dashurinë dhe Vdekjen*. Tematikat e këtyre veprave kishin të bënin me ankthin, dëshpërimin, britmën dhe vdekjen. *Britma* ka katër versione të krijuara nga Munch, të krijuara me bojë vaji, tempera, pastel dhe litografi. Mënyra e kompozimit është tejet simbolike dhe ekspresioniste. Por pavarësisht shfytyrimit të skenës kuptojmë se këndi i vështrimit është i rregullt dhe ka logjikë lineare. Ai nis me shikuesin në këndin e poshtëm në të djathtë të tablosë, haset me figurën në qendër, vijon me urën dhe me dy burrat, miqtë e artistit, kthehet djathtas përmes linjës së horizontit dallgëzues e zbret sërish tek pika e nisjes përmes bregut gjarpërues të liqenit. Varkat e vogla në sfond shërbejnë për të treguar perspektivën dhe thellësinë e skenës, dhe për shkak të linjave të çrregullta vertikale dhe horizontale e gjitha vepra pulson, merr frymë dhe transmeton një zë që përshkon figurën, natyrën dhe shikuesin.

Skena që ka pikturuar Munch, të cilën e përshkroi me fjalë gjatë një ecje me dy miqtë e tij është në Gjirin Kristiania në rrugën Valhallveien të kodrës Ekeberg në Oslo. "Dielli po perëndonte- papritmas qielli u kthye në një të kuqe gjaku" shkroi Munch. Ky shënim, shoqëruar edhe nga linjat e forta të kuqe e portokalli të qiellit në tablo kanë shtyrë shumë studiues të ngrenë tezën se qielli i kuq ishte real për shkak të shpërthimit të vullkanit të Krakatoas në Indonezi në vitin 1883, i cili ishte ndër shpërthimet më shkatërrimtare të historisë, duke shkaktuar vdekjen e mbi 36,000 njerëzve dhe pati një ndikim në mbarë botën duke skuqur qiellin e mbarë globit, ndaj, mendohet se Munch mund ta ketë ruajtur

në kujtesë atë fenomen të pazakontë, ose për shkak të atij shpërthimi, edhe pas një dekade, perëndimi i diellit dukej ende më i përflakur se zakonisht. Ky është një element tejet trillues që mund t'i shtohet interpretimit të veprës, por Munch ishte më shumë se sa thjesht një artist i cili shtyhej nga vrojtimi i përgjithshëm, ai kishte një qasje shpirtërore, psikologjike, fiziologjike dhe shkencore ndaj artit të tij, ndaj *Britma* nuk ka të bëjë me një shpërthim vullkanik të tokës, por me shpërthimin e brendshëm të njeriut, e madje të gjithë natyrës bashkë me të.

Vepra e Munch është një qark shpërthyes shpirtëror por edhe një vrojtim shkencor. Ai i referohet qarkut fiziologjik të qarkullimit, frymëmarrjes, sistemit nervor, trurit, riprodhimit, ushqimit dhe vdekjes. Në pikturat e tij, Munch i zbatoi këto procese vitale të trupit të njeriut në mënyra të ndryshme metaforike dhe në mënyra që do ta ndihmonin të përballej me materializmin e shekullit të 19-të. Në referimet e tij mbi fiziologjinë e sistemit nervor, ai trajtoi bindjen bashkëkohore se "arti ishte produkt i çrregullimit nervor dhe ndjeshmërisë së theksuar, dhe se krijimi artistik funksiononte si çlirim nervor."

Shkenca, filozofia, psikologjia dhe arti ishin një përzierje e përhapur në shekullin e 19-të për shkak të librave të shumtë të botuar e të shpërndarë gjerësisht, duke e bërë shkencën të disponohej në duart e lexuesve të shumtë. Munch ishte vazhdimisht i rrethuar nga njerëz të fushës mjekësore dhe letrare, ndaj edhe veprat e tij përmbajnë një ndërthurje të artit, psikologjisë, mjekësisë dhe biologjisë. Në një rast, një kritik reagoi i tmerruar nga veprat e Munch, duke e konsideruar atë si një piktor që i përkiste më shumë një auditori të një shkolle mjekësie sesa një muzeu arti.

Dhe vërtetë Munch e trajton figurën njerëzore dhe peizazhin porsi një organizëm i gjallë i shpalosur në kanavacë të ngjashme me një laborator biologjik e mjekësor. Por ky trajtim nuk ishte vetëm artistik ai ishte shumë jetik për të.

Për shembull, gjatë një qëndrimi në Monte Karlo, Munch-in e zunë ethet. Ai e përshkroi atë përjetim në terma shumë fiziologjik, porsi një pickim dhimbjeje në gjoks dhe se i dukej se po thithte ajrin që po e mbyste. Ai shpjegoi se parfumet dhe aromat i shkaktonin marramendje, dhe ai i krahasoi dëshirat e tij të lojërave të fatit me një sëmundje ngjitëse, duke pretenduar se vinte për shkak të mikrobeve në sallat e Monte Karlos. Tryeza e lojërave të fatit i dukej si një kafshë e çuditshme dhe e paqëndrueshme ... me roletën si qendrën e saj nervore. Në ditarët e tij të kësaj periudhe, pasi shëndeti i tij u përmirësua, ai e përshkroi këtë episod sikur termometri i tij të ishte ngjitur nga ferri e lart për në qiellin blu. Një situatë e rëndomtë si kjo, përshkruhej në ditarin e tij me terma biologjik, psikologjik, simbolik e shpirtëror, ndaj mund të kuptojmë përse arti dhe tablotë e tij, ku liria e shprehjes është më e madhe, përmbajnë përjetime më të thella.

Ndaj tek *Britma* jo vetëm figura por edhe peizazhi merr frymë. Toka ashtu edhe uji pulsojnë. Munch e krahasonte detin me një qenie të gjallë që merrte frymë, një qenie me një gjoks të pafund që ngrihet dhe ulet vetiu. Ai mund të ndiente frymën e detit dhe psherëtimat e gjata të nëntokës, dhe i përshkroi retë si frymëmarrje të botës ndërsa stuhitë si frymëmarrjen e saj të fuqishme. Me shumë gjasa, njeriu dhe natyra si organizma të gjallë duhet ta kenë marrë nxitjen përmes teksteve të biologjisë, fiziologjisë dhe ilustrimeve të tyre që i përkisnin babait dhe vëllait të Munch, të cilët ishin të dy mjekë. Fiziologjia është dega e biologjisë që merret me funksionet e proceseve vitale të organizmave të gjallë ose pjesëve dhe organeve të tyre. Këto procese përfshijnë funksione të tilla si riprodhimi, rritja, qarkullimi, frymëmarrja dhe metabolizmi, dhe kryhen brenda qelizave, indeve dhe organeve të trupit. Studimi i fiziologjisë ishte, gjithashtu, i lidhur ngushtë me studimin e mjekësisë së përgjithshme, anatomisë, patologjisë, neurologjisë dhe psikologjisë. Studimi i funksioneve trupore nisi që nga grekët e lashtë dhe u rikthye në shekullin e gjashtëmbëdhjetë gjatë të cilit u përdor edhe Leonardo da Vinci, me përparime të izoluara në kuptimin e këtyre funksioneve që vazhdonin deri në shekullin e tetëmbëdhjetë. Por, në prag të shekullit të 20-të Munch e manifestoi në një mënyrë ndryshe, në përshtatje me epokën moderne, me një britmë më të madhe e cila kishte mbetur e ndrydhur brenda njerëzimit për mijëra vjet.

Munch u ndikua shumë në formimin dhe botëkuptimin e tij artistik dhe njerëzor edhe nga veprat letrare dhe filozofike, kryesisht nga Emile Zola, Gustave Flaubert, Friedrich Nietzsche, dhe Dostoevsky, të gjithë autorë e mendimtarë rebelë dhe novatorë. Në veçanti Fyodor Dostoevsky pati një ndikim të madh tek artisti. Një herë Munch i shprehu një miku se askush në art nuk kishte udhëtuar aq thellë "në sferat mistike të shpirtit» sa Dostoevsky. Ndërkohë në pikturë, Vincent van Gogh dhe Paul Gauguin e frymëzuan Munch të përdorte ngjyra të forta, forma të thjeshtuara dhe linja dinamike, të gjitha të ndërthurura tek vepra *Britma*.

Arti i Munch, ashtu si me çdo artist, duhet analizuar në kontekstin shoqëror e historik. Kontradiktat politike, shoqërore dhe morale, të cilat pushtuan të gjithë botën perëndimore në shekullin e 19-të, prekën edhe Skandinavinë, ku u manifestuan dhunshëm në sferën e çështjeve morale dhe sociale. Në Norvegji, kontradiktat ishin më të forta sesa kudo. Në debatet norvegjeze, zërat më të fuqishëm ishin ato të dy figurave të mëdha letrare të gjysmës së dytë të shekullit, Henrik Ibsen dhe Bjørnstjerne Bjørnson, i pari kryesisht në çështjet etike dhe sociale dhe i fundit në sferën e politikës liberale dhe nacionalizmit në rritje; dhe miqtë e Munch në fund të shekullit morën pozita edhe më radikale sesa këta dy veteranë. Ekstremizmi i individualizmit, anarkizmit, me idetë e tij për domosdoshmërinë e heqjes së kufizimeve të shoqërisë dhe shtetit dhe këmbënguljen e saj për liri të plotë për individin, krijoi tonin filozofik të rrethit artistik të cilit i përkiste Munch.

Parë në këtë kontekst *Britma* shpaloset si një pasqyrë e denjë e dinamikës intelektuale të kohës. Konfliktin e mendimit ajo e përfaqëson me anë të ngjyrave: të ngrohtat si e kuqja dhe portokallia vihen përbri të ftohtave si jeshilja dhe vjollca, duket krijuar një kontrast të madh artistik dhe racional.

Fundi i shekullit të 19-të ishte edhe periudha e lavdishme e neurologut dhe psikoanalistit austriak Sigmund Freud, i cili kishte nisur të zbatonte hipnozën në praktikat e tij klinike, kishte themeluar teorinë e ndrydhjes dhe nevrozës si çrregullime personale dhe sociale, e më vonë do themelonte psikoanalizën. Kësisoj, një shtysë e madhe për Munch në krijimin e veprës *Britma* ishin edhe kujtimet e fëmijërisë, për të cilat artisti shkroi shumë komente në ditarët e tij. Edvard Munch vinte nga një familje e vjetër norvegjeze shumë e dalluar. Gjyshi dhe stërgjyshi i tij kishin qenë njerëz me rëndësi të madhe kishtare. Vëllai i madh i babait të tij, Peter Andreas Munch, ishte historiani i madh i Norvegjisë i shekullit të nëntëmbëdhjetë. Munch ishte krenar për prejardhjen e tij. Por, kujtimet me të atin ishin të hidhura dhe e kishin lënduar gjatë, duke i shkaktuar dëme të mëdha emocionale dhe psikologjike gjatë të gjithë jetës. Munch u shpreh kështu për kujtimet e tij të fëmijërisë:

*Babai kishte një karakter të vështirë, nervozizëm të trashëguar me periudhat e ankthit fanatik që mund të arrinin kufijtë e çmendurisë ... Kur nuk pushtohej nga ankthi ai sillej si një fëmijë i lumtur dhe bënte shaka e luante me ne. . . Kur na dënonte. . . ai tregohej i çmendur me dhunën e tij. . . Sëmundja dhe marrëzia ishin engjëjt e zinj që bënin roje mbi djepin tim. . . Në fëmijërinë time ndieja gjithmonë se trajtohesha në mënyrë të padrejtë, pa nënë, i sëmurë dhe me kërcënimin e të dënimit të ferrit mbi kokën time.*

Kur lexojmë këtë koment arrijmë ta dëgjojmë edhe më fortë zërin dhe jehonën e thertë të britmës së figurës në tablo, e tundohemi të zgjojmë kujtimet tona të hidhura të fëmijërisë, adoleshencës apo rrugëtimit gjatë maturisë. Me një baba fanatik deri në skaj të çmendurisë, me nënën dhe motrën e vdekur, me një motër tjetër të shtruar në psikiatri, e vetë me një shëndet të dobët, britma e Munch nuk kishte se si të ishte e heshtur, por e fortë dhe e përzier me vetë natyrën dhe universin. Ndaj, artisti guxoi të kapërcente egon e tij duke mos dashur të kufizohej vetëm nga historia e tij personale, por të krijonte një britmë për të gjithë njerëzimin. Një britmë që të dëgjohej ende edhe sot. Dhe, ai ja doli më së miri.

Kjo britmë nuk është e bukur por e sinqertë. Ekspresionistët refuzonin të ishin hipokritë. Ata donin të hetonin të vërtetat lakuriqe të ekzistencës dhe të shprehnin dhembshurinë për njerëzit e mjerë e të pafatë. Ata refuzonin të zbulonin fytyrën e bukur të artit, ata ishin në kërkim të fytyrës së sinqertë të artit, asaj që e njeh skllavërinë shpirtërore të njeriut, e që më pas e manifeston atë si një thirrje.

Munch u shpreh se "Arti është kristalizim." Dhe pikturat e tij duken kristalizime të ideve të tij për fatin e njeriut nën forcat e jetës dhe vdekjes. Pavarësisht se *Britma* mund të na duket një tablo e shfytyruar, ajo është tejet e kristalizuar. Ajo është simboli i njeriut të ndrydhur e të zënë në çarkun e vdekshmërisë, në çarkun e përsëritjes, të cilin Nietzsche e quajti *Kthimi i Përjetshëm*, koncepti i cili e çoi atë deri në çmenduri. Ajo reflekton gjendjen e njeriut nën traumat e jetës dhe forcën e vdekjes, duke thirrur e ulëritur me një zë kataklizmik që dëgjohet përtej epokave, në kërkim të shpëtimit dhe çlirimit, të qenies njerëzore por edhe vetë artit.



# MEDITIME MBI KRIJIMTARINË LETRARE

## Henry Miller

*Përktheu Nikolla Sudar*

Një herë, duke iu përgjigjur një ankete, Knut Hamsuni vuri në dukje se shkruante kryesisht me synimin për të vrarë kohën. Mendoj se, sidoqoftë, ai arsyetonte gabim, madje edhe sikur të fliste sinqerisht. Krijimtaria letrare, ashtu si edhe e gjithë jeta, është një rrugëtim me synimin për të arritur diçka. Ajo është një aventurë metafizike: mënyra e tërthortë e njohjes së realitetit, që të lejon të krijosh një pikëpamje të plotë dhe jo të pjesshme mbi gjithësinë. Shkrimtari ekziston midis shtresës së sipërme të jetës dhe asaj të poshtme; ecën nëpër shtegun që i lidh të dyja, me synimin që në përfundim vetë ai të shndërrohet në këtë shteg.

Unë e kam filluar atë në një gjendje hutimi dhe pasigurie absolute, pasi isha zhytur në kënetën e ideve të ndryshme, të përjetimeve dhe të vëzhgimeve nga jeta. Madje edhe sot, si edhe më parë, nuk e konsideroj veten shkrimtar në kuptimin e mirëfilltë të fjalës. Unë jam thjesht një njeri që rrëfen historinë e jetës së vet dhe, sa më shumë që zgjatet ky rrëfim, aq më tepër e ndiej atë të pashtershëm. Ai është i pafund, ashtu si edhe vetë evolucioni i botës. Në vetvete paraqet nxjerrjen në pah të çdo gjëje të çmuar, paraqet një udhëtim në vendet që nuk i merr dot me mend, derisa në njëfarë pike papritur fillon të kuptosh se ngjarja e rrëfyer është fare pak e rëndësishme në lidhje me vetë rrëfimin. Ja, kjo është veti e pandarë nga arti, që i transmeton atij nuancën metafizike, për faktin se ajo është ngjitur mbi botën, mbi hapësirën; ajo ndërthuret me ritmin tërësor të kozmosit e ndoshta vetëm prej tij mund të përcaktohet. Kurse "aftësia kuruese" e artit pikërisht aty edhe konsiston: në rëndësinë e tij, në mungesën e qëllimit dhe të përfundimit të tij.

Pothuajse qysh në hapat e mi të parë e dija mirë se nuk ekzistonte asnjë lloj synimi. Aq më pak pretendoja pushtimin e të tërës; unë synoja vetëm që ndjesinë time të plotë ta shprehja në çdo fragment, në çdo libër që lindte si kujtim i bredhjeve të mia, ndërsa depërtoja gjithnjë e më thellë në jetë: edhe në të kaluarën, edhe në të ardhmen. Dhe kur ashtu vepron ditë pas dite, gjithnjë e më thellë shfaqet bindja, e cila është shumë më esenciale se besimi apo dogma. Unë po bëhem gjithnjë e më indiferent ndaj fatit tim si shkrimtar, por gjithnjë e më i vendosur në misionin tim njerëzor.

Në fillim studiova me zell stilistikën dhe metodat e atyre që lexoja, prej të cilëve mahnitesha, si Niçe, Dostojevski, Hamsun, madje edhe nga Tomas Mani, të cilin tashmë thjesht e konsideroj një zanatçi të besueshëm, një gurgdhendës me përvojë në zanatin e vet; një kalë ngarkese, ndoshta edhe një gomar, që tërheq karrocën me një zell të papërmbajtur. Unë kam imituar metodat nga më të ndryshmet, me shpresë që të gjeja çelësin që do të më zbulonte misterin se si të shkruaja. Dhe kjo përfundoi duke më çuar në udhëkryq, pasi kisha përjetuar disfatën dhe dëshpërimin, të cilët kanë pasur rastin t'i provojnë jo shumë të tjerë. Thelbin e gjithë kësaj e përbënte fakti se unë nuk isha në gjendje të veçoja në veten time njeriun nga shkrimtari. Kështu që dështimi në krijimtari për mua do të thoshte dështim në fat; gjë që edhe e provova. Unë e kuptova se përfaqësoja një hiç, akoma më keq, një madhësi negative.

Dhe ja, pasi arrita në këtë pikë, duke u ndjerë sikur ndodhesha midis detit të vdekur të Sargasovit, fillova të shkruaja për së mbari. E fillova nga zeroja, duke i flakur tutje gjithçka kisha grumbulluar, madje edhe ato që i ruaja në mënyrë të veçantë. Sapo dëgjova zërin tim, m'u shfaq entuziazmi: më mahniste fakti se ky zë ishte i veçantë, i pangjashëm me asnjë tjetër, një zë unikal. Mua aq më bënte se si do të vlerësoheshin ato që shkrova. "Mirë", "keq", këto fjalë i çrrënjosa nga fjalori im. Në mënyrë të pandashme u futa në fushën e krijimtarisë, në mbretërinë e artit, i cili nuk ka asgjë të përbashkët me moralin, etikën, utilitarizmin. Vetë jeta ime u shndërrua në një krijimtari artistike. Unë e fitova zërin pasi u bëra përsëri një qenie e plotë. Vetë përjetova përafërsisht atë që, nëse u besohet librave, përjetohet pas iniciativës personale, kur përfshihesh te xhen-budizmi.

Për këtë qëllim m'u desh të ushqehesha me urrejtjen ndaj diturisë, m'u desh të kuptoja kotësinë e çdo gjëje, të rrënoja gjithçka, të evidentoja mungesën e shpresës dhe pastaj të qetësohesha apo, si të thuash, t'i vija vetes diagnozën vdekjeprurëse dhe vetëm atëherë i ktheva vetes ndjesinë e individualitetit personal. M'u desh t'i afrohesha plotësisht fundit dhe të hidhesha drejt errësirës.

Unë përmenda realitetin, por tashmë e di se është e pamundur t'i afrohesh atij, në një mënyrë tjetër nga krijimtaria letrare. Tashmë njoh më pak dhe kuptoj më shumë, por në saje të një mënyre të veçantë e të jashtëligjshme. Gjithnjë e më me besim po arrij ta zotëroj atë, në saje të dhuntisë së natyrshme. Tek unë po zhvillohej aftësia për të arritur, për të kapur, analizuar, bashkuar, për të emërtuar, për t'i sqaruar faktet, për t'i shprehur, madje të gjitha përnjëherë. Ajo që përbën strukturën e gjërave tashmë zbulohet më lehtë nga syri im. Instinktivisht u shmangem të gjitha arsyetimeve të qarta: sa më të thjeshta të jenë ato, aq më i thellë është misteri i vërtetë. Ndërsa ajo që unë di bëhet gjithnjë e më e pashpjegueshme. Mua më vë në lëvizje bindja, e cila nuk ka nevojë për dëshmi, njëlloj si feja. Unë jetoj vetëm për veten time, por pa kurrfarë ambicieje apo egoizmi dhe përpiqem që të përjetoj vetëm atë që më lejohet dhe kështu ndihmoj ekuilibrin e gjërave në botë. Ndihmoj lëvizjen, lindjen, vdekjen, transformimin që ndodhin në kozmos dhe e bëj këtë me të gjitha mjetet, nga dita në ditë. Unë jap gjithçka që kam; i jap me qejf, por edhe marr çdo gjë që jam në gjendje të mbaj. Unë jam edhe mbret, edhe pirat; jam simbol i barazisë, personifikim i Peshores, që u bë shenjë e pavarur, kur Virgjëresha u nda nga Akrepi.

Sipas pikëpamjes sime, në botë ka vend më se të mjaftueshëm për cilindo. Dikush jeton në atë mjedisin e vet, pa e vrarë mendjen për asgjë, kurse gjeniu, individiumi, është i vetmi në gjithë gjithësinë që e ndërton personalitetin ndryshe nga të tjerët. Çdo njeri e organizon jetën e vet siç i pëlqen. Njerëzit e përsosin personalitetin e tyre ashtu siç e shohin të arsyeshme.

Nga ana e jashtme, kur vihen në dukje vetëm betejat historike dhe gjithçka në botë u nënshtrohet përleshjeve për hir të pasurisë dhe pushtetit, jeta u ngjason turmave që bredhin sa andej-këndej. Mirëpo, në të vërtetë, ajo fillon vetëm pasi je zhytur thellë, duke iu larguar sipërfaqes, kur refuzon luftën dhe zhdukesh nga fushëpamja e të tjerëve. Mua asgjë nuk më detyron të shkruaj ose jo; unë nuk i njoh më detyrimet dhe tashmë nuk gjej në krijimtarinë time letrare diçka që të lehtësojë vuajtjen. Gjithçka që kam shkruar, është arritur kryesisht për hir të kenaqësisë; frutat bien vetë mbi dhe, pasi janë pjekur tek unë, tamam si në një pemë. Për mua nuk ka rëndësi se si do t'i gjykojnë ato kritikët apo lexuesit e zakonshëm. Unë nuk po përcaktoj asnjë lloj vlere, por thjesht nxjerr në pah frutin e pjekur, që ai të bëhet ushqim. Dhe në krijimtarinë time letrare nuk ka asgjë tjetër.

Situata e një indiferentizmi shumë të përzgjedhur - ja pasoja logjike e jetës egocentrike. Me problemin e ekzistencës në shoqëri unë jam përballur në atë mënyrë, saqë u bëra si i vdekur; problemi i vërtetë nuk qëndron në faktin që të mësohesh të jetosh pranë të tjerëve, po as edhe në përkrahjen për lulëzimin e vendit tënd. Problemi i vërtetë është njohja e destinacionit tënd dhe e kalimit të jetës në harmoni me ritmin e organizuar rreptësisht të kozmosit. Pasi ke arritur në vetvete aftësinë që pa u dridhur të arsyetosh për koncepte të tilla, siç janë kozmosi e shpirti, duke zotëruar artin për të arritur "anën shpirtërore", gjatë kësaj kohe ke shmangur çdo lloj defi-nicioni, argumenti, dëshmie e detyrimi. Parajsa është gjithandej, tek ajo të çon çdo rrugë, nëse do ta ndjekësh atë vetëm po të shkosh drejt saj shumë larg. Por që të ecësh përpara është e mundur vetëm duke u kthyer prapa, pastaj të drejtohesh anash, lart dhe më pas poshtë. Nuk ka asnjë lloj progresi, ekziston vetëm lëvizja dhe zhvendosja e përjetshme, që kryhet pafundësisht në formë rrethoreje apo spiraleje. Çdo njeri ka misionin e vet dhe imperativi ynë i vetëm është që ta ndjekim misionin tonë duke e pranuar atë, kudo që të na drejtojë ai.

As që e kam idenë se çfarë librash do të shkruaj në të ardhmen, madje as sesi do të jetë libri im i ardhshëm. Idetë e mia, planet e mia ndjekin stimulin më pak shpresëdhënës: unë thjesht mbaj shënim diçka në ecje e sipër, përfytyroj, shëmtoj, deformoj, trilloj, shpik në zbrazëti, ekzagjeroj, ngatërrohem, zemërohem dhe të gjitha këto në varësi të gjendjes shpirtërore. U nënshtrohem vetëm instinkteve të mia, intuitës sime. Paraprakisht nuk marr vesh asgjë. Shpesh përshkruaj gjëra që as vetë nuk i kuptoj, duke ditur që në vazhdim ato do të sqarohen dhe do të kenë për mua njëfarë kuptimi. Unë kam besim te njeriu,

i cili shkruan, domethënë te vetja ime, te shkrimtari. Dhe nuk u besoj fjalëve, madje edhe sikur t'i rreshtojë mjeshtri më me përvojë, por i besoj gjuhës, ajo është diçka më e lartë në raport me fjalët, përderisa ato krijojnë vetëm një iluzion të deformuar, që është i tillë. Fjalët nuk jetojnë të ndara, të tilla ato mund të ekzistojnë vetëm për shkencëtarët: për etimologët, filologët etj. Fjalët të ndara nga gjuha shndërrohen në një shtresë të vdekur, prej së cilës nuk zbulon dot të fshehtat. Njeriu zbulohet nëpërmjet stilit të tij, dhe në atë gjuhë, të cilën e ka krijuar për veten e vet. Për atë që është i pastër në shpirt (dhe për këtë jam i bindur), gjithçka në botë e zotëron me një qartësi të tejdukshme, madje edhe sikur të nënkuptosh vetë shkrimet ezoterike. Te një njeri i tillë e fshehta i dallohet hapur dhe në të nuk ka asgjë mistike; ajo është e natyrshme, proporcionale, zotëron logjikën dhe është e pranueshme nga përbërja e vet. Kuptimi nuk përmblidhet në synimin për të zbuluar të fshehtën, por për ta pranuar atë, për t'iu gëzuar jetës dhe për të jetuar me të, duke e shijuar atë dhe duke jetuar falë asaj.

Unë do të kisha dashur që fjalët e mia të lëviznin lirisht, siç lëviz, pa marrë parasysh drejtimin, vetë bota, në rrugëtimin e vet gjithë dredha, duke kaluar gjerësi e gjatësi gjeografike plotësisht të paparashikuara. Duke u gjendur paraprakisht në kushte dhe breza klimatikë, duke u ndeshur me matjet që askush nuk i llogarit. E kam pranuar me kohë paaftësinë time për ta realizuar këtë ideal. Por mua kjo gjë nuk më brengos. Në njëfarë kuptimi më të lartë, vetë bota është e infektuar nga dështimet; ajo paraqet në vetvete shembullin më të mirë të mungesës së përsosmërisë, ajo është vetëdija e dështimit. Kur e kupton këtë gjë, dështimi nuk ndihet më. Krijuesi, me fjalë të tjera, piktori, ngjason me fillimin e botës, me idenë Absolute, të përjetshme, të Vetme dhe një të tërë, e që e shpreh veten me mungesën e përsosmërisë së saj. Ajo është esenca e jetës, dëshmi e pavdekshmërisë së saj, që i afrohet të vërtetës përfundimtare, ku, sipas mendimit tim, përmblidhet qëllimi më i lartë i shkrimtarit, është e mundur vetëm në atë shkallë sa është në gjendje të refuzojë luftën dhe sa është në gjendje të mposhtë vullnetin e vet. Një shkrimtar i madh është personifikim i jetës, domethënë i mungesës së përsosmërisë. Ai e kryen punën e vet pa mundim, duke krijuar përshtypjen se vepra e tij është e paqortueshme dhe se rruga e çon atë nga një qendër e panjohur që ndodhet, tashmë kuptohet, jo midis rrudhave të trurit, por që pa dyshim konsiderohet qendër. Ajo kap ritmin e gjithë gjithësisë, prandaj shfaqet kaq e besueshme, e papërdorur, e paasgjësueshme, po aq e fortë, e pavarur, anarkike, po aq pa synim, si edhe vetë gjithësia. Arti nuk të mëson gjë tjetër përveç konceptimit se sa e rëndësishme është jeta. Një vepër e madhe pashmangësisht nga ana e vet kuptimore duhet të jetë e turbull për të gjithë, përveç një grushti të tillë, që, ashtu si krijuesi i saj, i është bashkëngjitur të fshehtës. Informacioni që ajo përmban, nga rëndësia e vet, është i dorës së dytë, kurse kryesorja është aftësia e përjetësimit të tij. Prandaj është më se e mjaftueshme që për të të gjendet të paktën një lexues i vetëm që ta kuptojë.

Për mua kanë thënë se jam revolucionar, por nëse është kështu kjo ka ndodhur jashtë vullnetit tim. Unë nuk ngrihem kundër botës ekzistuese. Veten time mund ta karakterizoja me fjalët e Blez Sandrarit: "Unë revolucionarizoj". Por kjo nuk është e njëjta gjë me qenien revolucionar. Unë do të mund të jetoja edhe në anën tjetër të murit, që ndan pozitiven me negativen. Në përgjithësi më duket se jam ngritur mbi ndarje të tilla dhe po krijoj njëfarë harmonie të këtyre dy fillimeve, të shprehur në mënyrë plastike, por jo në kategoritë e etikës, të asaj që shkruaj. Mendoj se është e domosdoshme që të qëndrosh jashtë sferës së artit dhe jashtë ndikimit të tij. Arti është vetëm një nga mënyrat e jetës, kurse jeta është më bujare se ai. Dhe në vetvete arti nuk është jetë që e tejkalon jetën e zakonshme. Ai vetëm sa tregon rrugën, por këtë gjë shpeshherë nuk e kuptojnë jo vetëm spektatorët, por as vetë piktori. Duke u bërë qëllim, ai e tradhton vetveten. Kurse piktorët më shpesh e tradhtojnë jetën me përpjekjet e tyre për të dalë mbi të. Ata e copëtojnë atë, që duhet të jetë një e tërë, si një vezë. Unë jam plotësisht i bindur se dikur i gjithë arti do të zhduket. Por piktori do të mbetet dhe jeta nuk do të jetë "fushë e artit", por vetë arti, pasi të ketë zëvendësuar vendosmërisht një herë e përgjithmonë me vetveten, atë që i përket artit. Duke folur për thelbin, natyrisht që ne akoma nuk kemi filluar të jetojmë. Tashmë nuk jemi më kafshë, por, pa dyshim, akoma nuk jemi bërë njerëz. Që nga koha kur ka lindur arti, këtë gjë na e ka pohuar çdo piktor i madh, fare pak ishin ata që e kuptonin atë. Sapo arti fiton njohje të vërtetë, ai zhduket. Ai është vetëm një zëvendësim, një gjuhë simbolesh, nëpërmjet të cilit rikrijohet ajo që ne nuk jemi në gjendje ta shprehim drejtpërsëdrejti.

Por që të kryhet kjo, duhet që njeriu të bëhet me të vërtetë fetar: jo besimtar i një sekti, por në të vërtetë një bartës i fesë, i Zotit të vërtetë, pa asnjë lloj metafore. Dhe, në fund të fundit, ai do të bëhet pashmangësisht i tillë. Por nga të gjitha shtigjet, të cilat e nxjerrin në rrugën kryesore, arti është më i rëndësishëm, i hapur në drejtimin më të besueshëm dhe më shumë se të tjerët ia shpërblen udhëtarit. Piktori, i cili me të vërtetë e ka kuptuar misionin e vet, për këtë arsye pushon së qeni piktor. Dhe të gjithë anojnë drejt faktit se duhet të arrihet ky kuptim, kjo shkëndijë që arrin të ndriçojë vetëdijën tonë, se në jetën e sotme, duke përfshirë madje dhe artin, asgjë nuk është e aftë që të lulëzojë.

Dikush është i mendimit se të gjitha këto arsyetime janë mistifikime, por unë vetëm se po parashtroj atë për të cilin tashmë jam i bindur. Kuptohet se duhet mbajtur mend domosdoshmërish, se është e pashmangshme mospërshtatja midis gjendjes së vërtetë të gjërave dhe faktit se si e ndiejmë atë, madje gjendjen tonë personale. Megjithatë duhet sjellë në mendje edhe mospërshtatja e hapur midis gjendjes së vërtetë të gjërave dhe të asaj se si e paraqet vetveten dikush tjetër. Por midis atyre subjektive dhe objektive nuk ekzistojnë dallime esenciale jetësore. Gjithçka është iluzion dhe më shumë apo më pak jetëshkurtër. Të gjitha dukuritë, duke përfshirë njeriun me mendimet e tij për veten e vet, nuk janë më shumë se një grumbullim shenjash, i ndryshueshëm dhe i paqëndrueshëm. Fate të qëndrueshme te të cilat mund të mbahesh nuk ka. Prandaj edhe në libër, qoftë edhe sikur të synoja me vetëdije drejt prishjes dhe deformimit, nuk është aspak i detyrueshëm rezultati përfundimtar, që rezulton larg së vërtetës, sesa po të ishte në rastin e kundërt. Mund të jetë plotësisht i vërtetë dhe i sinqertë, e në këtë rast pa e fshehur të vërtetën se po gënjen plotësisht. Fiksimi, trillimi janë të ndërthurur me vetë përmbajtjen e jetës. Të vërtetën nuk e lëkund asnjë lloj tronditjeje e fortë shpirtërore.

Për këtë arsye, çfarëdo efekti që të arrija unë me ndihmën e kësaj apo asaj metode profesionale, ato në asnjë rast nuk janë thjesht mënyra të shkathëta, por transmetojnë saktësisht luhatjet e sejsmografit tim, që fikson përvojën kaotike, të shumëllojshme, të fshehtë e të paarritshme, që mua ma ka dhuruar jeta. Ndërkohë që po shkruaj librin, këtë përvojë po e përjetoj nga fillimi, ndryshe, ndoshta akoma më shumë kaotike, më të paarritshme dhe më misterioze. E ashtuquajtur shtresë e fakteve të padiskutueshme, që konsiderohet pikënisje dhe gjithë kohën rikrijuese, më është ngulitur shumë thellë dhe sado që përpiqem, nuk mund të çlirohem prej saj, as që ta korrigjoj dhe as që ta paraqes për diçka tjetër. Por bashkë me të, megjithatë, ajo transformohet, ashtu siç transformohet pamja e jashtme e botës, çdo çast, pas çdo marrjeje apo nxjerrjeje fryme nga ana jonë. Dhe nga kjo del se që ta ngulitësh në mendje botën është e mundur vetëm duke krijuar një iluzion të dyfishtë: ti e ndalon lëvizjen dhe po ti krijon vazhdimësinë e pandërprerë të saj. Dhe ja ky, le të themi, truku i dyfishtë, të krijon përshtypjen se para nesh kemi një falsifikim, por ja që thelbi i artit qëndron në një lloj të tillë gënjeshtre, për faktin se ai krijon një maskë të lëvizshme transformuese. Ti hedh spirancën midis lumit; ti pranon të vendosësh maskën e gënjeshtarit, për të shprehur të vërtetën.

Shpesh kam menduar se duhej të shkruaja një libër, duke shpjeguar se si lindin tek unë këto apo ato faqe, madje edhe ndonjë faqe e vetme. Natyrisht që unë mund të shkruaja një libër mjaft voluminoz, në të cilin thjesht do të analizohej një faqe e përzgjedhur me sukses nga veprat e mia; në të do të shpjegohej se si e kisha menduar atë faqe, si ishte shfaqur ajo, si kishte ndryshuar, në çfarë vuajtjesh kishte lindur, sa kohë kishin kaluar, para se ideja e saposhfaqur të kishte marrë trajtë dhe cilat mendime më gumëzhinin në kokë, ndërkohë që po shkruaja këtë pjesë. Çfarë ditë e javës kishte qenë atëherë, si e ndieja veten, si i kisha punët me nervat, si më kishin ndërprerë, apo vetë e kisha ndërprerë punën; cilat formulime të ndryshme leksikore vërtiteshin poshtë penës, si shkruaja shpejt e shpejt dhe i ndreqja gabimet, në çfarë pike isha ndalur, që nga kisha nisur riformulimin, duke ndryshuar madje dhe impulsin fillestar dhe më pas, duke i bërë qepjen e fundit, tamam si kirurgët, që përpiqen të fshehin se operacioni kishte dalë pa sukses e duke konkluduar për veten se patjetër do t'i kthehem kësaj faqeje, që nuk e bëra asnjëherë, por, dhe nëse do ta kisha bërë, do t'i isha kthyer vetëm impulsit, i cili tërësisht ishte fshirë nga kujtesa, por që papritur përsëri del në sipërfaqe, ndonëse kisha arritur të shkruaja disa libra të tjerë. Ndoshta mund të kisha folur për disa faqe, duke i krahasuar njërën me tjetrën dhe të zgjidheshin ato, të cilat për një kritik gjakftohtë të konsideroheshin mishërim i këtij apo atij. Por unë do t'i kisha hutuar këta kritikë analitikë; do t'u kisha treguar se faqja, gjoja e shkruar pa asnjë lloj imponimi, në fakt ishte shkruar nën një tensionim të pakufishëm, atëherë kur faqja tjetër, enigmatike, tamam si një labirinth dhe që lexohej me vështirësi, kishte shpërthyer tamam siç del nga toka një gejzer; atë e shkrova tamam sikur po më guduliste në shpinë një fllad kalimtar. Ose do të kisha shkruar se këtë faqe e kisha menduar akoma pa u ngritur nga shtrati, që e kisha ripunuar, duke u veshur, dhe më pas e kisha rishikuar përsëri, pasi isha ulur në tavolinë. Apo do t'i rishkruaja nga blloku im i shënimeve, që të gjithë të shihnin se si fjalët e ngrohta, të gjalla dhe njerëzore lindin nga vetë stimujt artificialë, të huaj për ta. Do të kisha riprodhuar fragmente frazash që do të më dilnin para sysh, kur do të shfletoja ndonjë libër dhe do të shkruaja se këto fragmente kishin nxitur tek unë përfytyrimin. Mirëpo kush do të shpjegonte hapur se në ç'mënyrë ndodh kjo, si kryhet kjo punë? Çfarëdo që të thonë kritikët për veprën, madje më të mirët, më të mençurit, që janë të aftë të bindin dhe që kanë prirje dashamirëse ndaj autorit, gjë që pothuajse nuk ndodh, sidoqoftë arsyetimet e tyre do të ishin thjesht jetëshkurtra, nëse do të njihej mekanizmi i vërtetë, procesi i vërtetë i lindjes së artit. Atë që unë kam shkruar vetë, kuptohet, e mbaj mend, jo fjalë për fjalë, por mjaft qartë dhe me vërtetësi. Kështu pra, librat e mi, të cilët u ngjasojnë disi fushave, që i kam shkelur me kujdes, si një topograf



*Vijon në faqen 23*

DHIMITËR SHUTERIQI

# Në Beograd, në kongresin e shkrimtarëve

Dhjetor 1945. Nisem me Mitrush Kutelin  për në Kongresin I të shkrimtarëve jugosllavë, që do të mbahet në Beograd dhe ku jemi ftuar si delegatë të Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë. Udhën Tiranë – Bitol e bëjmë me veturë. Pazari i Ohrit është mbushur me mollë, qepë e fasule, dhe me fshatarë të shumtë që flasin shqip. Thua se je në Pogradec. Treni Bitol – Beograd është pa xhama. Kallkan i madh nëpër Maqedoni dhe Serbi. Beogradi na pret me një dimër që s'e kam njohur gjetiu. Në stacion kanë dalë për ne Jovan Popoviçi dhe Oskar Daviçoja, të cilët na mësojnë se kongresi u shty për një datë të pacaktuar! Po, mysafirët janë të mirëpritur. Si s'e paskemi marrë vesh lajmin se kongresi u shty? S'e kemi marrë se nuk na e ka lajmëruar njeri. "Me që erdhët, do të rrini." Mirë se i gjetëm pra! Na vendosën në Hotel Moska, në qendër të qytetit, pranë godinës së famëshme "Albania", më e larta e Beogradit. Oskari punon në gazetën satirike "Jezh", Jovani nuk më kujtohet se ku.

Në Hotel Moska, rastësisht, duke ngrënë, njohim poetin maqedon Benko Markovski, një djalë mbi të tridhjetat, ca brufollak, me dy sy të mëdhenj, esentrik në paraqitje, fjalëshumë. Është bërë i famshëm. Ilia Ehrenburgu e ka quajtur "themelues të letërsisë moderne". Gëzohet të na njohë. Më nuk e takuam. (Pas vitit 1948 bëri burg, pastaj thanë që vdiq, po me sa kam dëgjuar, rron në Bullgari.)

Nëpër Beograd na shoqëron herë Daviçoja, herë Popoviçi, herë të dy. Flasin mirë frëngjisht. Oskari është një çifut fort i gjallë, ezmer, inteligjent, me talent të madh, thonë, i shkollave të fundit të letërsisë moderne. Pipa dhe bereta duan t'i japin dorën e fundit paraqitjes së tij si frëng e shkruar frëngu. (Rreth vitit 1948, më kujtohet se bëri emër të madh me një libër mbi Greqinë; sot i dëgjohet emri shumë si poet e romancier.) Jovani është një thatim disi i rezervuar, si një sllav i mbyllur, serioz, i sjellë, i përpiktë. Na tregohet vërtet i dashur. Komunist i vjetër, rreth 40 vjeç. Më jep me delikatesë librin e tij të botuar gjatë luftës, më 1944, "Istinite legjende" (legjenda të vërteta, tregime nga jeta partizane). (Këtë libër ia kam dhuruar Bibliotekës kombëtare, si gjë fort e rrallë qe ishte. Popoviçi më vonë qe ambasador në Kinë. Ka vdekur më 1955.)

Sjell në mend vizitën që bëmë bashkë në një ekspozitë të arteve figurative jugosllave, diku në Kalemejdan të Beogradit. Më kujtohet kemi zbuluar, unë dhe Kuteli, se Mosha Fijade na qenka piktor. Piktor mediokër. Gjithë ekspozita bënte përshtypje për ndikim dhe imitim, herë të lumtur dhe herë jo, të artit perëndimor, sidomos frëng. Asgjë të jashtëzakonshme. As disa skulptura të Augustinçiçit, me të cilin mburreshin fort, me sa duket me të drejtë. Daviçoja dhe Popoviçi thanë fjalë të mira për ekspozitën. por nuk u treguan entusiastë. Për ta, "ishte pak e improvizuar" , gjë që "kuptohej" për atë kohë, fill pas luftës.

Në baçen e Kalemejdanit, një monument i Mestroviçit fliste vërtet për art të madh. Na erdhi keq që nuk vizituam monumentin kombëtar në Aval, vepër e tij.

Organizuam një takim në Lidhjen e tyre të Shkrimtarëve, ku unë fola mbi letërsinë shqipe, frëngjisht. Nuk pat nevojë për përkthyes. Një sallë mesatare, një tavolinë e madhe (selia s'ishte e ngrohur, në Beograd mungonte qymyri), njerëzit ishin strukur nëpër palltot e qyrqet e tyre, me duart në xhepa, me jakat e ngritura, ndonjëri me kapelën në kokë, sikur të ishim në ndonjë stepë. Dëgjonin me vërejtje, sidoqoftë. Konferenca pati sukses, sado informative ishte. Më shtrënguan dorën, pasi duartrokitën me zell.

Më afrohet një burrë i gjatë e me syze, më eleganti në sallë (elegantisim për atë kohë), me një paraqitje prej diplomati apo nobli, me një frëngjishte të thatë, plot akcent sllav, po korekte. Është Ivo Andriçi i famshëm, për të cilin kam dëgjuar shumë ato ditë, sepse ka botuar ose do të botojë një roman me rëndësi ("Ura mbi Drina", që mori Çmimin Nobel.) Pas komplimenteve të rastit, më thotë:

Duhet t'ju kërkoj ndjesë, zotëri, se nuk kam njohur gjer tani asgjë nga letërsia juaj. Ne kemi me sa dëgjova, shumë gjëra të përbashkëta në jetën letrare.

Në mbrëmje, në hotel, troket dera e dhomës dhe hyjnë dy vetë. Njëri, me pallto lëkure, prezantohet Milan Bogdanoviç dhe prezanton shokun, Gligor (?) Gligoriç. I pari, - profesor i universitetit të Beogradit, kritik, historian i letërsisë; i dyti, drejtor i teatrit kombëtar në Beograd. Flasin frëngjisht mirë. Nuk dinë se si të çfajësohen se nuk erdhën në konferencën  time dhe dëshirojnë të kenë tekstin e saj, për ta botuar në numrin e parë të revistës " Nasha knizhevnost" që do të botohet në janar. (Kështu u bë: konferenca ime u botua, pak e shkurtuar.) Edhe këta të dy nuk dinë gjë për letërsinë tonë. Tregojnë admirim për disa vjersha që unë kam përkthyer frëngjisht ("Mojsiu" i Nolit, "Vaje IV" e Çajupit, " Zotit" prej Serembes e ndonjë tjetër). Me Gligoriçin pamë, në teatrit kombëtar, "Revizorin" e Gogolit. Ishte hera e parë që e shihja këtë vepër dhe me pëlqeu gjithëçka, pjesa, loja, regjia. Ato ditë nuk e di cila e përjavshme e Beogradit botoi tregimin tim "Ky çuni i madh i dajë Cenit", të cilën më kujtohet se ma pëlqyen (Popoviçi). Shtypi i Beogradit, "Borba", "Politika", i bënë oshëtimë të mirë konferencës sime.

Kthimin e bëmë nga Shkupi, Dibra, Struga. Në Shkup qëndruam 2-3 ditë dhe shqiptarët e atyshëm na pritën mirë. Pat që na u qenë hapet, se maqedonët i trajtonin keq shqiptarët. Shkollën shqipe të Shkupit e kishin bërë kazermë dhe fëmijët i bënin mësimet pasdreke në shkollën turke. Kuptohej qëllimi: që të mos i shpëtojmë ndikimit turk. Turq në Shkup kishte shumë pak në krahasim me shqiptarët. Po kishte ende shqiptarë turkofilë. Fesat e kuq ishin gjë e zakonshme në lagjet muhamedane përtej Vardarit. Në një fshat shqiptar pranë qytetit (Dançevo?) , hoxha na foli me mllef kundër sllavëve, duke na treguar se si tokat e tyre në fushë ua kishin rrëmbyer malazezët në kohën e carit.

Patëm një takim me gazetën "Nova Makedonia " dhe na morën në intervistë. Kryeredaktori, një djalosh, nxinte kur dëgjonte se shqipja kishte libra të shtypura që nga shek. XVI.

Pallati "Albania", Beograd

Shqiptarët dolën njerëz me kulturë! Kujtonin se letërsia jonë lindi që nga Lufta an. çl. dhe nuk u besonin veshëve. Gazeta botoi vetëm disa rrjeshta nga intervista. Këtë lajm ish e detyruar të botojë edhe gazeta shqipe e Shkupit, " Flaka e vëllazërimit" dhe asgjë më shumë. Binte era shovinizëm që atje tutje.

Pas një moti kam njohur Oto Zhupançiçin, kur bëra vizitën e dytë në Jugosllavi, për të marrë eksperiencë, me rastin që po krijonin Institutin pedagogjik dyvjeçar (dhjetor 1946). Në Lublianë, bashkë me Aleks Budën, ishim mysafirë të djalit të poetit, një gjeograf, i cili, atë verë, kaloi disa ditë në alpet e Shqipërisë, bashkë me nj'a dy shokë të tij të Zagrebit. Zhupançiçi, mbi 70 vjeç, plak i bardhë dëborë dhe mjaft i mbajtur, shumë i qeshur tregoi admirim të madh për popullin tonë dhe për luftën që kishim bërë. Kishte përkthyer ahere diçka të Shekspirit dhe që kishte bërë bujë. Na thanë se me qejf të madh do të përkthente diçka nga shqipja, po ta ndihmonim. Kishte qejf të dëgjojë se si tingëllonte kjo gjuhë dhe u enthuzias kur i treguam se përkthimet nga Shekspiri në shqipet ishin kryevepra.

Në Lublianë, profesori Nahtigal, plak dhe ai, na priti gati me indiferencë. "Nuk merrem më me shqipen", na tha, kur i kërkuam një mendim për krijimin e një katedre të gjuhës dhe letërsisë shqipe në Institutin tonë pedagogjik.

Në Zagreb, Petar Skoku na priti me inat, sepse kishte marrë vesh që ne çuditshëm se si kishte bërë asistent të vetin për shqipen Gjergj Komninonë. " Ma kërkoni mendimin tim me shkrim, që t'ua dërgoj", na tha. Në Beograd, përkundrazi, profesor Bariçi u tregua i gatshëm e na bëri sugjerime interesante mbi katedrën që projektonim. Ai nuk la gjë pa thënë kundër pushtetit në fuqi, që s'e trajtonte mirë. Kryetari i Komitetit për Arsimin na priti në mënyrë korekte, po sekretari i tij, Ivo Frol, u tregua nervoz, kur i thanë se librat shkollorë të premtuara prej tyre nuk i kishin marrë. "Ne i nisim, po ku mbarojnë?" Froli ishte shkrimtar dhe kishte vizituar pak më parë Shqipërinë. E mbante kokën lart dhe na shihte që nga maja e reve. Veç takimit zyrtar, nuk na u afruan fare, ndonse unë e kisha pritur o i kisha bërë nder në Tiranë. Më 1948 kam marrë vesh që jugosllavët bënë çmos që ne të mos e ngremë Institutin tonë pedagogjik. Vendosëm shpejt e shpejt të çelin në Beograd një degë të shqipes në universitet dhe aty vumë Dançetoviçin. Ky qe një mot profesor i serbishtes në Institutin tonë pedagogjik dhe shqipen e kishte mësuar në Kosovë, ku kishte mbledhur edhe folklor shqiptar. Përpjekjet e jugosllavëve kundër Institutit tonë i kam marrë vesh nga Fadil Paçrami, ahere zv.ministër i arsimit.

*Vijon nga faqja 21*

dhe jo nga kabineti, i armatosur me penë dhe grafika, por fizikisht, duke u zvarritur me këmbë, duar e me bark, duke prekur centimetër për centimetër dhe kështu për javë të tëra, sido që të ishte koha. E thënë shkurt, kjo punë për mua edhe sot është po kaq e zakonshme, siç ka qenë edhe në fillim fare dhe, ndoshta, më se e zakonshme. Finalizimin e librit unë gjithmonë e kam konceptuar veçanërisht në aspektin fizik: duhej ndryshuar poza. Libri mund të mbyllej me një mijë zgjidhje të tjera. Në të asnjë pjesë nuk quhej e përfunduar me të vërtetë; unë mund ta riktheja shtjellimin nga çdo pozicion; mund ta vazhdoja atë, duke hapur kanale dhe tunele të rinj, duke ndërtuar shtëpi të reja, fabrika, ura; duke populluar hapësirën me banorë të rinj, pasi të kisha transformuar faunën dhe florën. Përveç kësaj, e gjithë kjo, jo më pak se më parë, do t'u përgjigjej fakteve, të cilat unë i kisha prekur në vepër. Tek unë nuk gjen as zgjidhje dhe as finalizim. Jeta fillon në çdo moment, kur ndodh akti i të kuptuarit; po ashtu edhe libri. Mirëpo çdo fillim, qoftë libër, faqe, paragraf, frazë apo fjali, zëvendëson në vetvete lidhjen e re jetësore të ndërthurur dhe ja, në këtë gjallëri, vazhdimësi, jashtëkohësi dhe pandryshueshmëri mendimesh dhe ngjarjesh, unë çdo herë zhytem nga fillimi. Çdo fjalë, çdo rresht janë të lidhur organikisht me ekzistencën time, vetëm timen, qoftë ai ndonjë veprim, rast, fakt, ndonjë mendim apo emocion, ndonjë dëshirë, arratisje, lodhje, ëndërr, fantazi, mrekulli, në përgjithësi është diçka e papërfunduar dhe e pakuptimtë, që më ka mbetur në tru dhe që e ka mbështjellë atë si një lloj pëlhure merimange që shqyhet. Ndonëse në përgjithësi nuk ka asgjë të paqartë, të turbullt, madje, ajo "diçka" është e skicuar me rreptësi, është e pandarë, e përcaktuar dhe e qëndrueshme. Edhe vetë unë njëlloj si merimanga end dhe end, si besnik i misionit tim dhe i ndërgjegjësuar se kjo pëlhurë është endur me lëndë, nga e cila jam i përbërë edhe vetë, prandaj asnjëherë nuk do të më ngrejë kurthe dhe asnjëherë nuk do të shterojë.

Në fillim ëndërroja për një rivalitet me Dostojevskin; shpresoja se do të zbuloja para botës luftën e papërmbajtur shpirtërore e enigmatike dhe se bota do të vdiste e rrënuar. Por shumë shpejt e kuptova se tashmë e kishim kapërcyer cakun e ngulitur nga Dostojevski, e kishim kapërcyer në kuptimin se degjenerimi na kishte çuar më larg. Për ne ishte zhdukur vetë kuptimi i shpirtit, më saktë, ai tashmë ishte në një gjendje kimikisht të transformuar dhe në një pamje çuditërisht të shfytyruar. Ne njohim vetëm elementet kristalore të një shpirti të shpërbërë e të rrënuar. Piktorët bashkëkohorë, me sa duket, këtë gjendje e shprehin, madje, më hapur sesa shkrimtarët. Pikaso është një shembull i mrekullueshëm, i cili vërteton atë që përmenda. Prej këndej, vetë mendimi për të shkruar romane rezultoi i pamundur dhe po aq i parealizueshëm fakti për të marrë pjesë në lëvizje të ndryshme letrare në Angli, Francë dhe Amerikë, sepse të gjitha ato të çonin në udhëkryq. Me ndershmërinë më të madhe e pranoj se, duke vëzhguar rrënimin dhe shpërbërjen e elementeve të jetës (e kam fjalën për jetën shpirtërore dhe jo për jetën kulturore), e ndjeva veten të detyruar që t'i bashkoja ata sipas vizatimit tim, duke shfrytëzuar "unin" tim të shpërbërë e të rrënuar me po atë mizori, me atë mënyrë të pakuptueshme, me të cilën isha i gatshëm të shfrytëzoja të gjitha mbeturinat e dukurive të botës që na rrethon.

Nuk kam provuar asnjëherë as armiqësi dhe as ndrojtje në lidhje me anarkinë, të mishëruar në format mbizotëruese artistike, përkundrazi, gjithmonë i gëzohesha zhdukjes së formave të mëparshme. Në epokën të evidentuar si të degraduar, zhdukja më dukej si bamirësi, për më tepër si një imperativ moralizues. Unë jo vetëm që nuk kam pasur asnjëherë as dëshirën më të vogël që diçka ta konservoja, ta gjallëroja artificialisht ose ta ruaja, duke e rrethuar me mure, por më shumë do të thosha se që në rini isha i mendimit se shpërbërja është një manifestim i tillë i çuditshëm dhe joshës nga ana krijuese, i jetës, ashtu si edhe lulëzimi i tij.

Siç duket, pranova faktin se mua më tërhiqte krijimtaria letrare, përderisa ajo ishte e vetmja gjë që më kishte mbetur e qartë dhe që meritonte t'i përkushtoja forcat. Unë ndershmërisht i kisha provuar të gjitha rrugët e tjera drejt lirisë. Në të ashtuquajturën botë reale, isha një i pafat me dëshirën time dhe jo për shkak të paaftësisë për t'u përshtatur. Krijimtaria letrare për mua nuk ishte "arratisje", e thënë ndryshe, një mjet për t'u veçuar nga realiteti i përditshëm; përkundrazi, ajo do të thoshte se po futesha akoma më thellë në këtë pellg të ndotur, me shpresë për të arritur deri te burimet, që vazhdimisht e përtërinin me ujin që llokoçiste në to, që nuk shteronin e që përjetësisht gurgullonin. Duke i hedhur një vështrim prapa rrugës sime, unë e dalloj veten si një njeri të aftë për t'u marrë pothuajse me çdo lloj pune, me çdo problem. Drejt dëshpërimit më kishin çuar monotonia dhe steriliteti i gjithë mënyrës sipërfaqësore të jetesës. Mua më duhej një mbretëri e tillë, ku në të njëjtën kohë do të isha edhe zotëri, edhe skllav, dhe i tillë mund të bëhej vetëm arti. Dhe unë hyra në këtë botë, duke mos zotëruar asnjë lloj talenti të dukshëm, duke mos pasur njohuri, duke mos vlejtur për asgjë, si një fillestar i ngathët, i cili pothuajse ishte ngurosur nga frika dhe nga mendimi i madhështisë së asaj me të cilën ai do të merrej. M'u desh të vendosja tullë pas tulle, të harxhoja miliona fjalë, derisa në letër të shfaqej ajo fjalë e vërtetë, e autentike, të cilën e kisha nxjerrë nga thesari im i brendshëm. Unë isha i aftë të flisja shtruar dhe kjo gjë më pengonte, por kisha gjithë difektet e njeriut të arsimuar. Më duhej që në vazhdim të mësoja për të menduar, për të ndjerë, për të parë plotësisht sipas mënyrës së re, duke harruar arsimin tim, botën time dhe gjë më të vështirë se kjo mënyrë nuk ka mbi dhe. Duhej të hidhesha në lumë, duke e ditur se kishte mundësi të mos dilja dot prej tij. Në shumicën e tyre piktorët hidhen në lumë, në fillim duke u pajisur me komardaren e shpëtimit, e cila më shpesh i fundos ata. Askush nuk mundet të udhëtojë nëpër oqeanin e realitetit nëse veçohet nga përvoja. Nëse në jetë diçka ndryshon për së mbari, kjo arrihet jo në saje të përshtatjes, por falë sfidës dhe aftësisë për t'iu përgjigjur një nxitjeje të verbër. "Guximi fisnik nuk është fatal", - ka thënë Rene Krevel dhe këtë sentencë unë e mbajta mend përgjithmonë.

E gjithë logjika mbi të cilën mbahet gjithësia është e paracaktuar nga guximi fisnik e nga krijimtaria, e bazuar në mbështetjen më të pasigurt e më të paqëndrueshme. Në fillim një guxim i tillë identifikohet me aktin e vullnetshëm, por koha kalon, vullneti dobësohet dhe mbetet procesi automatik, i cili nga ana e vet gjithashtu duhet ta ndërpresë, ta ndalojë, që të vërtetohet besueshmëria e re, që nuk ka asgjë të përbashkët me diturinë, me aftësinë, zakonin apo besimin. Guximi fisnik të krijon ndjesinë të përfshihesh në këtë Iks plotësisht enigmatik, pozicion i piktorit, i cili është i vetmi që të mbron në botë dhe askush nuk mund ta shprehë me fjalë se ai është i tillë e megjithatë ai ekziston dhe shihet në çdo fjalë të shkruara prej teje.

1941

ArB eLo

# FUGU

Onufri